

Liritë
Veprimtari mësimore
për shkollat e mesme
për çështje ligjore të
Gjykatës Evropiane
për të Drejtat e Njeriut

Këshilli i Evropës

*Mendimet e shprehura në këtë botim janë
përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëso-
jnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të
Këshillit të Evropës*

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund
të përkthehet, të riprodhohet ose të
transmetohet në çfarëdo lloj forme
a mjeti, elektronik (CR rom, internet
etc) ose mekanik, duke përfshirë
këtu edhe fotokopjimin, regjistrimin
me çdo mjet tjetër ruajtës ose
transmetues, pa lejen paraprake me
shkrim nga Drejtoria e Komunikimit
(F-67075 Strasbourg Cedex ose
publishing@coe.int)

Kopertina: SPDP, Këshilli i Europës
Foto: Këshilli i Europës
Faqosja: Jouve

Përgjegjës për botimin shqip:
Astrit Dautaj

Botim i Këshillit të Europës
F-67075 Strasbourg Cedex
<http://book.coe.int>

ISBN 978-92-0871-8069-8
© Këshilli i Europës, Mars 2015-05-18
Shtypur në Këshillin e Europës

Bashkautorë dhe kontribues

Drejtuesit e projektit

Z. Villano Qirjazi, Drejtor i Divizionit të Politikave Arsimore, Këshilli i Europës

Znj. Stefania Kruger, Sekretare për Komitetin Drejtues të Politikave dhe Praktikave Arsimore, në Divizionin e Politikave Arsimore, Këshilli i Europës

Redaktorë

Dr. peter G. Kirchsclaeger, Dr. Bernard Dumont, Z. David Hayward

Bashkautorë:

- ▶ Z. Astrit Dautaj, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Tiranë (Shqipëri)
- ▶ Dr. Bernard Dumont, Këshilltar, trajner në fushën e inxhinierisë, të mësuarit përmes internetit dhe të cilësisë në arsim (Francë)
- ▶ Z. David Hayward, Student i nivelit pasuniversitar, Universiteti i Glazgout (BM)
- ▶ Dr. Peter Kirchsclaeger, Bashkëdrejtues i Qendrës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut (ZMRB) në Universitetin e Edukimit të Mësuesve të Zvicrës Qendrore, në Lucern (Zvicër)
- ▶ Profesor Jim Murdoch, profesor i të drejtës publike në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Glazgout (BM)
- ▶ Dr. Ivana Radaçiç, Instituti i Shkencave Shoqërore Ivo Pilar në Zagreb (Kroaci)
- ▶ Dr. Mitja Sardoç, Instituti i Kërkimeve Arsimore, Ljubjanë (Sloveni)

Pedagogët dhe studentët e përfshirë në hartimin e veprimtarive

Shqipëria

Znj. Erlira Kokona, Znj. Nevila Xhindi, Znj. Ina Zhupa, Z. Erlis Hereni, Z. Ermal Telha, Znj. Ornella Cena dhe Znj. Kejsi Rizo nën drejtimin e Z. Astrit Dautaj

Croatia

Znj. Karla Alfier, Znj. Tihana Balagović, Znj. Tena Baričić, Znj. Sunčica Brnardić, Znj. Marija Ćurić, Znj. Ida Dojčinović, Znj. Vanda Jakir, Znj. Ivana Kordić, Znj. Zrinka Lepan, Znj. Branka Marušić, Znj. Slavica Mihalić, Znj. Monika Rajković, Z. Andrea Šimunović, Znj. Ema Mendusic Skugor, Znj. Nina Sertic, Znj. Petra Šiško, Znj. Svjetlana Škrobo, Znj. Vanja Stanišić, Znj. Anja Zadavec dhe Z. Ivan Zrinski nga Universiteti i Zagrebit, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Dr. Ivana Radačić dhe Dr. Vedrana Spajic-Vrkas

Slovenia

Z. Rok Jemec, Znj. Tina Košir, Z. Luka Mišić, Z. Anže Novak, Znj. Katja Stare, Znj. Mojca Stropnik, Z. Iztok Štefanec, Z. Matija Urankar dhe Znj. Mojca Zadavec, nën mbikëqyrjen e Dr. Mitja Sardoč, Instituti i Kërkimeve në Arsim, Ljublanë dhe Profesor Miro Cerar, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Ljubljanës

Switzerland

Z. Christoph Basler, Znj. Sandra Buzolzer, Znj. Stefanie Rinaldi, Z. Fabio Erni, Znj. Sara Erni, Znj. Sophie Ernst, Znj. Simone Fasnacht, Znj. Eva Furrer, Znj. Jacqueline Haehni, Z. André Huber, Z. Fabian Imfeld, Znj. Laura Kathriner, Znj. Aline Lehner, Znj. Nina Lerch, Z. Timothée Lienhard, Z. Samuel Nurmi, Z. Valon-Enrico Prendi, Znj. Rahel Rohrer, Z. Rolf Saegesser dhe Znj. Joséphine Vollmeier në Universitetin e Edukimit të mësuësve, Lucerne, nën drejtimin e Dr. Peter G. Kirchsclaeger

UK

Z. Peter Alexander Begbie, Znj. Sonia Helen Campbell, Znj. Meghan Devine, Z. Jack Ford, Z. James Foster Gaughan, Z. Elliott Jon Gold, Z. David Hayëard, Z. Alastair John Mitchell, Znj. Laura Pasternak, Znj. Kenzie Anne Sharkey dhe Z. Andrew James Sirel, nën drejtimin e Profesor Jim Murdoch, Universiteti i Glasgout

Ilustratimets

Z. Anže Novak

Campbell dhe Cosans v. the United Kingdom Case Video

Znj. Olympia Tsipira

Assistant

Znj. Véronique Bernot, Këshilli i Europës

Përmbajtja

PARATHËNIE	7
1. TË NJOHIM KONVENTËN DHE GJYKATËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	9
1.1 Çfarë janë të drejtat e njeriut?	9
1.2. Çfarë është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut?	10
1.3. Ç'është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?	11
1.4. Si mund të paraqesim një çështje në Gjykatë?	12
1.5 Kush vendos?	13
1.6. Çfarë ndodh nëse Gjykata vendos se shteti ka shkelur të drejtat e mia?	14
2. SI TË ZBATOJMË VEPRIMTARITË NË KLASË?	15
2.1. Veçoritë e edukimit të të drejtave të njeriut	15
2.2 Struktura e veprimtarive	17
2.3. Si të zhvillojmë veprimtaritë në klasë	18
2.4. Si të vlerësojmë arritjet e nxënësve	20
2.5. Si të përdorim burimet audiovizive	22
2.6. Si të vlerësojmë veprimtaritë	23
3. VEPRIMTARI	25
3.1. Hyrja dhe tabela e veprimtarive	25
3.2. Tema 1 – Është jeta ime	31
3.3. Tema 2 – Mos ma bëj një gjë të tillë!	52
3.4. Tema 3 – Si i trajtojmë të tjerët?	68
3.5. Tema 4 – Unë dua një zë!	94
3.6. Tema 5 – Barazi për të gjithë	113
4. TABELA E VEPRIMTARIVE TË TJERA	127
5. VARIANT I THJESHTUAR I NENEVE TË PËRZGJEDHUR NGA KONVENTA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE E PROTOKOLLEVE TË SAJ	133
5.1 Përmbledhje e hyrjes	133
5.2 Nene të përzgjedhur	133
5.3. Protokollet e Konventës	136
6. BURIME NGA UEBSAITI DHE NGA BAZA E TË DHËNAVE	137
6.1 Baza e të dhënave dhe qëllimet e saj	137
6.2 Disa mënyra kërkimi	138
6.3. Çfarë do të gjeni	140
7. BOTIMET KRYESORE PËR KONVENTËN EVROPIANE E PËR TË DREJTAT E NJERIUT	143
8. BOTIME TË TJERA PËR EDUKIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT	145

Parathënie

“Njih të Drejtat e Njeriut dhe Vepra për to!” është një program i

Këshillit të Evropës që kërkon të nxisë nxënësit të mësojnë për qytetarinë bashkëkohore dhe zgjedhjet morale që shoqërojnë jetesën në demokraci. Vlera e këtij programi qëndron në faktin që këto çështje ai i trajton në kontekstin jetësor, të lidhura me

çështjet juridike që kanë ardhur për zgjidhje në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në këtë mënyrë, ne jo vetëm ndajmë me të rinjtë vlerat tona të përbashkëta, por u tregojmë atyre edhe domethënien dhe rëndësinë që ka pluralizmi, liria demokratike dhe shteti i së drejtës në jetën e përditshme.



Kjo është shumë e rëndësishme. Çdo brezi i kërkohet të kuptojë dhe të ruajë vlerat që mbajnë të bashkuar kontinentin Evropian. Mbi brezin e ri do të bjerë detyra e ruajtjes së traditave. Për këtë arsye, ai duhet ndihmuar të zhvillojë aftësinë për të menduar në mënyrë kritike, për të qenë në gjendje t'i zbatojë këto parime në botën që ndryshon me shpejtësi. Të drejtat e njeriut janë dinamike, ashtu sikurse janë dhe qytetarët e demokracisë. Për këtë arsye dhe jo rastësisht, ky program quhet “Njih të drejtat e njeriut dhe vepra për to!”

Kjo përmbledhje plotëson burime të tjera që ekzistojnë në fushën e edukimit për të drejtat e njeriut dhe ofron kontributin e saj të veçantë në tri drejtime.

Së pari, vëmendja përqendrohet në çështje të tilla ku individët sfidojnë praktikën e vendosura dhe në këtë mënyrë ata, tërthorazi, mbrojnë edhe interesat e të tjerëve. Disa prej tyre përfshijë të rinjtë. Disa të tjerë mund të jenë persona publikë, por pjesa më e madhe janë njerëz të zakonshëm, të cilët kanë qenë të detyruar të mbajnë dhe të shprehin qëndrimin e tyre, duke sjellë ndërlikime dhe pasoja që shkojnë përtej tyre.

Së dyti, çështjet e trajtuara lidhen me vlerat të rëndësishme shoqërore, ku përfshihen edhe toleranca, respekti për të tjerët, paanshmëria dhe mbrojtja kundër vendimeve arbitrare. Duke u përballur me këto tema, nxënësit fillojnë t'i zbatojnë ato në marrëdhëniet dhe komunitetet e tyre. Për shembull, çështja Opuz kundër shtetit turk trajton shkallën në të cilën policia duhet të ndërhyjë për të mbrojtur qytetarët nga rreziqe serioze dhune. Megjithatë, kur nxënësit e shkollës duhet të ndjejnë përgjegjësinë morale të ndërmarrin hapa konkretë për të mbrojtur shokët e klasës nga ngacmimet e talljet? Çështja D.H dhe të Tjerët kundër Republikës Çeke trajton çështjen e vlefshmërisë së ndarjes veçmas të mjediseve ku mësojnë fëmijët Rom, por edhe na jep mundësinë të hedhim vështrimin dhe të trajtojmë stereotipat dhe paragjykimet tona.


Së treti, këto materiale janë për të rinjtë dhe janë përgatitur nga të rinjtë. Ato janë prodhuar nga ekipe studentësh të talentuar dhe të motivuar, si dhe nga pedagogë të rinj në fushën e drejtësisë dhe të arsimit nga institucione të ndryshme dhe të testuar në një numër shkollash të Evropës. Grupe të ndryshme, me prejardhje të ndryshme, kanë sjellë këndvështrime dhe sfida të reja. Produkti është një numër i larmishëm veprimtarish dhe materialesh që ndihmojnë të rinjtë të kuptojnë edhe rolin që ata mund të luajnë në fushën e ligjit.

Unë kam kënaqësinë të nxis shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet palë në Konventën Kulturore Evropiane që të përdorin këtë burim të veçantë, ta përshtatin për nevojat e veçanta të klasave të ndryshme, gjatë procesit të të mësuarit të vlerave dhe ligjeve tona të përbashkëta.

Throrbjon Jagland
Sekretar i përgjithshëm i Këshillit të Evropës

1. Të njohim Konventën dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1.1 Çfarë janë të drejtat e njeriut?



Të drejtat e njeriut janë të drejta që të gjithë njerëzit i zotërojnë për shkak të të qenit qenie njerëzore. Ideja që i bashkon teoritë e ndryshme për të drejtat e njeriut është prania e disa tipareve themelore, të brendshme (karakteristika dhe aftësi të tilla, si; autonomia, dinjiteti, interesat dhe nevojat) që janë të përbashkëta për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga rrethanat në të cilat ata jetojnë. Këto “të drejta” janë të nevojshme për mirëqenien tonë, por në të njëjtën kohë ato janë lehtësisht të cenueshme nga veprimet e të tjerëve. Për këtë arsye, ato kanë nevojë të mbrohen përmes parimeve të të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut përshkruajnë mënyrën si shtetet duhet të trajtojnë personat që janë në juridiksionin e tyre. Ato klasifikohen në: të drejta civile dhe politike (mbrojtja e jetës dhe e integritetit mendor dhe fizik, si dhe liritë civile dhe politike); të drejtat shoqërore, ekonomike dhe kulturore (e drejta për punë, për arsim, për sigurime shoqërore, për shëndet); dhe “brezi i tretë” i të drejtave (e drejta për zhvillim, për paqe dhe mjedis të sigurt).

1.2. Çfarë është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut?



Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa" ose "KEDNJ") është instrumenti i parë ndërkombëtar detyrues për të drejtat e njeriut (u miratua në vitin 1950 dhe hyri në fuqi në vitin 1953). Konventa u miratua nga të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (një organizatë politike e 47 shteteve anëtare). Deri në 3 shkurt i vitit 2015, janë miratuar edhe 16 Protokolle të Konventës (14 prej tyre janë në fuqi), të cilat zgjerojnë të drejtat që duhet të mbrohen dhe disa amendojnë kuadrin e sistemit të konventës.

Konventa mbron të drejtat dhe liritë civile dhe politike (të tilla, si: e drejta e jetës, liria nga tortura, e drejta për jetë private dhe familje, liria e shprehjes etj.) Me disa përjashtime, të drejtat që përfshihen në Konventë (dhe Protokollat e saj) nuk janë absolute. Ato duhet të harmonizohen me të drejtat e të tjerëve dhe me interesin publik. Shtetet mund të shpërfillin disa të drejta në kohë lufte ose në situata të jashtëzakonshme. Konventa është konceptuar si një "instrument i gjallë". Për këtë arsye, edhe të drejtat janë interpretuar në mënyrë dinamike, në kuadrin e kushteve aktuale, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në kohën kur u ajo miratua. Për këtë arsye, Konventa nuk mbron vetëm nga tipat e zakonshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga shteti (për shembull, arrestimi i paligjshëm, dhuna në kushtet e ndalimit në mjediset e policisë), por edhe kundër shkeljeve të të drejtave nga individët (për shembull, dhuna seksuale dhe familjare, trafikimi), ku shteti dështon në marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar një shkelje ose për të vendosur ndëshkimet e duhura për to.


1.3. Ç'është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?



Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("Gjykata") është gjykata e parë ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, e krijuar nga Konventa në vitin 1959 dhe ende është e vetmja gjykatë të cilës individët mund t'i drejtohen drejtpërdrejtë. Gjykata vlerësohet si mekanizmi më i efektshëm ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe vepron, pothuajse, si një gjykatë kushtetuese e Evropës, që vendos standardet e përbashkëta Evropiane të të drejtave të njeriut. Që nga viti 1998 ajo ka pasur e vetëm përgjegjësinë për zbatimin e Konventës. Ajo përbëhet nga 47 gjyqtarë me kohë të plotë.

Gjykata shqyrton dhe vendos për çështjet ndërshtetërore, ato të individëve kundër shteteve kontraktues, si dhe ofron këshilla për çështje ligjore, që lidhen me interpretimin e Konventës, kur kjo kërkohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës. Kërkesat e individëve përbëjnë numrin më të madh të çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata. Deri në fund të vitit 2014, numri i kërkesave në pritje për shqyrtim nga Gjykata, ishte 69900.


1.4. Si mund të paraqesim një çështje në Gjykatë?



Ju mund të sillni një çështje në Gjykatë, nëse mendoni se shteti ka shkelur të drejtat tuaja, por përpara se Gjykata të shqyrtojë argumentet tuaja, ju duhet të keni plotësuar kërkesat e pranimit. Një ndër kriteret më të rëndësishme është rregulli i "shterimit të mjeteve të brendshme". Përpara dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, të gjitha mjetet efektive që ekzistojnë në shtetin tënd duhet të jenë shteruar (kjo do të thotë që ju keni kaluar në gjykatat e të gjitha niveleve në vend), dhe kërkesa duhet të dorëzohet brenda 6 muajve nga marrja e vendimit të formës së prerë. Kërkesa duhet të lidhet me një nga të drejtat që mbrohet nga Konventa. Personi që ankohet duhet të ndikohet drejtpërdrejt dhe duhet të ketë vuajtur dëme të rëndësishme. Përrashtim bën rasti kur respekti për të drejtat e njeriut, siç është përcaktuar në Konventë dhe në Protokollin e saj, kërkon një shqyrtim të vlerave të kërkesës në vetvete. Kërkesa nuk duhet të jetë haptazi e bazuar keq ose të jetë vetë abuzim i të drejtave.

Nëse mendoni se kërkesa juaj i plotëson këto kritere, atëherë ju mund ta dorëzoni atë në rrugë zyrtare. Përfaqësimi juaj nuk është i nevojshëm në fazën fillestare, megjithëse përfaqësimi ligjor do të kërkohet kur Gjykata njofton shtetin e akuzuar për të. Pas kësaj faze juve mund t'u jepet ndihmë ligjore dhe duhet t'i shkruani Gjykatës në një nga gjuhët e saj zyrtare. Megjithatë, ju mund të dorëzoni një kërkesë edhe në gjuhën e vendit tuaj.

1.5 Kush vendos?



Gjykata përbëhet nga 47 gjyqtarë, një nga çdo shtet anëtar. Ata duhet të karakterizohen nga integriteti i lartë moral dhe të kenë kualifikimet e nevojshme. Gjyqtarët zgjidhen me shumicë vote në Asambleshën Parlamentare të Këshillit të Evropës, për një periudhë të pa rinovueshme prej nëntë vitesh. Ata e kryejnë detyrën në bazë të aftësive individuale dhe janë të pavarur. Gjyqtarët ulen në një Komitet prej tre gjyqtarësh, Dhoma me shtatë gjyqtarë dhe Dhoma e madhe me 17 gjyqtarë. Një gjyqtar i vetëm mund të kundërshtojë kërkesa qartësisht të papranueshme (por nuk mund të shqyrtojë kërkesat kundër shtetit në lidhje me të cilin ai është zgjedhur). Komiteti prej 3 gjyqtarësh ka pushtetin të deklarojë kërkesat të pranueshme dhe të vendosë mbi bazën e cilësisë së çështjes kur ajo është paraqitur si duhet si një kazu ligjor. Dhoma me 7 gjyqtarë vendos mbi bazën e cilësisë së të gjitha çështjeve, me përjashtim të rasteve kur jurisdiksioni i kalon Dhomës së Madhe.

Dhoma e Madhe mund të dëgjojë kazuset që ngrenë çështje serioze interpretimi dhe zbatimi të Konventës, një çështje të rëndësisë së përgjithshme ose çështje që mund të nisen nga çështje të mëparshme ligjore. Një panel prej pesë gjyqtarësh vendos nëse Dhoma e Madhe pranon referimin. Dhoma e Madhe mund të dëgjojë një çështje të vendosur nga Dhoma, nëse Paneli e pranon kërkesën. Kërkesa mund të dorëzohet nga çdo palë e çështjes, brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e vendimit nga Dhoma.

1.6. Çfarë ndodh nëse Gjykata vendos se shteti ka shkelur të drejtat e mia?



Palët kontraktuese duhet t'i binden vendimit final të Gjykatës në rastet ku ata janë palë. Megjithatë, Gjykata në përgjithësi nuk specifikon masat që duhet të marrin shtetet dhe nuk mbikëqyr zbatimin e vendimit të saj. Kjo është detyrë e Komitetit të Ministrave (organ ndërqeveritar i përbërë nga ministrat e jashtëm ose nga përfaqësuesit diplomatik nga 47 shtete dhe të ndihmuar nga Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut). Masat e kërkuara janë dy lloje: masa individuale, që synojnë të zbutjen e pasojave të shkeljes për një aplikant (thjesht kënaqësi dhe masa të nevojshme të tilla si rihapja e procedurave); dhe masa të përgjithshme, që synojnë të parandalojnë shkelje të ngjashme, në të ardhmen, të tilla si ndryshime të ligjit, masa politike ose praktike, për shembull, riparimi i pajisjeve të vjetruara të burgjeve në rastet e ankesave që lidhen me kushtet e burgimit.

I takon shtetit të identifikojë masat, në bashkëpunim me Departamentin e Ekzekutimit të Vendimeve. Hapi i parë në zbatim, për shtetin, është të hartojnë një plan veprimi brenda gjashtë muajve nga data kur vendimi bëhet përfundimtar (tre muaj nga data e zbardhjes së vendimit, vetëm në rast se çështja është dorëzuar në Dhomën e Madhe). Nëse vendimi është i paqartë në lidhje me atë që kërkohet për zbatim, Komiteti i Ministrave mund të bjerë dakord, me shumicën e dy të tretave të votave, për t'u referuar përsëri në Gjykatë për qartësim.

2. Si të zbatojmë veprimtaritë në klasë?

2.1. Veçoritë e edukimit të të drejtave të njeriut

2.1.1. Përcaktimi i edukimit për të drejtat e njeriut

Edukimi për të drejtat e njeriut (EDNJ) është përcaktuar nga Karta e KE për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, si më poshtë:

“Edukimi për të drejtat e njeriut” nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikat dhe veprimtaritë që ato synojnë, përmes pajisjes së nxënësve me njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të dhënë ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri, për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

2.1.2. Parimet, qëllimet, objektivat dhe pedagogjia e edukimit për të drejtat e njeriut

Përcaktimi i Kartës na çon në parimet, qëllimet e objektivat specifike të EDNJ, duke na ofruar edhe një kuadër për pedagogjinë e EDNJ:

- ▶ Parimet:
 - EDNJ është një proces që zgjat gjithë jetën.
 - EDNJ duhet të realizohet në partneritet dhe bashkëpunim.
 - Mësimdhënia duhet të ndjekë vlerat dhe parimet demokratike dhe të të drejtave të njeriut.
- ▶ Qëllimet:
 - Mësimdhënia duhet të nxisë vlerat dhe parimet demokratike dhe ato të drejtave të njeriut dhe të rritë fuqizimin e dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësit.
 - EDNJ duhet të nxisë kohezionin shoqëror dhe dialogun ndërkulturor dhe vlerën e diversitetit dhe barazisë.
 - EDNJ duhet të fuqizojë njerëzit me gatishmërinë për të ndërmarrë veprime në shoqëri, në mbrojtje dhe për zhvillimin e të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës.

- ▶ Objektivat:
 - Të rritë njohuritë për të drejtat e njeriut, për shembull, njohuritë për të drejtat e njeriut që mbrohen me kushtetutë si dhe dokumentet themelore të të drejtave të njeriut.
 - Të aftësojë nxënësit të zhvillojnë të kuptuarit kritik të situatave të jetës, për shembull, përmes vënies në dyshim të kufijve dhe strukturave që pengojnë gëzimin e plotë të të drejtave dhe lirive.
 - Të ndihmojë nxënësit në procesin e qartësimit të vlerave të tilla si paanshmëria, barazia dhe drejtësia.
 - Të nxisë ndryshimin e sjelljeve përmes mësimdhënies së tolerancës ndërmjet anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike dhe kombëtare.
 - Të nxisë qëndrime solidariteti, për shembull, duke ndihmuar njerëzit të pranojnë përpjekjet e qenieve njerëzore, në shtëpi dhe kudo, në kërkim të plotësimit të nevojave të tyre dhe të përgjigjes për shkëlqen e të drejtave të njeriut.
 - Të ndryshojë sjelljet, për shembull, përmes veprimit që reflekton respektin për të tjerët.
 - Të fuqizojë njerëzit për pjesëmarrje, për shembull, përmes aftësimit të tyre për të përcaktuar dhe plotësuar nevojat e tyre
- ▶ Këto parime, qëllime dhe objektiva përcaktojnë dhe pedagogjinë e EDNJ, që karakterizohet nga tiparet e mëposhtme:
 - *Karakter i kontekstual* i të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se një ndër objektivat e edukimit për të drejtat e njeriut duhet të jetë të kuptuarit kritik i kushteve objektive në të cilat jeton nxënësi ose fëmija.
 - *Veprimtaria* zë vend qendror në edukimin për të drejtat e njeriut. Kjo do të thotë se, mësuesi duhet t'i kushtojë rëndësi njohjes dhe krijimit të kushteve për shprehjen dhe për shfrytëzimin e njohurive paraprahe të nxënësve. Veprimtaria, ora e mësimit duhet të ndihmojë nxënësin të shprehë përvojën e tij.
 - Krijimi i *situatave problemore* dhe i pyetjeve, që synojnë të *sfidojnë* njohuritë paraprahe të nxënësit.
 - *Pjesëmarrja dhe nxitja e përpjekjeve kolektive për sqarimin e koncepteve*, për analizën e çështjeve dhe për zhvillimin e veprimtarive duhet të jetë përparësi e procesit të edukimit për të drejtat e njeriut
 - Trajtimi *dialektik* i çështjeve, që lidhen me të drejtat e njeriut. Njohuritë duhet të krahasohen me burime të ndryshme, si: fakte, të dhëna, statistika etj.
 - Analiza dhe zhvillimi i pyetjeve “pse” dhe “si”, për t'i bërë nxënësit të mendojnë rreth psesë së gjërave, për lidhjet e tyre, për ndikimet reciproke etj. Kjo do t'i ndihmojë ata të shohin tej fasadës.

2.1.3. Kontekstualizimi i të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut nuk janë diçka abstrakte, që ekzistojnë vetëm në trajtën e koncepteve, të ideve ose të vlerave. Ato lidhen ngushtë me veprimtarinë e përditshme të njerëzve, e cila, ashtu si dhe vlerat dhe idetë, lidhen me nje realitet konkret. Pra, si shkëlqet, ashtu edhe mbrojtja e të drejtave të njeriut realizohet në një kontekst të caktuar historik. Për këtë arsye, objektivat, që lidhen me kontekstin, në të cilin zhvillohet veprimtaria njerëzore, përbëjnë një grup të dytë të objektivave specifike të edukimit për të drejtat e njeriut.

Në këtë fushë nxënësit duhet të jenë të aftë:

- ▶ të japin shembuj të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- ▶ të japin një përcaktim të një shkeljeje të të drejtave të njeriut;
- ▶ të identifikojnë grupe njerëzish në shoqëri, të cilëve u janë shkelur të drejtat;
- ▶ të identifikojnë njerëz, grupe ose situata, që shkaktojnë shkelje të të drejtave të njeriut;
- ▶ të shpjegojnë pse një konventë (për shembull, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut) duhet të ratifikohet nga parlamentet e vendeve anëtare të KE;
- ▶ të japin shembuj të ligjeve që duhet të ndryshohen ose të përmirësohen në bazë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

2.1.4. Respektimi, mbrojtja dhe çuarja përpara e të drejtave të njeriut

Njohuritë për të drejtat e njeriut janë thelbësore, por nuk janë të mjaftueshme. Ato duhet të shoqërohen me qëndrime të tilla, që kanë në themel respektimin e të drejtave të njeriut dhe veprimin për mbrojtjen dhe për çuarjen e tyre përpara.

Në këtë drejtim, nxënësit duhet të jenë të aftë:

- ▶ të argumentojnë pse demokracia ka nevojë për mbrojtjen e të DNJ;
- ▶ të argumentojnë mundësinë e nxitjes dhe zhvillimit të të DNJ;
- ▶ të identifikojnë rolin e individit në mbrojtjen dhe në çuarjen më tej të DNJ të institucioneve dhe të organizatave shoqërore
- ▶ të projektojnë masa ose strategji për mbrojtjen e të DNJ në nivel individual, kolektiv ose institucional.

2.1.5. Solidariteti ndërkombëtar

Në kushtet e një shoqërie globale e gjithnjë e më të ndërvarur, shumë prej problemeve, që lidhen me të drejtat e njeriut, kërkojnë angazhimin e komunitetit ndërkombëtar.

Për këtë arsye, është mirë që nxënësit në këtë fushë të jenë të aftë:

- ▶ të identifikojnë forcat në nivel ndërkombëtar që promovojnë të drejtat e njeriut;
- ▶ të identifikojnë forcat në nivel ndërkombëtar që ndikojnë në gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin tonë etj.

2.2 Struktura e veprimtarive

12 veprimtaritë mësimore të detajuara në Kapitullin 3¹ janë strukturuar në mënyrë të tillë që i japin mundësi nxënësit të njohë faktet e çështjes, të analizojë nenet e Konventës që lidhen me të dhe të diskutojë vendimin e Gjykatës dhe ndikimet e

1. Më shumë veprimtari gjenden në faqen e projektit: <http://explore-humanrights.coe.int>, accessed 3 February 2015.

saj. Ato nxisin nxënësin të kërkojë përtej rastit konkret dhe ta lidhë atë me jetën e përditshme dhe me situatat e njohura për ta.

Veprimtaritë mësimore përfshijnë elemente që synojnë të familjarizojnë nxënësit me aspektet procedurale të Gjykatës, në mënyrë që t'i mësojnë të përdorin mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel Evropian.

Veprimtaritë bazohen në çështje reale dhe janë paraqitur në të njëjtin format:

Pjesa A përmban vendimin referues, kontekstin ligjor, ndërsa pjesë B përmban çështjet pedagogjike.

Më hollësisht, Pjesa A përmban elementet e mëposhtëm:

- ▶ aplikanti
- ▶ arsyetimi: pse është përzgjedhur çështja
- ▶ faktet
- ▶ beteja ligjore: bazat e çështjes
- ▶ kronologjia e veprimeve ligjore
- ▶ nenet e Konventës që lidhen me çështjen si dhe çështje kryesore të trajtuara në gjykim
- ▶ përgjigja e Gjykatës dhe parimet themelore të mbajtur parasysht
- ▶ çfarë ndodhi më tej; ndikimi i vendimit të Gjykatës në ligjin vendas.

Pjesa B përmban:

- ▶ hyrje për veprimtarinë
- ▶ konceptet dhe çështjet e përfshira
- ▶ objektivat e të mësuarit
- ▶ planifikimi: udhëzime për të organizuar orën e mësimit 45 minutëshe nga pikëpamja e metodës, e veprimtarive të mësuesit dhe të nxënësit
- ▶ materiali pedagogjik që mund të përdoret për të mbështetur veprimtarinë

2.3. Si të zhvillojmë veprimtaritë në klasë

Për të zgjedhur veprimtarinë që përputhet me nevojat tuaja, 12 veprimtaritë janë grupuar në pesë tema kryesore, në fillim të kapitullit 3. Çdo veprimtari është hartuar për nxënësit e shkollës së mesme. Ajo është planifikuar për t'u zhvilluar në 45 minuta dhe përmban të gjithë informacionin dhe materialin e nevojshëm që gjendet në këtë manual.

Megjithëse veprimtaritë janë hartuar të plota në vetvete, atje ku është e mundur, mund të ishte e efektshme të propozoheshin detyra shtëpie përpara ose pas mësimit, si dhe për të shtuar veprimtari të tjera me spektër më të gjerë dhe për një periudhë më të gjatë kohore. Përpara fillimit të veprimtarisë së parë, është e rekomandueshme që mësuesi të paraqesë shkurtimisht Këshillin e Evropës dhe objektivat e tij. Për këtë qëllim, rekomandohet të përdoret broshura prej shtatë faqesh "Këshilli i Evropës, rojtari i të drejtave të njeriut (2014)", i përkthyer në 21 gjuhë. Broshura gjendet në adresën:

[https://edoc.coe.int/en/an-overview/
6206-the-council-of-europe-guardian-of-human-rights.html](https://edoc.coe.int/en/an-overview/6206-the-council-of-europe-guardian-of-human-rights.html)

Një broshurë tjetër, prej 28 faqesh, "Këshilli i Evropës: pamje e përgjithshme (2013), në gjuhët anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe rusisht, gjendet në adresën:

<https://edoc.coe.int/en/an-overview/5336-the-council-of-europe-an-overview.html>

Ju mund të përdorni edhe videon prej 7 minutash dhe 35 sec në adresën:

www.youtube.com/watch?feature=player_embedded&v=7SKqVzIHc9o



Është e rëndësishme të bëjmë dallimin ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, në njërën anë, dhe ndërmjet Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian nga ana tjetër.

Së dyti, ju duhet të paraqisni Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si pjesë e Këshillit të Evropës, si dhe mënyrën në të cilën ai mund të ndikojë në legjislacionin e vendeve anëtare. Ju mund të përdorni, për shembull, fletëpalosjen dy faqëshe "Gjykata shkurtimisht", e cila gjendet në adresën:

www.echr.coe.int/Documents/Court_in_brief_ENG.pdf

Kjo broshurë ofron një hyrje për Gjykatën dhe të dhëna kyç të historisë së saj, si dhe një përmbledhje të shkurtër të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo është e përkthyer në 38 gjuhë. Për më shumë informacion, ju mund të përdorni "Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në 50 pyetje (nëntë faqe) dhe gjendet në:

www.echr.coe.int/Documents/50Questions_ENG.pdf

Ju mund të përdorni një video (15 minuta dhe 50 sekonda), "Ndërgjegja e Evropës", gjendet në 25 gjuhë. Ky është një dokumentar që i drejtohet publikut të gjerë dhe ofron shembuj të veçantë të çështjeve të shqyrtuara nga gjykata dhe merr parasysh mundësitë dhe sfidat e saj. Në gjuhën angleze, kjo gjendet në:

[www.youtube.com/watch?v=Ijdoe02cY0U&feature=plcp&context=
C3494c3aUDOEgsToPDskLp5dEeCFO-YnqrILlvQAe_](http://www.youtube.com/watch?v=Ijdoe02cY0U&feature=plcp&context=C3494c3aUDOEgsToPDskLp5dEeCFO-YnqrILlvQAe_)

Së treti, ju mund të paraqisni Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila gjendet në:

www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf

Konventa është përkthyer në 38 gjuhë²

Në varësi të moshës dhe nivelit të nxënësve, mund të ishte me vlerë të punoni me një version më të thjeshtuar, me nene të përzgjedhur nga Konventa dhe Protokollat e saj.³

www.echr.coe.int/Documents/Simplified_Conv_ENG.pdf

2. Gjendet në www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=basictexts&c=#n1359128122487_pointer, accessed 3 February 2015.
3. Kjo frymëzohet nga versioni i thjeshtësuar i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nga Amnesty International.

Një video e shkurtër (3 minuta dhe 16 seconda), e përkthyer në 38 gjuhë, është prodhuar nga Gjykata dhe paraqet të drejtat dhe liritë kryesore të Konventës. Video në gjuhën angleze gjendet në:

www.youtube.com/watch?v=MOcmUQTgjCw&list=PLT-6qb4oU5fj_2HYaZ7Rtq0jfGr6cAics&index=1

2.4. Si të vlerësojmë arritjet e nxënësve

Si çdo proces të mësuarit, edhe EDNJ ka nevojë të vlerësohet për të përcaktuar nëse nxënësit i kanë fituar njohuritë dhe aftësitë ose kanë ndryshuar qëndrimet e tyre.

Në fakt, vlerësimi ndikon fuqimisht në të gjithë procesin e të mësuarit dhe të mësimdhënies. Shpesh herë nxënësit mësojnë atë që vlerësohet, ndërsa mësuesit mësojnë atë që pritet të testohet. Në këtë këndvështrim, kjo është një ndër arsyt kryesore përse vlerësimi është një proces shumë i rëndësishëm.

Çfarë duhet të vlerësojmë në fushën e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe të Edukimit për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNJ)? Në dritën e përcaktimit të Kartës së Këshillit të Evropës për EQD/EDNJ, objektivi kryesor i EDNJ është përgatitja dhe fuqizimi i të rinjve për të integruar të drejtat e njeriut në jetën dhe sjelljet e tyre të përditshme, për t'u bërë qytetarë të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Për këtë arsye, EDNJ fokusohet në atë që nxënësit duhet të jenë të aftë të bëjnë, më shumë se në atë që mësuesi duhet t'u mësojë atyre. Kjo do të thotë, që vlerësimi i nxënësve duhet të bazohet te kompetenca. Në fund të procesit të të mësuarit, të shkollimit ose të trajnimit, nga nxënësit pritet:

- ▶ të dinë të drejtat e tyre dhe të kuptojnë kushtet nga të cilat varen (të mësuarit "*rreth*" demokracisë dhe të drejtave të njeriut);
- ▶ të jenë trajnuar në ushtrimin e të drejtave të njeriut dhe në respektimin e të drejtave të të tjerëve (të mësuarit "*përmes*" demokracisë dhe të drejtave të njeriut);
- ▶ të kenë fituar aftësitë për të qenë besimplotë dhe të gatshëm në ushtrimin e të drejtave të njeriut, me ndjenjë përgjegjësie ndaj të tjerëve dhe komunitetit (të mësuarit "*për*" demokracinë dhe të drejtat e njeriut).⁴

Kjo do të thotë që, njohja me të drejtat e njeriut dhe me sistemin e mbrojtjes së tyre nuk është i mjaftueshëm. Ai duhet të shoqërohet me zhvillimin e aftësive të vendimmarrjes, të mendimit kritik dhe të pjesëmarrjes. Qytetaria efektive dhe e përgjegjshme kërkon jo vetëm njohuri dhe të kuptuar, por edhe pjesëmarrje në qeverisjen e shkollës, të komunitetit dhe të vendit.

Të gjitha veprimtaritë e zhvilluara në këtë manual bazohen në njohuri, aftësi dhe qëndrime që lidhen me objektivat. Cilësia e përmbushjes së tyre varet nga shkalla në të cilën ato përputhen me qëllimin. Duke vlerësuar nxënësit, ne synojmë të sigurojmë

4. R. Gollob, P. Krapt dhe W. Weidinger (red.) (2010), Edukimi për demokraci Materiale për mësuesit, për edukimin për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut. Vëllimi I i Vëllimeve 1-6- Edukimi për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat Njeriut në praktikën shkollore. Njësi mësimore, koncepte, metoda dhe modele, Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg, fq. 29

një përgjigje për këtë pyetje. Objektivat e të mësuarit të veprimtarive dhe qëllimi i të gjithë projektit janë dhe kriteret për vlerësimin e përparimit të nxënësve në këtë fushë të edukimit.

Objektivat e të mësuarit për veprimtaritë janë strukturuar si më poshtë:

Njohuritë dhe të kuptuarit

Për shembull, si rezultat e pjesëmarrjes në këtë veprimtari:

- ▶ nxënësi do të kuptojë konceptet kryesore të çështjes;
- ▶ nxënësi do të kuptojë parimin e të drejtës për një gjyq të drejtë, të pavarur, të paanshëm, brenda një kohe të arsyeshme.

Aftësitë

- ▶ nxënësi do të kuptojë rëndësinë e aftësisë së mendimit kritik;
- ▶ nxënësi do të vlerësojë çështjen në të cilën është shkelur e drejta për një gjyq të drejtë;
- ▶ nxënësi do të marrë dhe do të mbrojë qëndrimin e tij, të bazuar në fakte dhe argumente, duke marrë parasysh edhe argumentet e të tjerëve;
- ▶ nxënësi do të jetë i aftë të bëjë kompromise.

Qëndrime

- ▶ nxënësi do të motivohet për të zbatuar njohuritë e marra në jetën e përditshme;
- ▶ nxënësi do të jetë i aftë të ndryshojnë mendimin e tij ,duke u bazuar në faktet e reja;
- ▶ nxënësi do të jetë i aftë të bëjë kompromise.
- ▶ nxënësi do të jetë i aftë të ndërmarrë vullnetarisht veprime për të mirën e përbashkët.

Procesi i vlerësimit bazohet në rezultatet e të mësuarit dhe në sjelljen e vëzhgueshme. Në fund të veprimtarisë, mësuesi duhet të reflektojë për pyetje të tilla si:

- ▶ A i kupton nxënësi konceptet e çështjes në shqyrtim?
 - Është nxënësi i aftë:
 - të identifikojë elementet e çështjes?
 - të përshkruajë kuptimin e tyre?
 - të shpjegojë qëllimin?
- ▶ Është nxënësi i aftë të arrijë në kompromise?
 - Është nxënësi i aftë:
 - të identifikojë opinionet e ndryshme nga të tija?
 - të identifikojë vlerat/pikat e forta në opinione e të tjerëve?
 - të pranojë pikat e dobëta në opinionin e tij?
 - të pranojë të heqë dorë nga diçka e tija?
- ▶ Është nxënësi në gjendje të ndryshojë mendimin e tij?
 - Është nxënësi i aftë:
 - të identifikojë faktet që kundërshtojnë mendimin e tij?
 - të pranojë faktet që kundërshtojnë mendimin e tij?
 - të identifikojë pika e dobëta në mendimin e tij?

Një ndër rezultatet e pritshme të proceseve të të mësuarit dhe të trajnimit në fushën e EDNJ është që nxënësi të jetë i gatshëm për të marrë pjesë në proceset politike të komunitetit. Kjo ka të bëjë me aftësitë pjesëmarrëse, domethënë me aftësinë e nxënësit:

- ▶ për të ndërmarrë veprime për të komunikuar me të tjerët , për të pyetur, për t'u përgjigjur, për të marrë vendime, për të ndërtuar koalicione, për të menaxhuar konflikte, për të punuar në grup, për të përdorur medien etj.;
- ▶ për të monitoruar politikën publike, në mënyrë që pjesëmarrja e tij të jetë e përgjegjshme. Kjo do të thotë, të jetë i aftë të marrë pjesë në jetën qytetare, të informojë dhe të informohet, të japë dhe të marrë intervista, të mbajë fjalime në publik etj.;
- ▶ për të ndikuar politikën publike, domethënë, të përdorë aftësitë e duhura për këtë qëllim në të gjitha nivelet.

Një ndër qëllimet e EDNJ është ndryshimi i sjelljes dhe qëndrimeve të nxënësve, duke u mundësuar atyre të pranojnë përgjegjësinë në të gjitha fushat e jetës. Kështu:

- ▶ nxënësi duhet të jetë anëtar i pavarur i shoqërisë;
 - Është nxënësi në gjendje:
 - të marrë pjesë, vullnetarisht, në shoqëri, duke pranuar standardet e saj të bazuara në të mirën e përbashkët?
 - të pranojë përgjegjësinë për veprimet e tij?
- ▶ nxënësi duhet të jetë i aftë të marrë pjesë në shoqëri duke qenë i mirinformuar.
 - Është nxënësi në gjendje:
 - të kërkojë informacion përpara se të votojë ose të marrë pjesë në një debat publik?
 - të vendosë përparësinë e të mirës së përbashkët mbi atë vetjake?

2.5. Si të përdorim burimet audiovizive

Një ndër 12 veprimtaritë, Kempbell dhe Kozan kundër Mbretërisë së Bashkuar, ilustron me një video në dy versione: një version i plotë, që zgjat më shumë se 19 minuta dhe tregon për çfarë duhet të kërkojnë nxënësit paraprakisht. Në fund të mësimit, ju mund t'u rekomandoni nxënësve të shohin versionin e gjatë, duke pajisur ata me adresën e internetit ose me një kopje të saj.

Në përgjithësi, nëse, gjatë mësimit, dëshironi të përdorni një video më të gjatë, ju duhet të punoni paraprakisht me të, duke e redaktuar dhe ndarë atë në pjesë më të shkurtra (3 deri 6 minuta secila). Më pas, ju mund të paraqisni çdo pjesë, duke bërë të qartë përmbajtjen që duhet të jetë në qendër të vëmendjes së nxënësve. Pasi të shikohet një pjesë e videos, nxënësit duhet të punojnë me të për një detyrë të përgatitur nga ju paraprakisht. Më pas, ata mund të kalojnë në shikimin e pjesës së videos që vijon.

Nga pikëpamja e njohjes, është e rëndësishme që video të shikohet e plotë ose nxënësit të kenë mundësinë ta shohin atë edhe vetë pas mësimit.

2.6. Si të vlerësojmë veprimtaritë

Online gjendet një pyetësor i përdorur më parë nga mësuesit që kanë testuar veprimtaritë në klasat e tyre:

https://docs.google.com/forms/d/1zWyJorxDr1MTq3zNM_O2y64lWYlv_054Mns_OTbu-KA/viewform

Nxënësit mund të ofrojnë komente përmes këtij pyetësi online:

https://docs.google.com/forms/d/1Q4DYeGGdEJQ65RN9ics9e_9faGx3R4CqRzpTuTy5ZD0/viewform

Ju lutemi, mos hezitoni të ndani me autorët pikëpamjet dhe përvojën tuaj dhe ftoni nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë.

3. Veprimtari


3.1. Hyrja dhe tabela e veprimtarive

Ky manual përmban 12 studime rasti që lidhen me pesë tematika të gjera. Disa prej rasteve përfshijnë disa tema njëherësh, pavarësisht se këtu, çdo rast dhe çdo veprimtari përqendrohen në një temë të vetme.

Tema	Në klasë	Nenet e konventës	Kazuset	Lëndët
Është jeta ime (identiteti personal, identiteti fetar, identiteti seksual, jeta familjare)	“Jeta ime private”	Neni 2 dhe 8	<i>Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar.</i>	Edukim moral biologji
		Nenet 8, 9 dhe Neni 2 i Protokollit Nr. 1	<i>Folgero dhe të tjerët kundër Norvegjisë</i>	Edukim fetar, qytetari dhe shkenca shoqërore
		Neni 8 dhe 10		Studime për medien
Mos ma bëj një gjë të tillë! (Tortura, trafik njerëzor, mbrojtje nga rreziqet)	“Ngacmim dhe shfrytëzim i personave të dobët”	Neni 3 dhe Neni 2 i Protokollit Nr. 1	<i>Kempbell dhe Kosans kundër Mbretërisë së Bashkuar.</i>	histori, gjuhë dhe letërsi
		Neni 4	<i>Siliadin kundër Francës</i>	Gjeografi, ekonomi

Tema	Në klasë	Nenet e konventës	Kazuset	Lëndët
Si i trajtojmë të tjerët? (Diskriminim, abuzim, dhunë në shtëpi)	“Mos diskriminimi ndaj grupeve minoritare, respekti për vlerat e të tjerëve, ndërmarrja e veprimeve pozitive kundër keqtrajttimeve dhe stereotipave, respektimi i diversitetit”	Neni 14 dhe Neni 2 i Protokollit Nr. 1	<i>D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke</i>	Studime moderne, histori, shkenca politike, shkenca shoqërore
		Neni 9 dhe Neni 2 i Protokollit Nr. 1	<i>Lejla Shahin kundër Turqisë</i>	Edukim fetar, sociologji
		Neni 2, 3 dhe 14	<i>Opuz kundër Turqisë</i>	Shkenca shoqërore
Unë dua një zë (liria politike, intoleranca)	“Përgatitja e të rinjve për qytetari, përmes pjesëmarrjes aktive”	Neni 11 dhe 14	<i>Aleksei kundër Rosisë</i>	Shkenca politike, studime fetare, studime moderne
		Neni 10	<i>Xhersild kundër Danimarkës</i>	Studime për medien
Drejtësi për të gjithë (drejtësi, dëgjim, ndëshkim)	“Respekti për dinjitetin njerëzor, respekti për rregullat, ndëshkimi i shkelësve të rregullave?”	Neni 3 dhe 5	<i>Groni kundër Shqipërisë</i>	Qytetari
		Neni 3 dhe 6	<i>Gufen kundër Gjermanisë</i>	Filozofi, etikë


3.1.1. Tema 1 – Është jeta ime



Kjo temë hedh dritë mbi faktin që të drejtat e njeriut mbrojnë aspekte thelbësore të identitetit tonë:

- ▶ Familja jonë dhe aftësia jonë për të formuar marrëdhënie;
- ▶ Identiteti ynë personal
- ▶ Identiteti ynë seksual
- ▶ Besimet dhe vendimet tona


3.1.2. Tema 2 – Mos ma bëj një gjë të tillë!



Kjo temë ka të bëjë me ndërhyrjen e shtetit në integritetin tonë fizik dhe mendor:

- ▶ Nëse shteti vret një individ.
- ▶ Nëse shteti na burgos ose plagos.
- ▶ Nëse të tjerët na lëndojnë dhe shteti (domethënë policia) nuk na mbron.


3.1.3. Tema 3 – Si i trajtojmë të tjerët?



Kjo temë lidhet me çështjen e mënyrës si ne lidhemi me njerëzit që janë ndryshe nga ne. A i trajtojmë ata ndryshe? A i respektojmë besimet e të tjerëve? Po me njerëzit


- ▶ Nga raca të ndryshme?
- ▶ Nga vende të ndryshme?
- ▶ Me besime të ndryshme?
- ▶ Me miqtë dhe anëtarët e familjes?

3.1.4. Tema 4 – Unë dua një zë!



Demokracitë kanë nevojë për aktivistë. Demokracitë përparojnë nga liria e fjalës dhe protesta. Por, siç tregojnë edhe shumë ngjarje të sotme nga bota, qeveritë, ndonjëherë, kundërpërgjigjen jo në mënyrën e duhur, madje me shtypje.

3.1.5. Tema 5 – Barazi për të gjithë



Cila është mbrojtja për të cilën kam nevojë për të siguruar që drejtësia, jo vetëm të realizohet, por edhe të kuptohet që realizohet, në rastet kur unë bëj diçka të gabuar ose akuzohem se kam bërë diçka të tillë? Në çfarë rrethanash shteti ka të drejtë të kufizojë lirinë time, duke më burgosur? Si duhet të ndëshkohem dhe si duhet të ndëshkojmë të tjerët për shkeljet e rënda?

3.2. Tema 1 – Është jeta ime

Hyrje te tema dhe çështjet

Tri rastet e zgjedhura përfaqësojnë aspekte të ndryshme të identitetit tonë dhe të asaj që duhet të bëhemi:

- ▶ Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar: Pëlqimi i kujt duhet të merret parasysh për të krijuar një familje?
- ▶ Folgero dhe të Tjerët kundër Norvegjisë: A duhet që shteti (përmes shkollimit) të formojë bindjet tona?
- ▶ Von Hanover kundër Gjermanisë: Çfarë duhet të shohin dhe të lexojnë të tjerët për ne?

Këto raste studimore dhe të drejtat që ato përfshijnë zbatohen tek ju, nga mënyra si ju, në shtëpi, flisni me prindërit për mënyrën si ju lidheni me shokët drejtpërdrejt ose në Facebook

► **Evans kundër Mbretësisë së Bashkuar**

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-80046#{"itemid":\["001-80046"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-80046#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Aplikanti

Znj. Natali Evans, e lindur në tetor 1971, në Mbretërinë e Bashkuar

Arsyetimi

Ky rast është përzgjedhur pasi pasqyron vështirësinë e balancimit të të drejtave diametralisht të kundërta të dy personave. Në themel parashtrahet mosmarrëveshja ndërmjet një gruaje, e cila dëshironte të bëhej nënë (nëpërmjet farëzimit artificial – fertilizim in vitro), dhe ish partnerit të saj, i cili kishte tërhequr mbrapsht lejen e dhënë që sperma e tij të përdorej në këtë proces.

FIV: fertilizimi in vitro është procesi, nëpërmjet të cilit veza fekondohet nga sperma jashtë trupit të femrës (in vitro -“në xham”). Pasardhësit që ngjizen njihen jo-zyrtarisht me termin “bebe provëz”.

Faktet

Qershor 2000: Natalie Evans dhe Howard Johnston u fejuan.

Tetor 2001: Znj Evans zbuloi gjatë një kontrolli shëndetsor se kishte tumorre në vezoret e saj.

Nëntor 2001: Znj Evans i'u nënshtrua një trajtimi FVI; 11 nga vezët e saj u nxorën dhe u fertilizuan duke përdorur spermën e Z. Johnston; gjashtë embrione u ngrinin dhe u vendosën në bankë për ruajtje.

Nëntor 2001: Znj. Evans i'u hoqën vezoret.

Maj 2002: Çifti u nda. Menjëherë pas ndarjes, Z. Johnston i shkroi klinikës një letër ku kërkonte që embrionet të shkatërroheshin.

Korrik 2002: klinika informoi Znj. Evans në lidhje me kërkesën e Z. Johnston.

Beteja ligjore

Znj Evans nisi një betejë ligjore me argumentimin se nëse ajo do të kishte ngelur shtatzënë në mënyrë natyrore, çka do të thotë, me embrionet brenda trupit të saj, atëherë partneri i saj nuk do të ishte në gjendje ta ndalonte procesin.

2003 deri në 2004: gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar i hodhën poshtë argumentet e Znj. Evans, duke deklaruar se, sipas ligjit të MB, embrionet duhet të shkatërroheshin.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore që iu parashtruan Gjykatës

Ankuesja pretendonte se ishin shkelur nenet e mëposhtme të Konventës:

Neni 2: E drejta për jetën

E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykate pas dënimit për një krim për të cilin dënimi është parashikuar me ligj.

Ankuesja pretendonte se embrionet e saj e kishin "të drejtën e jetës" dhe se kjo ishte në kompetencat e Gjykatës, që duhet të shqyrtonte nëse kjo e drejtë zbatohet në këtë rast.

Neni 8: E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Ankuesja pretendonte se ajo kishte të drejtë që të zgjidhte të fillonte një jete familjare. Shteti mund të ndërhynte tek kjo e drejtë vetëm nëse plotësoheshin kushtet e paragrafit 2 të Nenit 8.

Gjykata duhet të vendoste nëse ligji – i cili thotë se, në qoftë se dhuruesi i spermës e refuzon lejen, atëherë embrionet duhet të shkatërrohen – i shte i ekuilibruar në lidhje me balancimin e të drejtave të ankueses dhe të drejtave të ish partnerit të saj.

Përgjigja e Gjykatës dhe parimet themelore

Neni 2

Sipas legjislacionit Britanik, embrionet nuk kanë të drejta ose interesa të pavarur. Në mungesë të një konsensusi pan Evropian në lidhje me këtë çështje, Gjykata duhet t'i akordojë një "hapësirë shumë të gjerë vlerësimi" edhe pikëpamjeve të ligjvënësve Britanikë. Thënë kjo, nuk ka pasur shkelje të Nenit 2.

Neni 8

Ligji që lejon shkatërrimin e embrioneve, nëse njëra nga palët ka revokuar pëlqimin e dhënë, ka pasur mbështetje gjithëpërfshirëse politike në momentin e krijimit, duke kërkuar mbështetjen e të dyja partive kundërshtarë me qëllim garantimin e sigurisë juridike gjithë përfaqësuese. Gjykata nuk ishte e gatshme që të përfshihej në një çështje private, mosmarrëveshje ndërmjet dy personave, ku secila palë kishte qëndrime të kundërta dhe përpiquej të përfitonte nga zbatimi i të drejtave diametralisht të kundërta. Nëse Gjykata do të konstatonte shkelje të Konventës, efektivisht, ajo do të shprehej se roli i burrit në procesin e lindjes së fëmijës me metodën FIV përfundonte në momentin kur veza do të fekondohej. Në këtë zonë të vështirë të politika-bërjes,

Gjykata sërish lëshoi pe në favor të ligjvënësve Britanikë dhe vendosi që nuk kishte shkelje të Nenit 8.

Çfarë ndodhi më pas?

Meqë gjykata nuk gjeti shkelje të Konventës, nuk kishte as arsye për të ndërmarrë masa për këtë.

Pjesa B. Veprimtaritë mësimore

Hyrje: Ky mësim shqyrton të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare.

Koncepti/Tema: Konflikti i dy të drejtave të Konventës. Si e shqyrton Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut këtë konflikt.

Objektivat e të mësuarit

Qëllimi kryesor është që nxënësit të njihen me Konventën dhe me punën e Gjykatës. Kjo veprimtari synon t'u japë nxënësve mundësinë:

- ▶ të njihen me rëndësinë e të drejtës për një jetë private dhe për një familje;
- ▶ të njihen me kufizimet dhe konfliktet e mundshme të të drejtave që lidhen me këtë çështje
- ▶ të shprehin pikëpamjet e tyre në lidhje me këto çështje;
- ▶ të mësojnë të identifikojnë informacionin e duhur nga një akt ligjor.

Kohëzgjatja: 45 minuta

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
5'	1. Hyrje – Evans kundër MB Mësuesi njih nxënësit me të drejtën për një jetë private dhe për një familje, sipas konventës. Më pas ai paraqet rastin e Znj Evans.		
30'	2. Punë në grup Mësuesi i njih nxënësit me detyrën: Ata duhet të simulojnë një parlament: <ul style="list-style-type: none">▶ Mësuesi vizaton një diagram në dërrasën e zezë dhe jep udhëzimet;▶ Nxënësit përfaqësojnë një parlament, i cili duhet të vendosë për mënyrën e rregullimit të proceseve FIV (pëlqimi i kujt kërkohet për futjen e embrionit në trupin e një femre dhe kush mund ta tërheqë këtë pëlqim?);▶ Nxënësit mund të zgjedhin alternativat e mëposhtme:<ul style="list-style-type: none">– Kërkohet marrëveshja e të dyve (të dy mund të tërheqin pëlqimin e tyre; kjo shënohet si "BG");	E gjithë klasa Punë në grup	Materiale për nxënësit dhe mësuesit, pyetje më diskutim

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
	<ul style="list-style-type: none"> – Kërkohet pranimi i njërit: <ul style="list-style-type: none"> - Pëlqimi i secilit (kur pëlqimi mund të tërhiqet nga të dy palët, të shënohet me “B/G”). - Vetëm pëlqimi i gruas (kur pëlqimi mund të tërhiqet vetëm nga gruaja, të shënohet me “G”). - Vetëm pëlqimi i burrit (kur pëlqimi mund të tërhiqet vetëm nga burri, të shënohet me “B”). – Pasi krijohet embrioni, nuk kërkohet më pëlqim (në rastin kur, as burri, as gruaja nuk mund të tërheqin pëlqimin e tyre, të shënohet me 0). ▶ Përpara votimit, mësuesi nxit diskutimin për secilën nga alternativat; ▶ Nxënësit votojnë për ligjin e ri, ndërkohë që mësuesi paraqet rezultatet e vendimit në klasë. 		
10'	<p>3) Diskutim me klasën</p> <p>Nxënësit mbrojnë argumentet për qëndrimin e zgjedhur prej tyre në simulimin e parlamentit.</p>		

B.2. Materiale

Fleta e punës 1: Bazat e fertilizimit in vitro dhe çështjet për parlamentin”

Fertilizimi in vitro (FIV) ose fertilizimi jashtëtrupor përfshin fertilizimin me ndihmë biomjekësore. Ky është një proces në të cilin qelizat e dy dhuruesve (një burri dhe një gruajë) merren dhe bashkohen jashtë trupit të gruas, për të krijuar një embrion, që më pas mbillet në trupin e saj.

Nxënësit luajnë rolin e një parlamenti. Ata diskutojnë për rregullat e pëlqimit në lidhje me FIV, pasi në kohën që merren qelizat e burrit dhe të gruas, kërkohet pëlqimi i të dyve. Çështja këtu qëndron: pëlqimi i kujt kërkohet për përdorimin e qelizave (që hyjnë në trupin e femrës)?


Alternativat janë dy:

- ▶ Kërkohet marrëveshja e të dyve (të dy mund të tërheqin pëlqimin e tyre) (BG)
- ▶ Kërkohet pëlqimi i njërit:
 - Pëlqimi i secilit (kur pëlqimi mund të tërhiqet nga të dy palët, të shënohet me “B/G”).

- Vetëm pëlqimi i gruas (kur pëlqimi mund të tërhiqet vetëm nga gruaja, të shënohet më "G").
- Vetëm pëlqimi i burrit (kur pëlqimi mund të tërhiqet vetëm nga burri, të shënohet më "B").
- ▶ Pasi krijohet embrioni, nuk kërkohet më pëlqim (në rastin kur, as burri, as gruaja nuk mund të tërheqin pëlqimin e tyre, të shënohet me 0).

Skema

Pas krijimit të një embrioni, tërheqja e pëlqimit nga secilin partner mund të ndikojë në vazhdimin e trajtimit të FIV (kjo do të thotë se, pëlqimi mund të tërhiqet përpara futjes së embrionit në trupin e gruas) Ligji mund: të kërkojë pëlqimin e të dy palëve; vetëm të një pale; ose të mos kërkojë pëlqimin e asnjërës prej palëve.



Shembuj pyetjesh

Më poshtë janë disa shembuj pyetjesh për situatat kur të dy palët japin pëlqimin e tyre:

- ▶ A është e rëndësishme autonomia e individëve në një shoqëri demokratike?
- ▶ A është e nevojshme për secilin të jetë i gjendje të vendosë për të pasur ose jo fëmijë dhe pse?

Pyetje të mundshme për situatat kur vetëm njëra nga palët mund të japë pëlqimin:

- ▶ Cili prej interesave duhet të ketë peshën më të madhe në vendimmarrje, i burrit apo i gruas? Përse?
- ▶ A mund t'i kërkohet partnerit që kërkoi tërheqjen e pëlqimit, por që nuk qe në gjendje të ndalonte lindjen e fëmijës, të kujdeset për të, madje edhe financiarisht?

- ▶ A mund të regjistrohet zyrtarisht, si babai ose si nëna e fëmijës, personi që ka refuzuar të japë pëlqimin?
- ▶ A ka të drejtë personi që kundërshton FIV të kujdeset për fëmijën?
- ▶ Sa rëndësi ka interesi i atyre që nuk dëshirojnë të kenë fëmijë?

Pyetje të mundshme për situatat kur asnjëra nga palët nuk jep pëlqimin:

- ▶ A mund të quhet qenie njerëzore një embrion në nivelin e pak qelizave dhe, për këtë arsye, duhet të mbrohet nga e drejta njerëzore e jetës?

Pyetje për të gjithë:

- ▶ A e merrni parasysh faktin që, për situata të tilla, ekzistojnë rregulla të qarta dhe se të gjithë pjesëmarrësit informohen paraprakisht për alternativat që kanë, përpara se të fillojnë një procedurë? Apo duhet të ekzistojë një komision, i cili të marrë vendimet në përputhje me rrethanat e rastit?
- ▶ Nëse mendoni se duhet të ekzistojë një komision i tillë, çfarë duhet të marrë parasysh ai kur të vendosë për lindjen e një fëmije?

► Folgero dhe të tjerët kundër Norvegjisë

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-81356#{"itemid":\["001-81356"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-81356#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Ankuesit, përfshirë Znj. Folgerø, ishin prindër të nxënësve të cilëve u ishte kërkuar që të ndiqnin një lëndë të titulluar "KRL", lëndë e cila mbulonte edukimin fetar dhe filozofik, me theks të veçantë dhe vëmendje të zgjeruar tek Krishterimi Luterian. Ankuesit ishin Humanistë dhe anëtarë të Shoqatës Humaniste Norvegjeze.

Arsyetimi

Ky rast është përzgjedhur pasi pasqyron nivelin e lartë të vëmendjes që duhet ti kushtohet pikëpamjeve të prindërve të ndryshëm gjatë hartimit të kurrikulave shkollore, si dhe detyrimin që ka shteti për të garantuar respektimin e pikëpamjeve të prindërve.

Faktet

Humanizmi: Një qëndrim filozofik dhe etik që thekson vlerat e qenieve njerëzore. Në përgjithësi ai parapëlqen mendimin kritik dhe faktet mbi idetë dhe besimin fetar.

Përpara vjeshtës së vitit 1997: Prindërit mund të bënin kërkesë për të përjashtuar fëmijët nga mësimi i krishterë në shkollë.

Vjeshtë 1997: Kurrikula e arsimit bazë të Norvegjisë ndryshoi me dy lëndë të veçanta. "Krishterimi dhe filozofia e jetës" u zëvendësua nga një lëndë e vetme me titull KRL (që mbulonte krishterimin, fenë dhe filozofinë).

Prindërit kishin të drejtë të kërkonin përjashtimin e fëmijëve të tyre nga pjesë të kësaj lënde. Madje, disa prej tyre dëshironin të siguroheshin që fëmijët e tyre të mos ndiqnin asnjë pjesë të saj.

Beteja ligjore

1998: një grup prindërisht u përpoqën të sfidonin kurrikulat shkollore në Norvegji, duke përdorur rrugët gjyqësore.

2007: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e dha vendimin e saj bazuar në sa më poshtë:

- një grup prindërisht, anëtarë të Shoqatës Humaniste Norvegjeze, dhe fëmijët e tyre (të cilët në atë kohë ndiqnin shkollën fillore) iu drejtuan Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

- ▶ Gjykata u shpreh se KRL ishte fokusuar së tepërmi tek Krishterimi dhe se sistemi i përjashtimeve të pjesshme, në këtë kontekst, nuk ishte i mjaftueshëm. Për këtë arsye ka pasur shkelle të Neni 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

Baza ligjore dhe çështjet kryesore që iu parashtruan Gjykatës

Neni 8: E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 9: Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.
2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 2, Protokoll Nr. 1: E drejta për arsimim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Sipas këtyre neneve, Gjykata duhet të merrte në shqyrtim:

- ▶ nëse KRL u mësohej nxënësve në mënyrë objektive, kritike dhe pluraliste;
- ▶ nëse përjashtimet e pjesshme i kishin dhënë peshë sa duhet pikëpamjeve dhe besimeve të prindërve.

Përgjigja e Gjykatës dhe parimet themelore

Gjykata nuk e shqyrtoi çështjen sipas Neneve 8 dhe 9, me bindjen juridike se Neni 2 i Protokollit Nr. 1 ishte në fakt pika më e rëndësishme (dhe se çdo shkelle e këtij neni do t'u siguronte palës ankuese vendimin të cilin ata po kërkonin nga Gjykata).

Gjykata shqyrtoi masat dhe procedurat e brendshme si dhe kurrikulën e KRL. Ajo u shpreh se ekzistonin dallime cilësore dhe sasiore ndërmjet mësim-dhënies së Krishterimit dhe besimeve të tjera fetare. Krishterimi zinte gjysmën e hapësirës së lëndës, ndërsa besimet e tjera përfaqësoheshin në mënyrë shumë marginale.

Gjykata, më pas, u shpreh se sistemi për përjashtimet e pjesshme nga KRL ishte i pamjaftueshëm. Sipas saj, prindërit e shqetësuar do të duhet të ecnin në një hap me kurrikulën javore dhe planet mësimore - të cilët mund të ndryshonin

Liritë-Veprimtari mësimore për çështje ligjore, për shkollat e mesme ▶ Faqe 40

shumë nga shkolla në shkollë dhe nga mësuesi në mësues. Për më tepër, prindërve mund t'u kërkohej të zbulonin informacione me karakter të ndjeshëm për jetën e tyre private, lidhur me besimin fetar, me qëllim justifikimin e përjashtimit të pjeshëm. Kjo mund të ndodhë nëse prindërit do të ndjehen të detyruar të justifikojnë përjashtimin, nëpërmjet aludimit për besimin e tyre fetar. Gjykata besonte se kjo e zvogëlonte qëllimin e përjashtimit. Për më tepër, stili i mësimdhënies me ngarkesë të diferencuar, i bazuar tek mësuesit individualisht, mund të dekurajonte prindërit nga të kërkuarit e përjashtimit.

Për këto arsye, ka pasur shkelje të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1.

Çfarë ndodhi më tej?

Fëmijët e ankuesve nuk ishin më të detyruar të ndiqnin lëndën. Rrjedhimisht, nuk mund të merreshin masa të veçanta.

Sa i përket masave të përgjithshme, edhe përpara se të jepej ky vendim, Norvegjia e kishte amenduar Ligjin e saj të Arsimit, duke e hequr referencën ndaj Krishterimit, si pikë referuese për lëndën KRL, si dhe duke hequr detyrimin për justifikim nga prindi, për përjashtim nga detyrimi për të ndjekur lëndën. Në vijim të gjykimit, Norvegjia e ndryshoi titullin e lëndës KRL, duke specifikuar se lënda e re duhej të paraqitej në një mënyrë objektive kritike dhe pluraliste, në përputhje me të drejtat e njeriut. Janë hartuar edhe dispozita të tjera me qëllim garantimin e respektimit të bindjeve personale të nxënësve dhe prindërve të tyre.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Koncepte/tema: feja në klasë, indoktrinimi

Objektivat e të mësuarit

Njohuri dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të përshkruajë mënyrën si Gjykata zbaton Neni 2 të Protokollit Nr. 1 dhe konceptin e indoktrinimit;
- ▶ të tregojë rëndësinë e diversitetit kulturor në arsim dhe shoqëri;
- ▶ të shpjegojë rëndësinë e harmonizimit të interesave konkurruese në një shoqëri shumëkulturëshe.

Aftësi

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë situatat që mund të shkaktojnë lindjen e shqetësimeve nga pakicat fetare, veçanërisht ato që, në fushën e arsimit, ngrihen deri në indoktrinim;
- ▶ të marrë pjesë në diskutime për harmonizimin e interesave të pakicave me ato të shoqërisë më të gjerë;
- ▶ të harmonizojë interesat konkurruese, të paktën në parim.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të vlerësojë rëndësinë e të qenit i paanshëm në arsim, në mënyrë të veçantë në lidhje me fenë;
- ▶ të vlerësojë rëndësinë e lëshimeve që bëhen në emër të larmisë kulturore.

Kohëzgjatja: 45 minuta







B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit-veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
5'	1. Diskutim për fenë dhe arsimin Mësuesi drejton diskutimin në klasë përmes pyetjeve të mëposhtme: <ul style="list-style-type: none">▶ a duhet që të gjithë fëmijët të mësohen të mendojnë të njëjtën gjë?▶ Çfarë ndodh me shoqërinë kur mungon diversiteti kulturor?▶ Çfarë ndodh me individët kur nuk janë në gjendje të ndjekin besimet e tyre?	E gjithë klasa	

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
20'	<p>2. Folgero dhe të tjerët kundër Norvegjisë</p> <p>Mësuesi shkruan pyetjet e pohimet e mëposhtme në tabelë:</p> <p>“Me gjithë faktin që interesat individuale duhet, me raste, t’i nënshtrohen atyre të grupit, demokraci nuk do të thotë, thjesht, që pikëpamjet e shumicës duhet të sundojnë gjithnjë. Për të garantuar trajtimin e duhur dhe të paanshëm të pakicave dhe për të shmangur abuzimet e pozitive sunduese është e nevojshme që interesat të harmonizohen”. (Paragrafi 84(f) Folgero dhe të tjerët kundër Norvegjisë).</p> <p>Mësuesi e shpjegon pohimin në klasë.</p>	E gjithë klasa	
10	<p>3. Në grupe të vogla, nxënësit lexojnë fletën e punës 1 dhe 2 dhe diskutojnë rezultatet e çështjes.</p>	Punë në grup	Fleta e punës 1 dhe 2
5'	<p>4. Kuptimi i indoktrinimit</p> <p>Në grupe me 4 ose 5 veta, nxënësit prodhojnë një hartë mendore për konceptin “indoktrinim”.</p> <p>Ata nxiten të vendosin sa më shumë informacion në letër, duke përdorur përcaktimet ligjore dhe jo ligjore të termit.</p>	Punë në grup	
5'	<p>5. Diskutim me të gjithë klasën</p> <p>Kuptimi i indoktrinimit</p>	E gjithë klasa	


B.2 Materiale

Fleta e punës 1 – Folgero dhe të tjerët kundër Norvegjisë

		
<p>Norvegjia ka një popullatë të krishterë –rreth 85% është e besimit luteran.</p>	<p>Feja mësohet në shkollë. Fetë që mësoheshin në shkollë kanë qenë disa, por krishterimit i është dhënë më shumë rëndësi</p>	<p>Znj. Folgero, duke mos qenë e krishterë, nuk dëshiron që fëmijët e saj të marrin pjesë në klasat fetare dhe kërkon përjashtimin e tyre plotë.</p>
		
<p>Përjashtimet e plotë nuk lejohen. Për përjashtimet e pjesshme duhen dhënë arsye të forta. Znj. Folgero mund t'i kërkojë të zbulojë informacionin e ndjeshëm për besimet e saj.</p>	<p>Përjashtimi i pjesshëm do të kërkonte nga Znj. Folgero që të ishte e përditësuar me çdo klasë, një barrë e rëndë kjo për çdo prind.</p>	<p>E pakënaqur, znj. Folgero i drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ajo mendon se fëmijët e saj janë indoktrinuar në fenë e krishterë, kundër dëshirës së saj.</p>

Fletë pune 2. Folgero dhe të Tjerët kundër Norvegjisë: Vendimi


Argumentet në favor të Norvegjisë



Krishterimi është pjesë e jetës për shumë njerëz në Norvegji

Krishterimi është pjesë e rëndësishme e kulturës dhe historisë së Norvegjisë.

Argumentet në favor të aplikantit




Të përjashtuarit po vëzhgojnë. Kjo është një lloj si të marrësh pjesë.

Një prind duhet të zbulojë shumë informacione vetjake për një përjashtim.

Krishterimi përbën rreth 50% të klasave- ata po thellohen më shumë se çdo fe tjetër.

Prindërit nuk dëshirojnë të shqetësojnë një mësues në mënyrë të vazhdueshme

Dhoma e Madhe e Gjykatës votoi. Nëntë gjykatës shohin shkelje të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1, ndërsa tetë thonë se nuk ka shkelje.



Norvegjia nuk e ka respektuar të drejtën e prindërve për të siguruar arsimim dhe mësimdhënie në përputhje me besimet e tyre.

► Von Hanover kundër Gjermanisë

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-61853#{"itemid":\["001-61853"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-61853#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Karolina, Princesha e Hanover-it, vajza e madhe e Princit Rainier i III i Monakos.

Arsyetimi

Ky rast është përzgjedhur pasi pasqyron një çështje të ditës dhe një të drejtë të rëndësishme, siç është ajo e privatësisë së personave publikë ose/dhe atyre të famshëm, nga njëra anë, dhe të drejtën e gazetarëve dhe personave të tjerë për t'u shprehur lirisht, në anën tjetër.

Faktet

Kjo çështje ka të bëjë me vështirësinë që paraqet balancimi i të drejtës që ka media për t'u shprehur lirisht (e mbrojtur sipas Nenet 10 të Konventës) me të drejtën e individëve për të pasur një jetë të qetë private (Neni 8).

Princesha Karolina e Hanoverit, vajza e madhe e Princit Rainier i III i Monakos, ka lindur në vitin 1957.

Vendbanimi i saj zyrtar është në Monako por ajo në pjesën më të madhe të kohës jeton në Paris. Si anëtare e familjes mbretërore, ajo është presidente e shumë fondacioneve dhe organizatave, por nuk kryen asnjë funksion në emër të vetë shtetit.

Ndërmjet 1993 dhe 1997: revista Gjermane Neue Post publikoi shumë fotografi të Princeshës Karolina në vende të ndryshme, duke përfshirë:

- ▶ në një restorant me një aktor;
- ▶ hipur mbi kalë;
- ▶ me fëmijët e saj;
- ▶ me bashkëshortin duke bërë ski;
- ▶ në një shfaqje kuajsh;
- ▶ duke u larguar nga shtëpia e saj;
- ▶ duke luajtur tenis me Princin Ernst August Von Hannover;
- ▶ në një klub plazhi, e veshur vetëm me rroba banje.

Beteja ligjore

1993 dhe 2000: Princesha Karolina e Hanoverit hapi një numër të madh procesesh gjyqësore në Gjermani. Gjykatat gjermane u shprehën se, si figurë publike që ishte,

ajo duhej të toleronte publikimin e fotove të saj, edhe nëse ato ishin bërë në ambiente dhe momente private.

24 Qershor 2004: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që:

- ▶ pavarësisht se fotografët "paparazzi" kishin të drejtën e lirisë së shprehjes nëpërmjet publikimit të fotove, disa nga fotot, të cila përmbanin dhe shfaqnin informacion shumë personal ose edhe intim, dhunonin të drejtën e Princeshës për të pasur një jetë private;
- ▶ publiku i gjerë nuk ka pasur interes të ligjshëm për të pasur njohuri në lidhje me vend ndodhjen e saj apo mënyrën se si ajo sillen në jetën e saj private.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore që iu parashtruan Gjykatës

Neni 8: E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 10: Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Pyetja kryesore parashtruar Gjykatës ishte nëse publikimi i fotografive të mbrojtura në bazë të Nenit 10, liria e shprehjes, mund të balanconte ndërhyrjen me Nenin 8, të drejtën e ankueses për jetë private.

Përgjigjja e Gjykatës dhe parimet themelore

Gjykatat e brendshme ishin shprehur se media ishte e justifikuar në publikimin e fotografive sepse ankuesja ishte "figurë e shoqërisë bashkëkohore". Gjykata Evropiane të Drejtave të Njeriut nuk ishte dakord me këtë gjë.

Gjykata u shpreh se gjykatat e brendshme kishin gabuar duke justifikuar sjelljen e gazetarëve paparazzi thjesht dhe vetëm se ankuesja ishte figurë publike në një shoqëri bashkëkohore. Legjislacioni që i lejon gazetarëve "paparazzi" të fotografojnë dhe

të publikojnë fotografitë e personave publikë nuk mund t'i mbivendosej të drejtës legjitime që ankuesja ka për një jetë të qetë private; shumica e këtyre fotografive të shkrepura fshehurazi në vende ku Princesha nuk priste apo nuk hamendësonte se do të fotografohej.

Të drejtat, sipas KEDNj, duhet të jenë “praktike dhe efektive”, çka do të thotë, ndërhyrja në jetën private të ankueses nuk mund të justifikohet. Për rrjedhojë, ka patur shkelje të Nenit 8 të KEDNj.

Çfarë ndodhi më tej?

Pavarësisht suksesit në këtë rast, Princesha Karolina i është drejtuar edhe tre herë të tjera deri tani Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në këtë betejë të gjatë kundër mediave. Në rastin e dytë dhe të tretë, që gjithashtu përfshinin revista Gjermane të cilat kishin publikuar fotografi të saj, duket se Gjykata ka pasur një qasje të ndryshme, duke e fokusuar diskutimin në pesë kriteret e mëposhtme:

- ▶ nëse informacioni/imazhet kontribuonin për hapjen e një debati me interes të gjerë publik;
- ▶ niveli i famës së personit në fjalë;
- ▶ sjellja paraprake e personit në fjalë;
- ▶ përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit;
- ▶ rrethanat në të cilat fotot ishin bërë.

Në çështjet e mëvonshme, Gjykata është përqendruar më tepër në faktin që Princesha është, në fakt, “figurë publike” dhe, për rrjedhojë, ndërhyrja në jetën e saj private, nëpërmjet publikimit të fotove, është e justifikuar, me përjashtim të rasteve kur ka arsye të forta për të dëshmuar të kundërtën.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Konceptet/temat: të kuptuarit e jetës private dhe familjare dhe e drejta për lirinë e shprehjes si dhe të mësuarit për konfliktet e mundshme ndërmjet këtyre të drejtave.

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të përshkruajë fushën e veprimit të neni 8 (e drejta për jetë private dhe familjare) i Konventës;
- ▶ të shpjegojë si interpretohet neni 8 nga Gjykata;
- ▶ të shpjegojë kur shteti ndërhyt ligjërisht në çështjet që mbulon neni 8;
- ▶ të identifikojë shkeljet e nenit 8 dhe neni 10.

Aftësi

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë argumentet e të dy palëve;
- ▶ të komunikojë me efektivitet një argument;
- ▶ të dëgjojë dhe të respektojë pikëpamjet e ndryshme;
- ▶ të dallojë shkeljet e nenit 8 dhe neni 10.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të vlerësojë rëndësinë e nenit 8 dhe të nenit 10 të Konventës.

Kohëzgjatja: 45 minuta

B. 1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
5'	1. Jeta private dhe familjare Paragrafi 1 i nenit 8, i Konventës projektohet në mur. Mësuesi pyet nxënësit të ngrihen në këmbë dhe të tregojnë dy skajet e dhomës: njëri skaj është "PO" dhe tjetri është "JO". Pasi mësuesi lexon pyetjet e fletës së punës, nxënësit përcaktojnë qëndrimin e tyre dhe vendosen në ose ndërmjet dy skajeve të dhomës. Pasi nxënësit të kenë përcaktuar pozicionet, mësuesi kërkon prej tyre të shpjegojnë zgjedhjen e bërë.	E gjithë klasa	

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
5'	Mësuesi pyet klasën për situatën në të cilën ata mendojnë se shteti mund të lejohet të ndërhyjë në privatësinë e tyre. Mësuesi projektton pjesën e dytë të nenit 8 dhe fton klasën në diskutimin për situatat kur ndërhyrja e shtetit gjykohet e pranueshme.	E gjithë klasa	
10'	2. Liria e shtypit Çështjet e mëposhtme duhet të diskutohen në klasë: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Përse është e rëndësishme liria e shtypit në një shoqëri demokratike? Jepni disa shembuj nga jeta e përditshme. ▶ Përse është e rëndësishme jeta private? ▶ Cila nga liritë e mësipërme: liria e shprehjes apo privatësia, është më e rëndësishme? ▶ A duhet lejuar shteti të kufizojë këto liri? 	E gjithë klasa	
10	2. Neni 10 i Konventës projektohet në mur. Mësuesi pyet nxënësit nëse struktura e nenit u duket e njohur dhe shpjegon që ajo vepron njëjllë si neni 8 i saj (për shembull, paragrafi 2 përmban rastet e përjashtimit). Mësuesi i pyet nxënësit se çdo të thotë liri e shprehjes dhe ku zbatohet ajo në jetën e përditshme (për shembull, në gazeta, politikë, besimet fetare, protestat etj.).	E gjithë klasa	
15'	Në grupe prej 3-4 vetash, nxënësit u përgjigjen pyetjeve të fletës së punës.	Punë në grup	Fleta e punës

B.2. Materiale

Fleta e punës: Çështja e Von Hanoverit kundër Gjermanisë

Princesha e Monakos, Karolina, u përpoq të ndalojë publikimin e fotove të saj dhe të familjes në gazeta. Deri tani janë publikuar një numër i madh fotosh, përfshirë edhe ato kur ajo ka qenë me pushime me familjen, duke ngarë kuajt dhe duke ndjekur angazhimet e saj private dhe sociale. Fotot janë marrë pa lejen e saj dhe ajo nuk ka pranuar publikimin e tyre.

Pyetje

1. A përfshin ky skenar nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)?
2. A përfshin ky skenar nenin 10 të KEDNJ?
3. Nëse po, cili është më i rëndësishëm sipas mendimit tuaj?
4. Cili ishte rezultati i çështjes sipas jush?
5. A ka rëndësi fakti që princesha Karolinë është një figurë publike dhe njeri i shquar?

Udhëzime - Loja e pozicioneve

1. A ekziston ndonjë ligj që e bën homoseksualitetin të paligjshëm, në shkelje të nenit 8 të KEDNJ?

Po.

Shembull: Në çështjen Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, ligjet në Irlandën e Veriut e bëjnë homoseksualizmin të paligjshëm dhe në shkelje të nenit 8 të konventës.

2. A është shkelje, sipas nenit 8 të Konventës, mohimi i të drejtës ligjore të dikujt për të ndryshuar gjininë?

Po

Shembull: Që me rastin e Kristina Guduin kundër Mbretërisë së Bashkuar, ekziston një detyrim pozitiv i shtetit për të ndryshuar regjistrin e lindjes ose për të lëshuar një certifikatë të ndryshuar lindjeje. Kjo të çon në Aktin për Njohjen e Gjinisë, 2004 në Mbretërinë e Bashkuar.

3. A dështon një qeveri në përpjekjet e saj për të ndaluar ndotjen e madhe në rritje pranë banesave të njerëzve duke shkelur në këtë rast nenin 8 të Konventës?

Po

Shembull: Në çështjen Lopez kundër Spanjës, shtetit iu kërkua të ndërmerre masa për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtës së ankueses për të respektuar jetën private të saj dhe të familjes.

4. Çfarë natyre ka informacioni që ne publikojmë në facebook: privat apo publik?

Për këtë nuk ka përgjigje të saktë, thjesht synon të nxisë diskutimin.

3.3. Tema 2 – Mos ma bëj një gjë të tillë!

3.3.1. Hyrje në temë dhe në çështjet përkatëse

- ▶ **Kempbell dhe Kozan kundër Mbretërisë së Bashkuar:** Si mund të disiplinohen fëmijët në shkollë?
- ▶ **Silladin kundër Francës:** A mundet të bëhemi sklevër të dikujt, veçanërisht nën dritën e formave “të reja” të skllavërisë që prekin të rinjtë që janë larg shtëpisë, në botën moderne?

Këto studime rasti ngrenë çështjen si njerëzit e veshur me pushtet trajtojnë dhe ndëshkojnë të rinjtë. A duhet prindërit të kenë të drejtën të godasin fëmijët e tyre? A mbrohen sa duhet nga shfrytëzimi fëmijët nga vendet e varfra? A trajtohen mirë të huajt nga shokët e tyre të klasës?

► **Kempbell dhe Kozan kundër Mbretërisë së Bashkuar**

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-57455#{"itemid":\["001-57455"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-57455#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Znj Grace Campbell dhe Znj. Jane Cosans janë prindër të dy fëmijëve të hequr nga shkolla.

Arsyetimi

Ky rast është i rëndësishëm pasi ishte i pari nëpërmjet të cilit u shqyrtua çështja nëse është i pranueshëm ndëshkimi fizik i fëmijëve në shkolla.

Faktet

Ndëshkimi fizik (trupor): ndëshkimi fizik ka qenë praktikë e zakonshme dhe ligjore në shumë juridiksione gjatë shekullit të 20-të. Në Skoci, ku kjo çështje zuri fill, ndëshkimi fizik përfshinte goditjet me rrip lëkure në pëllëmbët e duarve të nxënësve ose e ashtuquajtura "taëse". Në rast sjellje të pahijshme në klasë ndëshkimi jepej në vend, në prani të dhe në sy të klasës; për sjellje të pahijshme gjetiu apo për shkeljet e rënda të disiplinës, ndëshkimi fizik jepej nga Drejtori apo zëvendësi i tij, në zyrat përkatëse.

Djali i Znj. Campbell, Gordon

Djali i Znj. Kempbell, Gordon ka lindur në 1969.

Deri në 1979: Gordon ndoqi mësimet në një shkollë në Strathclyde, Skoci, shkollë e cila ushtronte ndëshkimin fizik. Znj Kempbell iu drejtua me kërkesë Këshillit, duke kërkuar garanci që djali i saj nuk do të ndëshkohej më në atë mënyrë, por këto kërkesa u refuzuan. Gordon vijoi të ndiqte mësimet në këtë shkollë deri në Korrik 1979. Në fakt, ai nuk u ndëshkua më kurrë në të njëjtën mënyrë.

Djali i Znj. Kozans, Xhefri

Djali i Znj. Kozans, Xhefri ka lindur në vitin 1961.

Deri në 1976: Jeffrey ndoqi mësimet në një shkollë në Fife, Skoci, shkollë që ushtronte,, ndëshkimin fizik.

23 Shtator 1976: Xhefrit iu tha të paraqitej në zyrën e Asistentit të Drejtorit për t'u ndëshkuar. Duke ndjekur këshillën e babait të tij, Xhefri u paraqit në zyrën e Asistentit të Drejtorit, por e refuzoi ndëshkimin. Më pas Xhefri u pezullua nga shkolla dhe nuk u kthye më kurrë në të.

Beteja Ligjore

Legjislacioni Skocez parashikonte se mësimitdhënësit në shkollë kishin të drejtë të përcaktonin masat e nevojshme disiplinore.

30 Mars dhe 1 Tetor 1976: të dy nënat e fëmijëve iu drejtuan Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut (tribunalit të veçantë që në atë kohë shqyrtonte mundësinë e aksesit të individëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut).

25 Shkurt 1982: Gjykata u shpreh se Britania e Madhe duhet të respektonte kundërshtimet e prindërve ndaj ndëshkimeve fizike në shkolla. Duke mos respektuar pikëpamjet e prindërve, Britania e Madhe shkelte Nenin 2 të Protokollit Nr. 1.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore që iu parashtruan Gjykatës

Neni 3: Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Gjykata duhet të shqyrtonte nëse ndëshkimet fizike në shkolla përbënin trajtim çnjerëzor dhe degradues.

Neni 2, Protokoll Nr. 1: E drejta për arsimim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Gjykata duhet të shqyrtonte nëse ekzistenca e ndëshkimeve fizike si masë disiplinore në shkolla, ndëshkime të vuajtura nga fëmijët e ankueseve, shkelte këtë nen si rezultat i kundërvënies ndaj bindjeve filozofike të ankueseve. Është e rëndësishme të theksohet se në fakt asnjë nga fëmijët nuk ishte ndëshkuar fizikisht; por ishte e mundshme që ndëshkimi të përdorej në të ardhmen dhe ky ishte shkaku i ankesës.

Përgjigjja e Gjykatës dhe parimet themelore

Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 3 – ajo nuk besonte se ndëshkimi fizik ishte mjaftueshëm i ashpër për të përbërë trajtim çnjerëzor apo torturë, si dhe konstatoi se nuk kishte prova materiale se kërcënimi për ndëshkim fizik i degradonte nxënësit (është e rëndësishme të theksohet se njëri prej fëmijëve nuk ishte ndëshkuar ndonjëherë në këtë mënyrë; dhe se çështja ishte vetëm tek kërcënimi për një ndëshkim të tillë).

Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1. Xhefri Kozans-it, i cili ishte pezulluar nga shkolla si rezultat i refuzimit të tij për të pranuar ndëshkimin, i ishte

mohuar e drejta e tij për arsimim (shih fjalinë e parë të Nenit 2). Gjykata gjithashtu konstatoi shkelje të fjalisë së dytë të Nenit 2 për të dy ankueset, për shkak se bindjet filozofike të ankueseve (prindërve) nuk u respektuan nga autoritetet shkollore që kur se lejuan ekzistencën e një ndëshkimi të tillë.

Çfarë ndodhi më tej?

Ky gjykim dhe vendimet e tjera të Gjykatës, në lidhje me paditë e bëra nga nxënësit e Britanisë së Madhe dhe prindërit e tyre, udhëhoqi efektivisht rrugën drejt abrogimit të ndëshkimit fizik në të gjitha shkollat shtetërore në Britani në vitin 1987. Megjithatë, deri në vitin 1999, ky lloj ndëshkimi mbeti në fuqi në shkollat private të cilat nuk financoheshin nga buxheti i shtetit.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Hyrje: ky mësim trajton çështjen e ndëshkimeve trupore për fëmijët.

Konceptet/tema: Të drejtat e njeriut që lidhen me ndëshkimet trupore për fëmijët, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me të drejtën për arsimim; E drejta për të qenë i lirë nga tortura dhe trajtimet çnjerëzore dhe rëndësia e të drejtave të fëmijës.

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë çështjet e të drejtave të njeriut që lidhen me ndëshkimin trupor;
- ▶ të shpjegojnë mënyrën e arsytimit të çështjes Kempbell dhe Kozan nga Gjykata;
- ▶ të përshkruajë përmbajtjen dhe zbatimin e nenit 2 të Protokollit Nr.1 dhe nenit 3 të Konventës

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të komunikojë në mënyrë të efektshme një argument;
- ▶ të kritikojë një argument të dhënë dhe të shpjegojë arsyen e saj;
- ▶ të dëgjojë pikëpamjet e të tjerëve.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë dhe të trajtojë çështjet kundërshtuese me maturi dhe logjikë;
- ▶ të vlerësojë rëndësinë e të drejtave të njeriut për fëmijët dhe të rinjtë;
- ▶ të vlerësojë Konventën si një instrumenti gjallë;

Kohëzgjatja: 45 minuta

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
20'	1.Hyrje . Çështja Kempbell dhe Kozan kundër Mbretërisë së Bashkuar <ul style="list-style-type: none">▶ Mësuesi fillon me shpjegimin e konceptit të ndëshkimit trupor dhe, më pas, u kërkon nxënësve të diskutojnë për çështjet që lidhen me ndëshkimin trupor duke u bazuar në njohuritë e tyre paraprake.	E gjithë klasa	Video klip projektor

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Mësuesi shfaq videoklipin për të gjithë klasën. ▶ Ai përshkruan Nenin 2 të Protokollit Nr.1 dhe nenin 3 të Konventës, përpara se t'i pajisë nxënësit me tekstin përkatës. Nxënësve u kërkohet të shpjegojnë mënyrën si zbatohen këto nene në çështjet në fjalë. ▶ Mësuesi shpjegon çështjet kryesore që dalin nga gjykimi dhe simulon diskutimin sa herë që është e mundur. Çështjet kyçe janë: <ul style="list-style-type: none"> – Përse , në rastin tonë, ndëshkimi trupor është shkelje e të drejtës së fëmijës për arsimim? – Përse shkollat shtetërore kanë detyrën të mbrojnë të drejtat e nxënësve? – Përse, në këtë rast, nuk zbatohet e drejta e fëmijës për të qenë i lirë nga tortura, sipas nenit 3? – Në ç'rrethana ndëshkimi trupor përbën shkelje të nenit 3? – Si ndryshon shoqëria në kohë dhe në ç'mënyrë do t'i pasqyrojë Konventa këto ndryshime? (është një instrument i gjallë?) 		
15'	<p>2. Ndëshkimi trupor në këndvështrimin e të drejtave të njeriut; pikëpamjet e feve, kulturave dhe shoqërive të ndryshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Klasa ndahet në grupe me 3 deri 5 vetë dhe çdo grup merr një kopje të fletës së punës 1. ▶ Nxënësit duhet të marrin parasysh faktet në fletën e punës 1 dhe të arrijnë në një zgjidhje duke ndjekur të njëjtën rrugë si Gjykata. Ata duhet të justifikojnë vendimin përpara klasës. 	Punë në grup	Fletë pune 1 fletë letre për secilin
10'	<p>3. Diskutim</p> <p>Nxënësit raportojnë për gjetjet e tyre. Mësuesi plotëson diskutimet duke përdorur përgjigjet në fletën e punës 2.</p>	E gjithë klasa	Fletë pune 2

B2. Materiale

Fletë pune 1

Fakte	A është një kjo shkelje e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut?
<p>Alison u ndëshkua nga nëna e saj me rrip lëkure, pasi theu një vazo me një top futboll. Ndëshkimi i shkaktoi një njollë të vogël mavijosje. Ajo u përpoq të kërkonte fillimin e ndjekjes penale në gjykatat e Britanisë, por mori përgjigjen se ky ndëshkim ishte i arsyeshëm dhe gjithashtu i pranueshëm sipas ligjit të Britanisë së Madhe. Alison nuk u pajtua me këtë qëndrim dhe iu drejtua Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (Gjykata) për shkelje të së drejtës së parashikuar në Nenin 3 të Konventës.</p>	
<p>Tomas, vëllai i Alison, u qëllua dy herë me shuplaka nga babai i tij, pasi ishte treguar i dobët. Ndëshkimi nuk la shenja në lëkurë. Edhe ai u përpoq që të kërkonte fillimin e procedimit penal në gjykatat e Britanisë së Madhe, ku mori sërish përgjigjen se ndëshkimi konsiderohej i arsyeshëm. Ai vendosi që t'i drejtohej Gjykatës, duke cituar shkeljen e të drejtave të Nenit 3 të Konventës.</p>	
<p>Kreig, një nxënës në një shkollë private Katolike në Fife, Skoci, u dënua për shkak se nuk kishte bërë detyrat. Shkolla pretendoi se ndalimi i ndëshkimeve fizike në klasë do të përbënte një shkelje të lirisë së besimit fetar të prindërve. Për më tepër, shkolla parashtroi se meqë nuk financohej nga shteti, nuk ishte e detyruar të respektonte të njëjtat ligje.</p>	
<p>Një gjykatë në Dandi, Skoci, përkrah goditjen ligjore me kamxhik për të rinjtë të cilët janë dënuar për krime të ndryshme. Gjykatësit e këtij institucioni premtojnë se do të rekomandonin këtë lloj dënimi vetëm për krimet e rënda dhe pohojnë se ky lloj ndëshkimi do t'i shpëtonte shtetit një sasi të konsiderueshme parash.</p>	
<p>Sandra beson se ndëshkimi fizik është rruga më e mirë për të disiplinuar fëmijët e saj. Ajo thotë se nëse gjykata ndërhynte, do të ndërhynte në të drejtat e saj për një jetë private dhe një jetë familjare.</p>	

Fletë pune 2 – Përgjigjet

Fakte	A është një kjo shkelje e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut?
<p>Alison u ndëshkua nga nëna e saj me rrip lëkure pasi theu një vazo me një top futboll. Ndëshkimi i shkaktoi një njollë të vogël mavijosje. Ajo u përpoq të kërkonte fillimin e ndjekjes penale në gjykatat e Britanisë, por mori përgjigjen se ky ndëshkim ishte i arsyeshëm dhe gjithashtu i pranueshëm sipas ligjit të Britanisë së Madhe. Alison nuk u pajtua me këtë qëndrim dhe iu drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata) për shkelje të së drejtës të parashikuar në Nenin 3 të Konventës.</p>	<p>Po. Ky nivel ndëshkimi, pa asnjë dyshim, do të konsiderohej si trajtim degradues sipas Nenit 3. Alison mund të përfitonte kompensim nga Britania e Madhe për mosrespektim të përshtatshëm të të drejtave të saj në zbatim të Konventës.</p> <p><i>A k. Britanisë së Madhe, 1998</i></p>
<p>Tomas, vëllai i Alison, u qëllua dy herë me shuplaka nga babai i tij, pasi ishte treguar i dobët. Ndëshkimi nuk la shenja në lëkurë. Edhe ai u përpoq që të kërkonte fillimin e procedimit penal në gjykatat e Britanisë së Madhe, ku mori sërish përgjigjen se ndëshkimi konsiderohej i arsyeshëm. Ai vendosi që t'i drejtohej Gjykatës, duke cituar shkeljen e të drejtave të Nenit 3 të Konventës.</p>	<p>Jo. Ka një nivel të caktuar dhune, që duhet tejkaluar, në mënyrë që të konsiderohet në shkelje të Nenit 3 e për rrjedhojë që të investohet Gjykata. Meqë babai i Thomas përdori pëllëmbën e tij dhe nuk i la shenjë në lëkurë, ndoshta kjo mund të konsiderohet si një ndëshkim i arsyeshëm e, për rrjedhojë, edhe të lejohet.</p> <p><i>Costello-Roberts k. Britanisë së Madhe, 1993</i></p>
<p>Kreig, një nxënës në një shkollë private Katolike në Fife, Skoci, u dënua për shkak se nuk kishte bërë detyrat. Shkolla pretendoi se ndalimi i ndëshkimeve fizike në klasë do të përbënte një shkelje të të lirisë së besimit fetar të prindërve. Për më tepër, shkolla parashtroi se meqë nuk finançohej nga shteti, nuk ishte e detyruar të respektonte të njëjtat ligje.</p>	<p>Po. Goditjet me kamxhik, padyshim, përbëjnë trajtim degradues e, për rrjedhojë, janë në shkelje të Nenit 3, dhe nuk mund të justifikohen nga e drejta e prindërve për liri të besimit fetar.</p> <p><i>Vendim pranueshmërie, Philip Uilliamson dhe të Tjerë k. Britanisë së Madhe, 2000; padia nr. 55211/00</i></p>
<p>Një gjykatë në Dandi, Skoci, përkrah goditjen ligjore me kamxhik për të rinjtë të cilët janë dënuar për krime të ndryshme. Gjykatësit e këtij institucioni premtojnë se do të rekomandonin këtë lloj dënimi vetëm për krimet e rënda dhe pohojnë se ky lloj ndëshkimi do t'i shpëtonte shtetit një sasi të konsiderueshme parash.</p>	<p>Po. Gjykata ka konstatuar që goditjet ligjore me kamxhik e fëmijës përbëjnë "trajtim ç'njerëzor dhe degradues" dhe për rrjedhojë shkel Nenit 3 të Konventës.</p> <p><i>Tyrer k. the Britanisë së Madhe, 1978</i></p>

Fakte	A është një kjo shkelje e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut?
<p>Sandra beson se ndëshkimi fizik është rruga më e mirë për të disiplinuar fëmijët e saj. Ajo thotë se nëse gjykata ndërhyr, do të ndërhynte në të drejtat e saj për një jetë private dhe një jetë familjare.</p>	<p>Po. Gjykata u shpreh se e drejta e fëmijës për të jetuar një jetë pa tortura dhe trajtim degradues është më e rëndësishme se sa e drejta e prindit për privatësi dhe jetë familjare.</p> <p>Vendimi për pranueshmëri, <i>Shtatë Individë k. Suedisë</i>, 1982; padia nr. 8811/79</p>

► Siliadin kundër Francës

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje, në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-69891#{"itemid":\["001-69891"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-69891#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Znj Siua-Akofa Siliadin (një shtetase nga Togo), e cila jetonte në Paris.

Arsyetimi

Kjo çështje është përzgjedhur, pasi dëshmon se nocioni i skllavërisë, në vend që të jetë një koncept historik, ende ekziston, në mënyra të ndryshme, në Evropën e sotme.

Faktet

Ms Siua-Akofa Siliadin lindi në 1978.

25 Janar 1994: në moshën 15 vjeçare, ankuesja u zhvendos në Francë së bashku me Znj D – një shtetase Franceze me origjinë nga Togo. Ankuesja kishte një pasaportë dhe një vizë turistike.

Ishte rënë dakord që ankuesja të shërbente në shtëpinë e Znj. D deri sa të mund të shpërblente paratë për biletën e avionit, të paguara nga Znj. D. Në fakt, ajo u kthye në një shërbëtoressë pa pagesë dhe pasaporta iu mor e iu fsheh.

Në fund të 1994: Znj. D "e huazoi" ankuesen tek Z dhe Znj B në mënyrë që ajo t'i ndihmonte me punët e shtëpisë. Ajo punonte shtatë ditë në javë pa asnjë ditë pushim, duke filluar çdo ditë nga ora 7.30 në mëngjes dhe duke shkuar në krevat për të fjetur pas orës 10.30 në mbrëmje. Ajo flinte në një dyshek në tokë në dhomën e bebes, për të cilin edhe duhej të kujdesej. Ajo kurrë nuk u pagua për punën e saj, përveç një ose dy rasteve sporadike, kur iu dha nga një kartëmonedhë 500 franga.

Dhjetor 1995: ankuesja ia del të largohet me ndihmën e një shtetasi haitian, i cili i garantoj një strehim dinjitoz dhe e pagoi 2 500 Franga në muaj për ta ndihmuar me punët e shtëpisë.

Më pas – me udhëzimin e të atit – asaj iu desh të kthehej tek Z. dhe Znj. B në të njëjtat kushte si më parë.

28 Korrik 1998: policia bastisi shtëpinë e Z. dhe Znj. B.

Beteja ligjore

10 Qershor 1999: një gjykatë në France dënoi Z. dhe Znj. B me nga 12 muaj burgim secilit dhe vendosi, si masë plotësuese, një gjobë prej 100 000 Frangash për t'iu paguar ankueses.

19 Tetor 2000: një gjykatë apeli në Francë e prishi vendimin e shkallës së parë dhe i deklaroi Z. dhe Znj. B të pafajshëm, me pretendimin se nuk e konsideronin ankuesen si të varur prej tyre ose të dobët për t'u mbrojtur, duke qenë se ajo lihej në shtëpi vetëm për periudha të gjata kohore. Me fjalë të tjera, ajo mund të ishte larguar kur të dëshironte.

11 Dhjetor 2001 dhe 15 Maj 2003: shkalla e radhës e gjykatave Franceze la në fuqi vendimin që deklaronte se Z. dhe Znj. B nuk mund të visheshin me përgjegjësi penale, pasi nuk ishte provuar se jeta e ankueses ishte e papajtueshme me dinjitetin njerëzor. Megjithatë, kjo gjykatë urdhëroi që ankueses t'i paguheshin të gjitha pagat e prapambetura.

17 Prill 2001: ankuesja iu drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në zbatim të Nenit 4 të Konventës, me pretendimin se dispozitat ligjore penale në Francë nuk i garantonin asaj mbrojtje të mjaftueshme kundër "servitutit ose skllavërisë" ose, më e pakta, ndaj "punës së detyruar", e cila i ishte kërkuar asaj të kryhej prej vitesh.

Servituti: një gjendje nënshtrimi ndaj një pronari (d.m.th. një skllav).

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore të parashtruara Gjykatës

Neni 4: Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

1. Askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri.
2. Askujt nuk mund t'i kërkohej të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.
3. Për qëllim të këtij neni, termi "punë e kryer me dhunë ose e detyruar", nuk përfshin:
 - a) çdo lloj pune që i kërkohej të kryejë zakonisht një personi të ndaluar, në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë liritimit të tij me kusht;
 - b) çdo lloj shërbimi i karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
 - c) çdo lloj shërbimi që kërkohej në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e komunitetit;
 - d) çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Gjykata duhet të vendoste nëse ky rast përfshihet apo jo në mbrojtjen që ofron Neni 4 nëpërmjet vlerësimit nëse ankuesja i ishte nënshtruar në fakt punës së detyruar apo jo. Më pas, Gjykata duhet të vendoste nëse (keq) trajtimi i saj ishte mjaftueshëm i rëndë për t'u konsideruar "skllavëri, servitut ose punë e detyruar" dhe nëse legjislacioni penal Francez i ofronte mjaftueshëm mbrojtje Znj. Siliadin.

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

Gjykata arriti në përfundimin se ankuesja, në fakt, ishte mbajtur kundër vullnetit të saj, dhe se për shkak se ishte një 15-vjeçare e paligjshme në Francë dhe e frikësuar ndaj arrestimit të mundshëm, këto rrethana të gjitha së bashku përbënin “punë të detyruar” sipas kuptimit të Nenit 4. Kjo ishte hera e parë që Gjykata gjente shkelje të Nenit 4 të Konventës.

Meqënëse Konventa nuk i përcaktonte termat e servitutit ose të “punës së detyruar”, referimi duhet të bëhet nga konventat ndërkombëtare përkatëse në këtë fushë, për përcaktimin e kuptimit të këtyre koncepteve. Në rastin shembull, kishin rëndësi të veçantë kriteret e përcaktuara, si nga Kombet e Bashkuara po ashtu edhe nga Këshilli i Evropës, për identifikimin e formave moderne të skllavërisë dhe servitutit. Kjo, pasi këto ishin shumë të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore dhe nevojën e njohur në nivel ndërkombëtar për t’u garantuar fëmijëve mbrojtje të veçantë bazuar tek mosha dhe dobësitë që ata mund të paraqesin. Padiësja ishte detyruar të punonte si pasojë e trafikimit, të cilit ajo i ishte nënshtruar nga Znj. B.

Ndërsa ishte e vështirë që të përcaktohej nëse ajo ishte mbajtur në “skllavëri”, në kuptimin e parë dhe tradicional të fjalës, dobësia dhe izolimi i saj – si rezultat i punës së detyruar të cilën ajo nuk mund ta linte, dhe që zgjaste 15 orë në ditë – mbështeste përfundimin se ankuesja i ishte nënshtruar edhe “servitutit”.

Gjykata konfirmoi gjithashtu se Neni 4 i ngarkonte shtetet me detyrimin që të procedonin penalisht dhe të dënonin çdo akt që e nënshtronin një person ndaj “skllavërisë, servituit apo punës së detyruar”. Gjykata evidentoi se legjislacioni penal Francez ishte i pamjaftueshëm për shkak se as skllavëria dhe as servituti nuk klasifikoheshin si vepra penale.

Çfarë ndodhi më tej?

Në kushtet e masave të veçanta individuale, ankuesja mori të gjithë shumën e plotë të pagesave të prapambetura si dhe €15 245, si kompensim për “traumën e fortë psikologjike” që ajo kishte vuajtur.

Në lidhje me masat e përgjithshme, pas këtij episodi, legjislacionit penal Francez iu bënë ndryshime materiale, të cilat garantuan lehtësi në dënimin e personave të cilët detyronin të tjerët të kryenin punë të detyruar. Krahas ndryshimeve ligjore u rritën edhe gjobat – masa plotësuese. Gjithashtu Franca ratifikoi Konventën për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në 9 Janar 2008.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Koncepte/tema: Detyrimi pozitiv i shteti për të mbrojtur individin kundër punës së detyruar, skllavërisë dhe servitutit.

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të tregojë që neni 4 përmban detyrimin pozitiv të shtetit;
- ▶ të tregojë si interpretohet neni 4 nga Gjykata
- ▶ të tregojë çfarë duhet të marrë parasysh Gjykata kur merr vendimin, në bazë të nenit 4, nëse shteti ka dështuar në mbrojtjen e aplikantit;
- ▶ të vlerësojë fushat në të cilat mund të zhvillohet çështja ligjore për nenin 4.

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë argumentet e të dy palëve;
- ▶ të komunikojë në mënyrë të efektshme një argument;
- ▶ të dëgjojë pikëpamjet e të tjerëve;
- ▶ të kritikojë një argument dhe të shpjegojë qëndrimin e tij.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të vlerësojë rëndësinë e nenit 4 dhe si ai mund të zbatohet në shoqërinë moderne;
- ▶ të vlerësojë nevojën që shteti të mbrojë qytetarët e pambrojtur dhe rolin e Konventës dhe të Gjykatës për këtë qëllim.

Kohëzgjatja: 45 minuta

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
10'	1. Siladin kundër Francës dhe zhvillimi i nenit 4 të Konventës. Nxënësit njihen me faktet dhe pyetjet e çështjes si dhe me nenin 4. Atyre u kërkohet t'u përgjigjen pyetjeve individualisht.	Punë individuale	

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
10	Nxënësit ndahen në grupe prej 3 - 4 nxënës dhe diskutojnë përgjigjet e tyre	Punë në grupe	
15'	Duke qenë në grupe, nxënësit vazhdojnë me diskutimin e çështjes në fletët e punës.	Punë në grup	Fletët e punës
10'	Mësuesi fton tri vullnetarë për të dalë përpara klasës. Atyre u kërkohet të rreshtohen, me fytyrë në njërin anë dhe me sytë e mbyllur. Ndërmjet dhe përpara tyre duhet të ketë hapësirë. Mësuesi lexon çështjen nga fleta e punës dhe u kërkon nxënësve të vendosin, në bazë të njohurive që kanë mbledhur, nëse Gjykata ka vendosur për shkelje të nenit 4 apo jo shkelje. Nëse ata mendojnë se kemi të bëjmë me shkelje, atëherë të bëjnë një hap përpara. Nëse mendojnë të kundërtën, të bëjnë një hap prapa. Në fund, mësuesi paraqet vendimin e gjykatës dhe përgjigjet diskutohen me të gjithë klasën.	Mësimdhënie me të gjithë klasën	Fletët e punës dhe Udhëzimet

B.2. Materiale

Fletë pune – studime rasti

Çështja A

Ankuesi, një mbrojtës i të drejtave të studentëve, u thirr për të ofruar shërbime ligjore falas për të ndihmuar të pandehurit e varfër. Ai u ankua me pretendimin se kjo përbënte punë të detyruar.

Çështja B

Ankuesi u dënua për vjedhje dhe, si dënim plotësues, pas përfundimit të dënimit të tij dy vjeçar, të vihej në dispozicion të shtetit për disa vite, kohë gjatë të cilës ai mund të thirrej përsëri në parburgim. Ai u ankua se, në këtë mënyrë, po mbahej në servitut, duke qenë se po nënshtrohej ndaj “trillevë të administratës”.

Çështja C

Ankuesi ishte babai i një gruaje të re me origjinë Ruse, e cila humbi jetën në Qipro ku ajo kishte shkuar për të punuar në Mars të 2001. Ai u ankua se policia Qipriote nuk kishte bërë gjithçka sa ishte e mundur për të mbrojtur të bijën nga trafikimi, për sa kohë ajo ishte gjallë, dhe për të dënuar përgjegjësit pas vdekjes së saj. Ai u ankua gjithashtu lidhur me dështimin e autoriteteve Ruse për të hetuar trafikimin dhe vdekjen e mëvonshme të vajzës së tij si dhe për mos-marrjen e hapave të nevojshëm për ta mbrojtur atë nga rreziqet e trafikimit.

Çështja D

Katër djem të moshave nga 15 deri 16 vjeç u regjistruan dhe u rekrutuan në Forcat Detare Britanike për një periudhë prej nëntë vjetësh. Kërkesat e tyre për t'u liruar nga shërbimi për arsye të ndryshme personale u refuzuan nga autoritetet, refuzim pas të cilit ata u ankuan se po mbaheshin në servitut.

Udhëzimet për studimin e rastit– Përgjigjet

Çështja A

Ankuesi, një mbrojtës i të drejtave të studentëve, u thirr për të ofruar shërbime ligjore falas në ndihmë të të pandehurve të varfër. Ai u ankua me pretendimin se kjo përbënte punë të detyruar.

Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Van der Musselle k. Belgjikës)

Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje të Nenit 4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: shërbimi falas i kërkuar prej personit lidhej drejtpërdrejt me profesionin e tij dhe për këtë shërbim ai përfitoi disa avantazhe (p.sh. të drejtën ekskluzive për të qenë në sallë gjatë proceseve në çdo gjykatë) si dhe ishte një kontribut i vyer për trajnimin e tij të mëtejshëm; ai lidhej me Nenin 6 paragrafi 1 i Konventës (e drejta për ndihmë ligjore) dhe mund të konsiderohej si pjesë e "detyrimeve normale qytetare" të lejuara sipas Nenit 4 paragrafi 3. Së fundmi, duke qenë se vetë profesioni ia kërkonte që ankuesi të mbronte njerëz, pa u paguar për shërbimet e kryera, kjo nuk i linte Z. Van der Musselle mjaftueshëm kohë për punën e paguar.

Çështja B

Ankuesi u dënua për vjedhje dhe si dënim plotësues, pas përfundimit të dënimit të tij dy vjeçar, të vihej në dispozicion të shtetit për disa vite, kohë gjatë të cilës ai mund të rithirrej në paraburgim. Ai u ankua duke pretenduar se, në këtë mënyrë, po mbahej në servitut duke qenë se po nënshtrohej ndaj "trilleve të administratës".

Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Van Droogenbroeck k. Belgjikës).

Gjykata u shpreh se nuk ka pasur shkelje të Nenit 4 të Konventës. Ajo theksoi se situata e ankuesit mund të konsiderohej si servitut vetëm nëse do të përfshinte një formë të veçantë të privimit të lirisë, çka në këtë rast nuk kishte ndodhur. Për më tepër, puna e cila ishte kërkuar të kryhej nga ankuesi nuk e kishte tejkaluar atë çka normalisht pritej të bëhej nga ai në kuadër të përlllogaritjeve të kryera për punën e nevojshme në mënyrë që ai ta integronte sërish veten në shoqëri.

Çështja C

Ankuesi ishte babai i një gruaje të re me origjinë Ruse e cila humbi jetën në Qipro, ku ajo kishte shkuar për të punuar në Mars të 2001. Ai u ankua se policia qipriote nuk kishte bërë gjithçka që ishte e mundur për të mbrojtur të bijën nga trafikimi, për sa ajo ishte gjallë, dhe për të dënuar përgjegjësit pas vdekjes së saj. Ai u ankua gjithashtu lidhur me dështimin e autoriteteve Ruse për të hetuar trafikimin dhe vdekjen e mëvonshme të vajzës së tij si dhe për mos-marrjen e hapave të nevojshëm për ta mbrojtur atë nga rreziqet e trafikimit.

Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Rantsev k. Qipros dhe Ruisë).

Gjykata konstatoi se shteti i Qipros kishte shkelur Nenin 4 të Konventës për shkak se kishte dështuar në hartimin e një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe administrativ për të luftuar trafikimin, dhe se policia kishte dështuar në detyrën e saj për të mbrojtur Znj. Rantseva (vajzën e ankuesit), pavarësisht se ishin përballur me fakte dhe rrethana që sugjerorin se ajo mund të ishte viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Paralelisht ka pasur shkelje të Nenit 4 edhe nga ana e shtetit Rus në lidhje me dështimin për hetuar ku dhe kur Znj. Rantseva ishte rekrutuar, dhe në veçanti, kishte dështuar në marrjen e masave të nevojshme për identifikimin e personave të përfshirë në rekrutim e saj apo metodave të përdorura për ta rekrutuar.

Çështja D

Katër djem të moshave nga 15 deri 16 vjeç u regjistruan dhe u rekrutuan në Forcat Detare Britanike për një periudhë prej nëntë vjetësh. Kërkesat e tyre për t'u liruar nga shërbimi për arsye të ndryshme personale u refuzuan nga autoritetet, refuzim pas të cilit ata u ankuan se po mbaheshin në servitut.

Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Ë., X., Y. dhe Z. k. Britanisë së Madhe)

Komisioni konstatoi se shërbimi ushtarak i ankuesve nuk përbën skllavëri në kuptimin e Nenit 4 paragrafi 1 i Konventës dhe e deklaruan kërkesë-padinë si të papranueshme.

3.4. Tema 3 –Si i trajtojmë të tjerët?

3.4.1. Hyrje në temë dhe në çështjet

- ▶ **D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke:** Si i trajtojmë pakica të tilla si Romët? A mundet shkolla të ndajë nxënësit e racave të ndryshme në klasa të ndryshme?
- ▶ **Lejla Shahin kundër Turqisë:** Si i trajtojmë ata që dëshirojnë të shprehin fenë e tyre në publik? A mund të kufizohet e drejta për të shprehur përkatësinë fetare për të mbrojtur të drejtat e tjera?
- ▶ **Opuz kundër Turqisë:** Si i trajtojmë njerëzit në familjet tona? A është dhuna në familje një formë e diskriminimit?

Këto veprimtari janë zhvilluar për të nxitur të rinjtë të mendojnë për mënyrën si nxënësit në shkollë i trajtojnë nxënësit që janë pjesë e pakicave ose ata që kanë vlera ose besime të ndryshme nga të tyret. Ato synojnë të nxisin reflektimin për mënyrën si nxënësit i trajtojnë ata që janë të ngjashëm me ta, si mund të luftojnë kundër ngacmimeve dhe të mbrojnë viktimat.

► D.H. dhe të Tjerët kundër Republikës Çeke

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje, në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-83256#{"itemid":\["001-83256"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-83256#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Një grup prej 18 shtetasish nga Çekia me origjinë Rome, të lindur ndërmjet 1985 dhe 1991, të cilët jetojnë në rajonin e Ostravas të Republikës Çeke.

Arsyetimi

Ky rast është unik në llojin e vet pasi gjykimi kritikon shumë rëndë sistemin arsimor të një Shteti Palë të Konventës. Vendimi trajton diskriminimin indirekt kundrejt komunitetit Rom, lidhur me aksesin në klasat jo-të-specializuara dhe evidenton se vetë sistemi, praktikisht, promovon ndarjen dhe veçimin e fëmijëve në Rom dhe jo-Rom.

Faktet

1996 deri në 1999: fëmijët e ankuesve ishin caktuar në shkolla të veçanta për fëmijët me vështirësi në të nxënë:

- ▶ drejtori i shkollës ishte i detyruar me ligj që të bazonte vendimin e tij në rezultatet që buronin nga testi i kapacitetit intelektual të fëmijëve;
- ▶ testi mund të kryej vetëm nëse përfaqësuesi ligjor i fëmijës jepte pëlqimin e tij.

Beteja ligjore

Pas përcaktimit: 14 nga ankuesit i kërkuan Autoritetit Arsimor të Ostravas që të rishikonte vendimet e marra nga drejtorët e shkollave, me pretendimin se:

- ▶ testet nuk ishin të besueshme;
- ▶ autoritetet nuk i kishin informuar prindërit plotësisht për çka mund të ndodhte, në qoftë se ata do të jepnin pëlqimin për testet e kryera mbi fëmijët e tyre;
- ▶ autoriteti i mbështeti vendimet e drejtorëve si të bazuar në ligj;
- ▶ 12 nga ankuesit e apeluan vendimin në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se:
 - dërgimi i fëmijëve Rom në shkolla të veçanta është një "praktikë e përgjithshme" e cila rezulton në veçim dhe diskriminim racial;
 - vendimi i dërgonte fëmijët në dy sisteme arsimore të ndryshme dhe të pavarura, të cilët përvijonin paralel me njëri-tjetrin, ku Romët përjashtoheshin nga shkollat "e zakonshme" fillore në të cilat shkonin fëmijët e shumicës së popullsisë.

20 Tetor 1999: Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë apelin.

18 Prill 2000: ankuesit parashtruan një kërkesë-padi pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me pretendimin se:

- ▶ fëmijët e tyre ishin caktuar në shkolla të veçanta për fëmijët me vështirësi në të nxënë, për shkak se ishin fëmijë Rom dhe për këtë arsye ishin diskriminuar duke u mohuar të drejtën e tyre për arsimim.

13 Nëntor 2007: Dhoma e Madhe e Gjykatës konstatoi se ankuesit ishin caktuar në këto shkolla për shkak të origjinës së tyre Rome dhe jo si rezultat i kapacitetit të tyre intelektual dhe, si pasojë, u shpreh se kishte shkelje të Nenit 4, në lidhje me Neni 2 të Protokollit Nr. 1.

Testi i aftësive intelektuale: një test që mat aftësinë intelektuale të fëmijës, të kryer në një qendër të psikologjisë së edukimit dhe që shoqërohet me sugjerime për drejtuesin e shkollës.

Segregacion: veprimi ose gjendja e vendosjes së dikujt i veçuar nga të tjerët.

Diskriminim racial: trajtimi i padrejtë ose paragjykes i kategorive të ndryshme të njerëzve duke u bazuar te raca.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore parashtruar Gjykatës

Ankuesit pretendonin se nenet e Konventës të cilët ishin shkelur parashtrohen si vijon:

Neni 14: Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

në lidhje me:

Neni 2, Protokoll Nr. 1: E drejta për arsimim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Ankuesit pretendonin se fëmijët e tyre ishin caktuar në shkolla të veçanta për fëmijët me vështirësi në të nxënë, për shkak se ishin fëmijë Rom dhe për këtë arsye ishin diskriminuar duke u mohuar të drejtën e tyre për arsimim. Shumë organizata jo-qeveritare ndërhyjnë në këtë çështje në mbështetje të pretendimit të ankuesve.

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

7 Shkurt 2006: Dhoma vendosi (me gjashtë vota pro dhe një kundër) se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 14, të lexuar në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 1. Trupa gjyquese u shpreh se sistemi i shkollave të veçanta nuk ishte futur në sistemin arsimor ekskluzivisht për të pritur fëmijët e komunitetit Rom. Këto shkolla ishin projektuar dhe synonin të mbështesnin fëmijë me nevoja të veçanta për të përfituar arsimim bazë. Çështja më pas u referua në Dhomën e Madhe.

13 Nëntor 2007: Dhoma e Madhe konstatoi se:

- ▶ faktet linin hapësirë për të pandehur se fëmijët Rom ishin diskriminuar në mënyrë indirekte për shkak të numrit të madh të raporteve që konfirmonin se numri i fëmijëve Rom në shkollat e veçanta ishte jo proporcionalisht i lartë;
- ▶ megjithëse të gjithë fëmijët e testuar u vlerësuan sipas të njëjtit testim, pavarësisht prejardhjes së tyre, autoritetet Çeke kishin pranuar që edhe fëmijët Rom, me nivel intelektivi të mjaftueshëm për të kaluar pragun e testit, ishin caktuar në shkolla të veçanta bazuar në testet psikologjike të cilët nuk e merrnin në konsideratë fare kulturën Rome. Pra, për shkak të sa më sipër Dhoma e Madhe kishte shprehur dyshimin se mos testet kishin qenë të njëanshëm;
- ▶ lidhur me dhënien e pëlqimit prindëror, shumë prindër të fëmijëve Rom, duke qenë anëtarë të grupeve minoritare dhe shpesh të paarsimuar, nuk kishin qenë në gjendje që të drejtpeshonin pasojat e dhënies së pëlqimit të tyre;
- ▶ ndryshimi në mënyrën e trajtimit nuk mund të justifikohet objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme, dhe se masat e marra nuk ishin në përpjesëtim me objektivin e synuar.

Në përfundim, Dhoma e Madhe konstatoi se fëmijët e ankuesve ishin caktuar në shkolla të veçanta si rezultat i origjinës së tyre Rome dhe jo për shkak të aftësive të tyre intelektuale. Kësisoj ajo konstatoi shkelje të Nenit 14 të Konventës të lexuar në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 1.

Parimi themelor

- ▶ Diskriminimi indirekt (praktikisht diskriminim): në mënyrë që një masë e marrë ose normë ligjore të jetë diskriminuese nuk është domosdoshmërisht e thënë që qëllimi i saj diskriminues të jetë i shprehur qartësisht. Përkundrazi, në rrethana të caktuara është e mjaftueshme që kjo masë ose normë të ketë pasojë diskriminuese në praktikë.

Çfarë ndodhi më tej?

Gjykata nuk rekomandoi masa të përgjithshme, për shkak se legjislacioni përkatës tashmë ishte zëvendësuar. Komiteti i Ministrave bëri rekomandimet përkatëse lidhur me arsimimin e fëmijëve Rom në Evropë.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Koncepte/tema: të drejtat e minoritetit dhe ndalimi i diskriminimit në arsim.

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të shpjegojë pasojat negative të diskriminimit;
- ▶ të dallojë format e padukshme të diskriminimit;
- ▶ të përshkruajë pasojat negative të përjashtimit.

Aftësi

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të dallojë diskriminimin;
- ▶ të vlerësojë pikëpamjet e të tjerëve.

Qëndrime

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të mirëkuptojë viktimat e diskriminimit;
- ▶ të tregojë simpati për nxënësit e marginalizuar dhe për të tjerët;
- ▶ të kundërpërgjigjet ndaj diskriminimit.

Kohëzgjatja: 45 minuta.

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
15'	1. Përkufizimi i diskriminimit Nxënësit, të ndarë në grupe me 3 veta, diskutojnë për kuptimin e diskriminimit dhe bien dakord për një përkufizim të tij, të cilin e shkruajnë në tabelë.	Punë në grup	
5'	E gjithë klasa vendoset në formë rrethi. Mësuesi lexon nenin 2 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 4 të Konventës. Nxënësit diskutojnë për përkufizimet e dhëna prej tyre dhe për ato që ndodhen në dy dokumentet e mësipërme, duke u përgjigjur pyetjeve të mëposhtme: <ul style="list-style-type: none">▶ Mbi ç'bazë mund të ndodhë diskriminimi?	E gjithë klasa	Udhëzimi 1

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Cilët janë individët që diskriminohen në vendin tuaj? ▶ Cilat janë format që merr diskriminimi? 		
15'	<p>2. Diskutimi i çështjes D.H.</p> <p>Mësuesi u shpërndan nxënësve faktet e çështjes dhe vendimin. Në grupe me nga 3 veta, nxënësit diskutojnë pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ A është diskriminuar ndonjëri në çështjen D.H? ▶ Si mund të ndryshohet situata(nga pikëpamja e Romëve dhe e të tjerëve)? <p>Nxënësit shënojnë fjalët kyç në copa letre të cilat i varin në mur.</p>	Punë në grup	Fletë të vogla letre
10'	Mësuesi zgjedh disa nga fjalët për të shpjeguar si ndalimi i diskriminimit vepron në sistemin Evropian, domethënë që ai mund të pretendohet vetëm në lidhje me të drejta të tjera.	E gjithë klasa	Udhëzimi 2

B.2. Materiale

Udhëzimi 1 – Përcaktimi i diskriminimit

Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Neni 2 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Pyetje:

- ▶ Mbi ç'bazë mund të diskriminohet dikush?
- ▶ Cilët janë individët e diskriminuar në vendin tuaj?
- ▶ Cilat janë format e diskriminimit?

Udhëzimi 2 – Ndalimi i diskriminimit në sistemin Evropian

Në sistemin Evropian diskriminimi ndalohet në dy mënyra.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbron ndaj diskriminimit që lidhet me të drejta të tjera të garantuara në këtë Konventë. Kjo rrjedh nga neni 14 i Konventës:

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Neni 14 i Konventës mund të thirret në lidhje me një tjetër nen të Konventës ose të Protokollit shtesë. Megjithatë, neni 14 i Konventës nuk ka ndonjë funksion të pavarur brenda sistemit të Konventës, në kuptimin që kjo dispozitë nuk pandeh domosdoshmërisht një shkelje të dispozitës me të cilën është lidhur. Kjo do të thotë që, neni 14 mund të shkelet në lidhje me një të drejtë të garantuar në Konventë ose të një nga Protokollat shtesë, edhe pse, pavarësisht nga neni 14, nuk gjendet shkelje e ndonjë të drejtë të veçantë.

Duke pranuar rëndësinë e ndalimit të diskriminimit në përgjithësi dhe jo vetëm në lidhje me të drejta të tjera nën sistemin e Konventës, në 4 nëntor 2010, Shtetet Palë miratuan një Protokoll shtesë, Nr. 12, duke sanksionuar ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit në nenin 1:

1. Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Duke ratifikuar këtë Protokoll, Shtetet palë pranojnë mundësinë e aplikimeve individuale me pretendimin se një individ ose një grup individësh kanë qenë diskriminuar edhe nëse ky diskriminim nuk mund të lidhet me një nga dispozitat e tjera të Konventës ose të protokolleve të saj.

► Leyla Şahin kundër Turqisë

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-70956#{"itemid":\["001-70956"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-70956#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Znj. Lejla Şhahin është një shtetase Turke, e lindur në vitin 1973. Ajo ka jetuar në Vjenë që prej vitit 1999 dhe vjen nga një familje tradicionale praktikantësh të besimit Mysliman. Ajo e konsideron detyrim fetar veshjen e shamisë Islame.

Arsyetimi

Në çështjen e Lejla Şhahin, Gjykata shqyrtoi rastet kur legjitimohet kufizimi i shprehjes së përkatësisë fetare dhe cilat janë hapësirat ligjore mbi bazën e të cilave të shqyrtohen këto çështje. Trajtimi i kësaj çështje ngre gjithashtu edhe shumë pyetje interesante në lidhje me mënyrën se si duhet të konsiderojmë të drejtën e besimit fetar, në një Evropë shumë-kulturore dhe bashkëkohore; rolin e shtetit në këto çështje në lidhje me fushën e arsimimi; dhe kushtetutën e Turqisë në dritën e detyrimeve që burojnë nga e drejta ndërkombëtare humanitare.

Faktet

Përpara 1998: Znj. Lejla Şhahin kishte kaluar 4 vite duke studiuar në Universitetin e Bursa-s, në Turqi, kohë gjatë së cilës ajo mbante veshur një shami Islame.

1998: ankuesja u regjistrua në Universitetin e Stambollit, si studente e vitit të pestë dhe vijoi ta mbante veshur shaminë edhe gjatë studimeve.

Shkurt 1998: Zv/Kancelari i Universitetit të Stambollit nxori një njoftim ku thuhej se studentët me "kokë të mbuluar" (duke përfshirë edhe studentët me mjekër), nuk duhet të pranoheshin në leksione, kurse ose në praktikë. Ky njoftim përcaktonte gjithashtu se nëse këta studentë do të refuzonin të largoheshin nga sallat pasi t'u kërkohej një gjë e tillë, do të bëheshin subjekt i masave disiplinore.

Në tre muajt që vijuan: Znj. Şhahin iu mohua hyrja në dy provime me shkrim, iu mohua edhe hyrja në sallat e leksioneve dhe të seminareve. Më pas, asaj iu dha edhe një paralajmërim me shkrim për përjashtim nga dekani i fakultetit.

Shkurt 1999: një grupim i paautorizuar (përfshi Znj. Şhahin) protestoi në lidhje me çështjen e veshjeve, jashtë dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë. Të gjithë studentëve që morën pjesë, përfshi Znj. Şhahin, iu dhanë masa disiplinore dhe, pas një dëgjese, Znj. Şhahin u pezulluan nga Universiteti për një semestër të tërë.

Beteja ligjore

Procedura gjyqësore Turke

- ▶ një padi e ngritur nga Znj. Şhahin në Gjykatën Administrative të Stambollit me objekt, kundërshtimin e vendimit të mësipërm (duke parashtruar se shkelte të drejtën e saj për të shprehur besimin e saj fetar), rezultoi e pasuksesshme, duke qenë se Ligji Turk për Arsimin e Lartë dhe jurisprudenca e gjykatave të larta përcaktonte se Zv/Kancelari kishte të drejtën që të përcaktonte rregulla për veshjen e studentëve me qëllim ruajtjen e rendit;

- ▶ 2001: apeli i Znj. Şhahin u hodh poshtë edhe nga Gjykata Administrative Supreme SAC, (gjykata e brendshme më e lartë);
- ▶ një padi e dytë u parashtrua në të njëjtën gjykatë, me qëllim anulimin e vendimit për pezullimin e Znj. Şhahin. Edhe kjo padi u pushua, duke qenë se jurisprudenca në lidhje me këtë temë, nuk i konsideronte këto masa si të paligjshme. Për këtë arsye, as rregullat e universitetit dhe as masat disiplinore të marra nuk u konsideruan si të paligjshme;
- ▶ 2000: u miratua një ligj dispozitat e të cilit u garantonin studentëve amnisti në lidhje me ndëshkimet dhe masat disiplinore të marra për kundërvajtje disiplinore si dhe shuante çdo lloj pamundësie të shkaktuar si pasojë e masave të marra. Znj. Şahin u zhvesh nga të gjithë detyrimet ligjore që vinin si pasojë e veprimeve të saj;
- ▶ SAC u shpreh se ishte e panevojshme që të shqyrtohej më tej themeli i çështjes dhe se Znj. Şhahin mund të kthehej në universitet;
- ▶ 1999: megjithatë, ndërkohë, Znj. Şhahin ishte larguar për studime në Universitetin e Vjenës, ku përmbylli pjesën e mbetur të studimeve.

Procesi në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

- ▶ 21 Korrik 1998: një kërkesë-padi u parashtrua në Gjykatë;
- ▶ 10 Nëntor 2005: Gjykata u shpreh se nuk kishte shkelje të të drejtave të njeriut.

Amnisti: një akt i lëshuar nga pushteti legjislativ apo ekzekutiv nëpërmjet të cilit shteti deklaron se ata të cilët mund të jenë shpallur fajtorë për një veprë penale rikthehen në gjendjen e tyre ligjore të mëparshme, pa ndryshuar legjislacionin që e përshkruan veprën penale.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore parashtruar Gjykatës

Zjn. Lejla Şhahin parashtrroi se ndalimi i veshjes së shamisë Islame në institucionet e arsimit të lartë përbënte një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e saj të besimit fetar, në veçanti, në të drejtën e saj për të shprehur bindjet e saj fetare.

Për sa më sipër, ajo u mbështet në nenet e mëposhtme të Konventës:

Neni 9: Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shprehjes së fesë ose të besimeve nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Është e rëndësishme të theksohet se ndërhyrja (paragrafi 1) nuk përbën shkelje nëse shteti arrin ta justifikojë atë (shih paragrafi 2). Gjykata shqyrtoi gjithashtu nëse masa

disiplinore e dhënë shkelte të drejtën e ankueses për arsimim (Neni 2 i Protokollit Nr. 1), të drejtën e jetës private dhe familjare (Neni 8), lirinë e shprehjes (Neni 10) apo nëse mbarte ndonjë natyrë tjetër diskriminuese (Neni 14).

Neni 2, Protokoll Nr. 1: E drejta për arsimim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë arsimim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

Gjykata theksoi se liria e besimit fetar, pavarësisht se përbën një nga shtyllat e shoqërive demokratike, nuk është një e drejtë e pakufizuar. Neni 9 nuk mbron çdo veprim të motivuar nga feja ose besimi fetar dhe në shoqëritë pluraliste, ndonjëherë, kufizimet nevojiten për të promovuar tolerancën dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të të gjithëve. Duke qenë se rëndësia e besimit fetar në një shoqëri zhvillohet në përputhje me kohën dhe komunitetin ku praktikohet, shteti në fjalë është përgjegjës për rregullimin e mënyrës së veshjes, të simboleve arsimore në institucionet e edukimit, në përputhje me kontekstin kombëtar përkatës. Ky “cak vlerësimi” (hapësira e veprimit e dhënë shtetit nga Gjykata për të vënë në zbatim të drejtat e Konventës në respekt të traditave të shoqërisë së vet) ecën paralel me mbikëqyrjen që bën Gjykata për të siguruar që garancitë e ofruara nga Konventa janë ende në fuqi.

Gjykata konstatoi se:

- ▶ vendimi i ankueses për të veshur shami motivohej nga besimi i saj fetar dhe se rregullorja e universitetit përbënte në vetvete ndërhyrje në të drejtën e saj për të manifestuar lirshëm besimin e saj fetar;
- ▶ ndërhyrja ishte rrjedhojë e zbatimit të legjisllacionit Turk, lexuar në dritën e jurisprudencës përkatëse dhe legjisllacionit të brendshëm. Kufizimet dhe ndëshkimet për mospërputhje duhet të ishin të qarta për ankuesen në kohën që nisi studimet e saj në Universitetin e Stambollit;
- ▶ ndërhyrja ishte në zbatim të objektivave legjitimë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve si dhe të ruajtjes së rendit publik. Gjykatat Turke e bazuan ndërhyrjen shtetërore në dy parime: sekularizmin dhe barazinë. Sekularizmi e pengon shtetin Turk që të shprehet preferencial ndaj një feje apo besimi të caktuar fetar, duke e përcaktuar rolin e tij si arbitër i paanshëm dhe, kështu, duke kufizuar lirinë fetare ndërkohë që mbron qytetarët nga lëvizjet ekstremiste të cilat imponojnë praktikën e tyre fetare në të gjithë shoqërinë. Sa i përket barazisë gjinore, Gjykata u shpreh se veshja e shamisë mund të ndikojë negativisht ndaj atyre të cilët nuk e veshin në një vend si Turqia ku pjesa më e madhe e popullsisë aderon në besimin Mysliman. Gjykata u shpreh se Neni 9 mund të kufizohet me qëllim mbrojtjen e këtyre parimeve;
- ▶ në kontekstin e universitetit, ku sundojnë pluralizmi, respekti për të drejtat e të tjerave dhe barazia gjinore, konsiderohet e pranueshme që autoritetet shtetërore të kërkonin ruajtjen e natyrës sekulariste të institucionit dhe, për

rrjedhojë, të merrnin parasysh, në kundërshtim me këto vlera, lejimin e këtyre lloj veshjeve në ambientet e tyre;

- ▶ Gjykata konstatoi se ka pasur një marrëdhënie të arsyeshme përpjesëtueshmërie ndërmjet mjeteve të përdorura dhe objektivave legjitimë të synuar nga ndërhyrja. Rregullat e universitetit janë zbatuar për vite me radhë, kohë gjatë së cilës, në shoqërinë Turke dhe në komunitetin mësimdhënës është zhvilluar një debat i gjerë lidhur me këtë çështje. Menjëherë pas njoftimit të dhënës, në universitet është ndaluar çdo lloj forme e veshjeve fetare. Autoritetet e universitetit kanë bërë përpjekje të njëpasnjëshme për t'u përshtatur me zhvillimet e ndryshme, me qëllim që të mos i pengonin hyrjen në auditor studentëve që vishnin shami Islame, nëpërmjet dialogut të vazhdueshëm me personat dhe komunitetin e interesuar, njëkohësisht duke garantuar rend dhe pajtueshmëri me rregulloret në fuqi. Kufizimet, në këtë rast, janë vlerësuar "të nevojshme për një shoqëri demokratike".

Përfundimi i Gjykatës: Gjykata unanimisht vendosi që nuk ka shkelje të Neneve 8, 10 dhe 14 si dhe Nenit 2 të Protokollit Nr. 1.

Parimi themelor

Liria e Besimit Fetar nuk është absolute. Tek ajo mund të ndërhyhet nëse:

- ▶ ndërhyrja është e parashikuar në ligj;
- ▶ ndërhyrja ndjek zbatimin e një objekti legjitim;
- ▶ ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike (e justifikuar në parim dhe në përputhje me qëllimin e synuar).

Gjykata i jep një hapësirë të gjerë vlerësimi shteteve, në rastet kur kanë të bëjnë me lirinë e besimit fetar.

Çfarë ndodhi më tej?

Meqë nuk u gjet asnjë shkelje e Nenit 9, Gjykata nuk urdhëroi masa të veçanta ose masa të përgjithshme. Megjithatë, në vitin 2008, Parlamenti Turk amendoi kushtetutën e vendit, duke u dhënë grave dhe vajzave të drejtën për të mbajtur veshur shaminë Islame në auditorët e universiteteve, me argumentin se shumica prej tyre do të ndërprisnin rrugën e dijës dhe nuk do të studionin më tej nëse u hiqej kjo e drejtë. Ky amendim u hodh poshtë nga Gjykata Kushtetuese. Gjithë sesi, që nga viti 2010, shumica e universiteteve, duke përfshirë edhe universitetin e Stambollit, kanë lejuar në mënyrë jo zyrtare që studentet të mbajnë veshur shamitë Islame në auditorë.

Pjesa B. Veprimtaritë mësimore

Koncepte/tema: të mësojmë si Gjykata interpreton nenin 9 të Konventës, përmes analizës së çështjes Lejla Shahin kundër Turqisë

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të përkufizojë me fjalët e tij mënyrën si liria e fesë dhe e drejta për arsimim përcaktohen, përkatësisht, në nenin 9 të Konventës dhe në neni 2 të Protokollit Nr. 1;
- ▶ të shpjegojë interpretimin që Gjykata i bën nenit 9 të Konventës në lidhje me simbolet fetare në institucionet shtetërore.

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të zbatojë një qasje që merr parasysh këndvështrimet e shumta që ekzistojnë për analizën e përmbajtjes së nenit 9 të Konventës, duke marrë parasysh argumentet e Znj. Lejla Shahin, të autoriteteve Turke dhe të Gjykatës;
- ▶ të punojnë në grup dhe të japin argumente për interpretimet e ndryshme të nenit 9 të Konventës;
- ▶ të negociojnë gjatë kohës që mbrojnë qëndrimet e kundërta;
- ▶ të identifikojnë tipat e ndryshëm të shkeljeve të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, duke u bazuar në interpretimet që Gjykata i bën nenit 9 të Konventës.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të jetë i hapur ndaj simboleve të ndryshme fetare dhe mënyrës së shprehjes së përkatësisë fetare;
- ▶ të respektojë mënyrat e ndryshme të shprehjes së besimeve fetare dhe opinionëve.

Kohëzgjatja: 45 minuta.

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
5'	<p>1. Neni 9 i Konventës dhe neni 2 i Protokollit Nr. 1</p> <p>Mësuesi projekton tekstin e nenit 9 të Konventës dhe të nenit 2 të Protokollit Nr. 1. Ai pranon të diskutojë çdo pyetje që lind nga leximi i tyre.</p>	E gjithë klasa	
10	<p>2. Faktet e çështjes</p> <p>Mësuesi paraqet çështjen e Lejla Shahin. Nxënësit, ndërsa dëgjojnë, shënojnë ngjarjet në rend kronologjik. Më pas, faktet diskutohen në klasë dhe mësuesi bën sqarimet e nevojshme.</p> <p>Në vijim, ai u shpërndan nxënësve fletën e punës 1.</p>	E gjithë klasa	Fleta e punës 1
	<p>Për të kuptuar më mirë çështjen, mësuesi i njeh nxënësit me hapat proceduralë përpara Gjykatës dhe me arsyetimin e vendimit. Ai analizon çështjet kryesore që u ngritën në Gjykatë dhe në përgjigjet dhe përfundimet e saj, kurse nxënësit përdorin fletën e punës 1 për ilustrime dhe kërkojnë sqarimet të mëtejshme.</p>	E gjithë klasa	

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
10'	<p>3. Debati</p> <p>Nxënësve u kërkohet të mendojnë për mënyrën si mund të ishte zgjidhur çështja: Argumentet që ata do të përdornin në vendin e Lejlës dhe si do të negocionin me zv/Kancelarin dhe me profesorin i cili nuk e pranoi në provim. Nxënësit e tjerë do të mendojnë për argumente që ata do të përdornin në rolin e Zv/Kancelarit dhe të profesorit. Rolet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Lejla; ▶ Tre nxënës protestojnë me Lejlën kundër shënimit të Zv/Kancelarit ▶ Zv/Kancelari ▶ Profesori që pengoi Lejlën të hyjë në provim. <p>Skena zhvillohet në zyrën e Zv/Kancelarit. Lejla dhe dy nxënës të tjerë, të pranishëm në protestë bisedojnë me Zv/Kancelarin dhe me profesorin rreth situatës. Lejla dhe nxënësit mbrojnë të drejtën e tyre për arsim dhe të drejtën e tyre për të shprehur fenë e tyre. Zv/Kancelari dhe profesori mbrojnë rendin publik dhe rregullat e institucioneve arsimore.</p>	Punë në grup	Fleta e punës 2 Shalle, veshje të përshtatshme për zv/ kancelar
	<p>Qëllimi është të gjejnë një gjuhët të përbashkët ndërmjet dy palëve që do të ndihmojnë në gjetjen e zgjidhjeve pa shkeljen e të drejtave të njeriut. A ishte i nevojshëm shënimi i zv/kancelarit dhe a ishte ai veprimi më i mirë?</p> <p>Mësuesi e ndan klasën në grupe me nga 6 veta. Çdo nxënësi i caktohet një rol.</p>		
10'	Nxënësit luajnë skenën para klasës	Punë në grup	

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
10'	<p>Mësuesi drejton klasën në diskutime në grup, duke përdorur pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Si u ndjetë në rolin tuaj? ▶ Çfarë do të thotë të veshësh një shall për Lejlën dhe për autoritetet e universitetit ▶ Çfarë mendon për zgjidhjen të cilën nxënësit arritën ta negociojnë? ▶ Çdo të thotë për ju e drejtë për arsimim? ▶ Si do të ndiheshit nëse do t'ju pengonin të hynit në klasë për shkak, për shembull, të kryqit që mbani në qafë? ▶ Në perëndim, veshja e një shalli është një çështje kundërshtuese. Disa mendojnë se shalli shënon veçimin e grave; disa të tjerë mbrojnë idenë se është një mjet për të diskriminuar gruan, ndërkohë që disa mendojnë se shalli e vështirëson bashkëbisedimin ballë për ballë. Cili është mendimi juaj për këto ide? A duhet që dëshira e gruas për të vënë një shall të ketë më shumë rëndësi se çështjet që u ngritën këtu? 	E gjithë klasa	

B.2. Materiale

Fleta e punës 1 – Materiale për punë në grup

Material pune për grupin 1

Pohimi: E drejta për të shprehur përkatësinë fetare nuk është aq e rëndësishme sa të drejtat e tjera.

- a) A mendoni se të gjitha të drejtat e njeriut janë njëloj të rëndësishme? A mund të themi se disa duhet të respektohen më shumë se të tjerat?
- b) A mund të mendoni për ndonjë shembull ku një e drejtë nuk ka shumë rëndësi për ju, në një kohë të caktuar, por është shumë e rëndësishme për dikë të tjetër dhe anasjelltas?
- c) Diskutoni pohimin "Nuk ka gjëra më shumë të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme, sepse të gjitha duhet të respektohen njëloj". Si mund të arrihet kjo në shkollën ose komunitetin tuaj?

Material pune për grupin 2

Pohimi: Kultura ose kombësia nuk luajnë rol në bindjet fetare.

- a) Cilët janë faktorët që ndikojnë në zgjedhjet tona fetare? A jemi ne gjithmonë të vetëdijshëm për to?
- b) Diskutoni pohimin: "Nëse do të kishim lindur, ndoshta, në një kulturë të ndryshme, besimet tona do të ishin ndryshe dhe, në këtë mënyrë, do të na duhet të respektojmë ato që janë të ndryshme nga tonat". Cilat janë sjelljet e veçanta me të cilat mësuesit dhe nxënësit në shkollën tuaj mund të tregojnë respektin ndaj atyre që kanë besime të ndryshme fetare?

Material pune për grupin 3

Pohimi: Njerëzit duhet të heqin dorë nga të drejtat e tyre për të shprehur fenë e tyre, nëse kjo do t'u kërkohej nga shteti.

- a) Cilat janë mënyrat me të cilat shteti mbron të drejtën e njeriut për të shprehur lirisht përkatësinë fetare? Nëse ju do të ishit përgjegjës për menaxhimin e shkollës, si do të vepronit ju, për shembull, për të krijuar një mjedis në të cilin e drejta e shprehjes së fesë do të respektohej dhe do të përmbushej plotësisht?
- b) Diskutoni pohimin dhe mendoni një shembull: "Mund të ndodhë që të drejtat e secilit nuk do të mund të respektoheshin kurdoherë plotësisht, por kjo nuk do të thotë që ne nuk i zotërojmë këto të drejta"

Material pune për grupin 4

Pohimi: Atyre që nuk zbatojnë rregullat e institucioneve arsimore, do t'u hiqet e drejta për arsimim.

a) A është e drejta për arsimim një e drejtë e patjetërsueshme njerëzore apo ka ndonjë faktor që mund të kufizojë të drejtën e nxënësve për arsimim në institucionet arsimore?

b) Cilat vlera vlerësohen si përgjegjësi të nxënësve ndaj institucioneve arsimore?

c) Diskutoni pohimin: "Roli i shkollës është të tregojë përse disa sjellje janë të papranueshme dhe të lehtësojë dialogun me ata që nuk u binden rregullave. "Nëse ju jeni përgjegjës për menaxhimin e shkollës, si do ta lehtësonit këtë dialog?"

Fletë pune 2 – Çështja në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Një bisedë e hamendësuar ndërmjet një gjykatësi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe një nxënësi:

Gjykatësi: Cili është problemi?

Nxënësi: Shteti turk ka ndaluar veshjen e shallit islamik në institucionet e arsimit të lartë.

Gjykatësi: Shteti po kufizon të drejtat e individit? Në cilat kushte mund të jenë të pranueshme këto kufizime? Le të shohim çfarë thotë për këtë Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut:

Neni 9: Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Gjykatësi: Pra, cilat janë çështjet që duhet të marrë në shqyrtim Gjykata?

Nxënësi: A e kufizon ndalimi i veshjes së shallit islamik në institucionet e arsimit të lartë, lirinë e Lejlës për të shprehur besimin e saj. Nëse është kështu:

A ishte ky kufizim:	
<i>I parashikuar në ligj:</i>	Kufizimi nuk mund të jetë rezultat i një vendimi arbitrar i personit përgjegjës, por duhet të jetë i rrënjosur në ligj; qartë, saktë dhe i arritshëm nga të gjithë.
<i>Në kërkim të përmbushjes së një qëllimi:</i>	Kufizimi mund të vendoset vetëm në interes të sigurisë publike, të rendit, shëndetit ose moralit ose në mbrojtje të lirisë së të tjerëve. Vetëm këto janë arsyet që mund të justifikojnë kufizimet.
<i>I nevojshëm në një shoqëri demokratike:</i>	Përveç justifikimit të kufizimit në parim, a është realisht i nevojshëm në një shoqëri demokratike? A janë pasojat e një ndërhyrje të tillë në përputhje me qëllimin për të cilin bëhen?

Nxënësi: Çfarë ndodhi në fund?

Gjykatësi: Më poshtë keni mendimin e Gjykatës:

Ndërhyrje në lirinë e shprehjes së fesë	Parashikuar në ligj	Qëllim i përligjur Mbrojtja e rendit publik dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve	I nevojshëm në një shoqëri demokratike
Vendimi i Lejlës për të vënë shallin islamik motivohet dhe frymëzohet nga feja dhe, për këtë arsye, kufizimi përbën një akt që ndërhyr në të drejtën e për të shprehur përkatësinë e saj fetare	a) Gjykata Kushtetuese e Turqisë ka vënë re paraprakisht se kushtetuta nuk u jep qytetarëve të drejtën për të vënë shall në institucionet e arsimit të lartë.	a) Shteti duhet të mbetet sekularist, për të garantuar për këdo mbrojtje të barabartë të të drejtës për lirinë e fesë dhe për t'i mbrojtur nga lëvizjet ekstremiste që kërkojnë të imponojnë pikëpamjet e tyre fetare në të gjithë shoqërinë	a) Vendimet janë rezultat e shumë viteve të debatit publik në shoqërinë turke dhe në profesionin e mësimdhënies

Ndërhyrje në lirinë e shprehjes së fesë	Parashikuar në ligj	Qëllim i përligjur Mbrojtja e rendit publik dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve	I nevojshëm në një shoqëri demokratike
	b) Kufizimet për veshjen e shallit islamik në Universitetin e Stambollit kanë qenë të pranishme që në vitin 1994, edhe pse paralajmërimi për përgjegjësinë për një gjë të tillë, nuk ishte bërë i ditur para shkurtit të vitit 1998	b) Universiteti është vendi i pluralizmit dhe i barazisë gjinore; cili do të ishte ndikimi i veshjes së simboleve të tilla të paraqitura ose të perceptuara si detyrim, tek ata që kanë zgjedhur të mos e veshin atë në një vend ku pjesa më e madhe e popullsisë është myslimane	b) Megjithatë, ende lejohen forma të tjera të vëzhgueshme të besimit mysliman

► Opuz kundër Turqisë

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-92945#{"itemid":\["001-92945"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-92945#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Znj. Nahide Opuz, e lindur në 1972. Ajo është shtetase Turke me banim në Diyarbakir, Turqi. Në vitin 1990 Znj. Opuz nisi të bashkëjetonte me H.O. Ata u martuan në vitin 1995 dhe lindën 3 fëmijë, respektivisht në vitet 1993, 1994 dhe 1996.

Arsyetimi

Dhuna në familje është konsideruar prej kohësh një çështje private, në të cilën autoritetet nuk kishin të drejtë të ndërhyjnë. Duke u mbështetur në dokumentet dhe praktikën ndërkombëtare, ky vendim përcakton qartë se dhuna në familje është në fakt një çështje me interes publik dhe jo një çështje private ose familjare. Vendimi thekson se autoritetet duhet të arrijnë në një ekuilibër mes të drejtës për jetë private dhe të drejtës për integritet fizik dhe mendor të viktimës dhe që autoritetet duhet të marrin masat e duhura për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Ky është vendimi i parë i Gjykatës që vendosi se dhuna ndaj grave është një formë diskriminimi, përderisa shtetet dështojnë në mbrojtjen e grave në të njëjtën shkallë si burrat.

Faktet

1995 deri në 1998:

- Autoritetet Turke u informuan për katër incidente me objekt sjelljen e dhunshme të H.O. ndaj Znj. Opuz dhe nënës së saj, duke përfshirë: rrahje të herë-pas-herëshme, një zënkë që përfshinte përdorimin e thikës dhe H.O. që shtypte me makinë ankuesen dhe nënën e saj, aksident gjatë të cilit të dy viktimat morën plagë kërcënuese për jetët e tyre;
- tre denoncime u regjistruan për kërcënim me vdekje, dhunë fizike dhe tentativë vrasje;
- H.O. u arrestua dy herë, por më pas u lirua, për shkak se ankuesja dhe nëna e saj tërhoqën denoncimet respektive, duke mos u lënë rrugë tjetër gjykatave të brendshme, veçse të pushonin çështjet;
- megjithatë, për shkak të seriozitetit të plagëve të nënës së ankuses, një nga procedimet penale vijoi dhe i kushtoi H.O. tre muaj burgim, dënim që më pas u shndërrua në gjobë.

2001 deri në 2002:

- H.O. plagosi ankuesen me thikë shtatë herë, u gjobit dhe më pas u lirua.

- ▶ nëna e ankueses kërkoi që H.O. të ndalohej, për shkak se ajo dhe e bija ishin detyruar më herët që të tërhiqnin denoncimet e tyre nga H.O. Katër denoncime u shënuan mes 1998 dhe 2002, me pretendimin se ankuesja dhe nëna e saj ishin në rrezik serioz;
- ▶ H.O. u mor në pyetje shumë herë dhe eventualisht u la i lirë;
- ▶ Në 11 Mars, kur ankuesja dhe e ëma po transferoheshin në Izmir, H.O. detyroi automjetin të ndalonte, hapi derën e pasagjerëve dhe qëlloi nënën e ankueses për vdekje.

Beteja ligjore

- ▶ 15 Korrik 2002: një kërkesë-padi u parashtrua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- ▶ Mars 2008: H.O. u dënua me burgim të përjetshëm për vrasje dhe për mbajtjen pa lejë të armëve të zjarrit. Megjithatë duke qenë se H.O. pretendoi se reagimi i tij ishte provokuar nga veprimet e vjehrrës së tij, si dhe për shkak se, gjatë procesit gjyqësor, ai kishte paraqitur një "sjellje të mirë", dënimi u ul në 15 vjet e dhjetë muaj burgim;
- ▶ Prill 2008: nga ankuesja u parashtrua një tjetër denoncim, ku i kërkoheshin autoriteteve të merrej nën mbrojtje ajo dhe i dashur i saj pasi ishin kërcënuar me jetë nga ish-bashkëshorti;
- ▶ Maj 2008: ankuesja iu ankua Gjykatës së Strasburgut në lidhje me dështimin e autoriteteve Turke për të garantuar marrjen e masave mbrojtëse;
- ▶ 21 Nëntor 2008: pas një sërë shkëmbimeve të informacionit ndërmjet Gjykatës dhe autoriteteve kombëtare, Qeveria Turke informoi Gjykatën në lidhje me masat specifike që ishin marrë për të garantuar jetën e ankueses nga kërcënimet me jetë të ish-bashkëshortit.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore parashtruar Gjykatës

Duke marrë parasysh ngjarjet e sipër përmendura dhe vendimet e dhëna nga gjykatat e brendshme, ankuesja vendosi që t'i drejtohej me kërkesë-padi Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke referuar si bazë ligjore dispozitat e Konventës si vijon:

Neni 2: E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor pas dënimit për një krim për të cilin dënimi është parashikuar me ligj.

Ankuesja pohonte se autoritetet dhe shoqëria në përgjithësi e toleronin dhunën në familje, duke u garantuar autorëve në këtë mënyrë pandëshkueshmëri. Ajo pretendonte që:

- ▶ autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë për të mbrojtur atë dhe nënën e saj nga H.O.;
- ▶ masa e dënimit të dhënë për H.O. ishte shumë më e vogël se dënimi i dhënë zakonisht për kryerjen e veprës së vrasjes, me pretendimin se, në këtë rast, vrasja justifikohet si "krim nderi".

Krim nderi: përfshin dhunën e ushtruar nga ata që synojnë ruajtjen e reputacionit dhe familjes së tyre në komunitet.

Neni 3: Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Paditësja ishte ankuar se autoritetet nuk kishin bërë asgjë për parandalimin e dhunës, plagëve apo kërcënimeve të përsëritura me vdekje që ishin shkaktuar nga ish-bashkëshorti ndaj saj, çka i kishin shkaktuar asaj dhimbje dhe frikë.

Neni 14: Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ankuesja pretendonte që:

- ▶ legjislacioni Turk ishte diskriminues ndaj grave, qëkurse i trajtonte gratë dhe vajzat si qytetare të dorës së dytë dhe, përgjithësisht, jetën e gruas si inferiore, në emër të unitetit familjar. Fakti që H.O. mori një dënim prej 15 vitesh burgim e përforconte këtë keq-interpretim;
- ▶ ndërsa ajo i pranonte ndryshimet në legjislacionin penal dhe civil, dhuna në familje vijonte të shkaktohej nga burrat dhe nga sundimi i pa ndëshkueshmërisë.

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

Në 9 Qershor 2009, Gjykata u shpreh se, në lidhje me:

Nenin 2: E drejta për jetën

- ▶ shtetet Kontraktuese të Konventës kanë detyrimin pozitiv për të marrë masat e duhura me qëllim mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre;
- ▶ sa i përket dhunës në familje, analiza e praktikave të shteteve të ndryshme tregon se sa më e rëndë të jetë vepra penale dhe sa më i lartë të jetë rreziku i kryerjes së veprave të tjera të mundshme penale, aq më të mëdha janë mundësitë që prokuroria të vijojë hetimet edhe nëse denoncimet tërhiqen;
- ▶ për shkak se ka pasur përshkallëzim të dhunës kundër ankuseses dhe nënës së saj nga H.O., autoritetet duhet të kishin marrë masat e duhura mbrojtëse në mënyrë që të parandaloheshin akte të mëtejshme dhe të parashikueshme të dhunës. Autoritetet kishin dështuar në analizën e arsyeve se përse denoncimet ishin tërhequr dhe, se nuk duhej të trajtonin dhunën në familje thjesht si një "çështje private". Ky ishte një justifikim i pamjaftueshëm për autoritetet dhe dështimin e tyre për të ndërhyrë në rastin e ankuseses.

Neni 3: Ndalimi i torturës

- ▶ shteti kishte detyrimin pozitiv për të parandaluar abuzimin nga aktorët jo-qeveritar;
- ▶ dhuna psikologjike dhe fizike e vuajtur nga ankuesja u konsiderua nga Gjykata si keqtrajtim brenda kuptimit të Nenit 3 të Konventës;
- ▶ megjithëse shteti kishte marrë masa për të mbrojtur ankuesen, ato nuk ishin të mjaftueshme dhe shteti, kështu, kishte dështuar në përpjekjen e tij për t'i kujdesur si dhe sa duhet për të.

Neni 14: Ndalimi i diskriminimit

- ▶ Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Përfundim: Gjykata u shpreh unanimisht se sistemi gjyqësor ekzistues nuk e përmbushte rolin e tij në parandalimin e dhunës për të drejtën e jetës që kishte nëna e ankueses apo dhe keqtrajtimin që ajo kishte vuajtur kur ishte gjallë. Për më tepër, Gjykata konstatoi se sjellja e autoriteteve, sa i përket dhunës në familje, rezultonte në diskriminim. Si pasojë Gjykata gjeti shkelje të Neneve 2, 3 dhe 14.

Parimet themelore

Detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur individët nga dhuna në familje.

Shtetet Kontraktuese kanë një detyrim për mbrojtjen e individëve nën juridiksionin e tyre nga abuzimet e mundshme me të drejtat e njeriut nga aktorët jo-shtetërorë. Kjo vlen edhe për dhunën në familje, dhe madje edhe në mungesë të ankuesit ose nëse ankuesi ka tërhequr denoncimin. Kjo mbrojtje duhet të jetë efektive, praktike dhe ligjore.

Dhuna ndaj grave si formë diskriminimi

Nëse shteti nuk arrin t'i përgjigjet në mënyrën e duhur dhunës me bazë gjinore, ky dështim do të konsiderohet diskriminim dhe shkelje e Nenit 14 të Konventës, duke qenë se dhuna ndaj grave është shprehje e diskriminimit nëpërmjet ligjit (nga ana procedurale) ose drejt për drejt në praktikë.

Çfarë ndodhi më tej?

Në lidhje me masat e veçanta, ankueses i është dhënë një "shpërblim i drejtë". Megjithatë, procesi penal kundër H.O. ishte në vazhdim dhe Komiteti i Ministrave është ende në pritje të informacionit se cili është vendimi i marrë. Një shembull i masave të përgjithshme të marra është edhe Plani Kombëtar i Veprimit 2007-2010, i hartuar për të luftuar dhunën ndaj grave.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Koncepte/tema: detyrimi i shtetit për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarive, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë dhe përshkruajë pasojat e dhunës në familje;
- ▶ të përshkruajë fushën e veprimit të nenit 2, 3 dhe 14 të Konventës në lidhje me dhunën në familje;
- ▶ të përshkruajë mënyrën e arsyetimit të Gjykatës në çështjen Opuz;
- ▶ të shpjegojë dhunën me bazë gjinore si formë të diskriminimit;
- ▶ të shpjegojë se dhuna në familje është një çështje e interesit publik, më shumë se një çështje familjare.

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarive, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të shpjegojë çështjen Opuz dhe rëndësinë e saj;
- ▶ të diskutojë për ndikimin që mund të ketë vendimi i Gjykatës;
- ▶ të diskutojë dhunën në familje nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarive, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të tregojë dhembshuri për viktimat e dhunës në familje;
- ▶ të tregohet pasiv kur përballlet me situata të dhunës në familje.

Kohëzgjatja: 45 minuta

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
15'	<p>1. Hyrje në çështjen Opuz</p> <p>Nxënësit formojnë një rreth. Ata ndajnë me njëri-tjetrin hipotezat për çfarë ndodhi.</p> <p>Mësuesi projektton në mur një përmbledhje të shkurtër të çështjes (pa vendimin). Një nxënës lexon përmbledhjen me zë të lartë. Më pas klasa diskuton faktet e çështjes. Njëri prej nxënësve shënon në një tabak letre ose në dërrasën e zezë. Nëse diskutimi ndërpritet papritur, mësuesi vazhdon me pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ A është e lejueshme për H.O. të qëllojë dhe të kërcënojë gruan e tij? ▶ A ka H.O dhe gruaja e tij të njëjtat të drejta? ▶ Cilën të drejtë mund të përdorë Nahide për të paditur burrin e saj? Çfarë mund të bëjmë ne në rastet kur jemi të abuzuar ose të trajtuar në mënyrë të padrejtë? Si mund të veprojmë? ▶ Çfarë mund të ndodhë nëse shteti nuk bën asgjë? ▶ A ka autoritet më të lartë dhe më të fuqishëm se shteti? 	E gjithë klasa	
15'	<p>2. Punë në grup</p> <p>Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëri përfaqëson ankuesin (Nahide), tjetri përfaqëson Turqinë. Të dy grupeve u jepen faktet e çështjes dhe tekstet e konventës. Nxënësit duhet të identifikojnë nenet që zbatohen në rastin konkret. Ato duhet të mendojnë edhe për argumentet që do të përdorin për të mbështetur mendimin e tyre. Ata renditin nenet dhe argumentet në tabelë.</p>	Punë në grup	Tabak i madh letre
	<p>Një përfaqësues i grupit i paraqet rezultatet klasës. Mësuesi mbledh nenet dhe argumentet dhe i grupon në tabelën e zezë. Të dy grupet mund të pyesin njëri-tjetrin për argumentet e përdorura. Në fund mësuesi i njeh nxënësit me vendimin.</p>	E gjithë klasa	

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit- veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
10'	3. Mbyllja Nxënësit ndahen në 5 grupe. Ato diskutojnë ndikimin e çështjes në temat në vijim: rolet gjinore, media, dhuna në familje, praktika ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Ata i shkruajnë mendimet e tyre në copa të vogla letre dhe i ngjisin ato në poste të përgatitura paraprakisht. Ato mund të shtojnë edhe fotografi të marra nga fillimi i veprimtarisë	Punë në grup	
5'	Në një diskutim përmbledhës klasa diskuton gjetjet kryesore. Mësuesi komunikon disa fjalë përmblylëse të veprimtarisë	E gjithë klasa	

3.5. Tema 4 – Unë dua një zë!

3.5.1. Hyrje në temë dhe në çështjet

- ▶ **Aleksej kundër Ruisë:** A duhet të lejohet një protestë që mbrohet lirinë demokratike, por shqetëson shumicën e popullsisë?
- ▶ **Jersild kundër Danimarkës:** Trajton çështjen e intolerancës. A është më mirë ta mbulojmë apo ta shfaqim hapur, për t'u marrë më mirë me ekstremizmin?

Si i përgatitim të rinjtë për të marrë pjesë aktivisht në jetën politike? Cilat janë kufizimet e lirisë së shprehjes. Rëndësia e të mësuarit për t'i dhënë zë mendimit tënd, duke respektuar edhe mendimin e të tjerëve, përbën një ndër shembujt më të rëndësishëm të “të drejtave dhe përgjegjësi” për të cilët do të dëgjojnë të rinjtë.

► **Aleksejev kundër Rosisë**

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-101257#{'itemid': \['001-101257'\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-101257#{'itemid': ['001-101257']})

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Nikolay Aleksejev, është një aktivist i LGBT, i lindur në vitin 1977 dhe banues në Moskë.

Arsyetimi

Neni 11 i Konventës mbron lirinë e organizimit dhe të tubimit paqësor dhe është një nga gurët e themelit të shoqërive demokratike. Dispozita e këtij neni përfshin të drejtën e bashkimit në sindikata dhe të protestës paqësore, për shembull, në formën e paradës, marshimeve ose të procesioneve (varganëve). Kjo është shprehje demokracie dhe një mënyrë thelbësore për të sjellë ndryshime në shoqëri. Neni 11 ndërthuret shpesh edhe me të drejta të tjera në nenet 8, 10, 5 etj. Ky rast hulumton kufizimin e pajustificuar të të drejtave të garantuara nga Neni 11 i Konventës, të bazuar në diskriminimin që ka në bazë orientimin seksual.

Faktet

2006 deri në 2008: paditësi ndihmonte në përgatitjen e marshimeve që do të mbaheshin në Moskë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me komunitetin gei-lezbik në Rusi, si dhe promovimin e tolerancës dhe respektit ndaj të drejtave të njeriut.

15 Maj 2006: organizatorët informuan zyrën e kryetarit të bashkisë lidhur me qëllimin e tyre për të realizuar disa marshime dhe ndërmorën iniciativën për të bashkëpunuar me autoritetet ligj-zbatuese lidhur me garantimin e sigurisë, respektin për rendin publik si dhe kufizimet e zhurmës.

18 Maj 2006: leja për organizimin e marshimeve u refuzua me arsyen e ruajtjes së sigurisë dhe të rendit publik, pasi një sërë peticionesh kundër organizimit të marshimeve ishin firmosur dhe dërguar në adresë të disa institucioneve. Autoritetet mendonin se ekzistonte rreziku i shpërthimit të reagimeve të dhunshme, të cilat më pas mund të shkaktonin edhe prishje të rendit dhe trazira masive.

18 deri në 23 Maj 2006: organizatorët më pas informuan zyrën e kryetarit të bashkisë lidhur me synimin e tyre për të organizuar stenda të vogla në vend të marshimeve, por lejet u refuzuan sërish.

26 Maj 2006: kryetari i bashkisë dhe kabineti i tij u cituan të kishin thënë në media se asnjë paradë gei nuk do të lejohej të mbahej në Moskë për asnjë lloj arsyeje "për sa kohë që kryetari aktual i bashkisë të kishte mandat". Kryetari i bashkisë bëri thirrje edhe

për një “fushatë aktive të mas-medies ... nëpërmjet përdorimit të peticioneve të sjella nga individë të ndryshëm ose organizata fetare” kundër marshimeve dhe paradave gei.

Beteja ligjore

Në shtator dhe nëntor 2006 (respektivisht): ankuesi nisi sfida të pasuksesshme në gjykatat e brendshme kundër vendimeve që ndalonin marshimet ose vendosjen e stendave.

17 Shtator 2009: një kërkesë-padi u parashtrua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

21 Tetor 2010: Gjykata gjeti shkelje të Neneve 11, 13 dhe 14 të Konventës.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore parashtruar Gjykatës

Ankuesi u mbështet në Nenet 11 dhe 14 të Konventës (si dhe Nenin 13).

Neni 11: Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Ishte pranuar se organizmi i paradave u ndalua për shkak të ndërhyrjes së Z. Aleksejev në të drejtën e qytetarëve për t’u tubuar dhe organizuar paqësisht. Ankuesi kontestonte vendimet, duke thënë se marshimet e planifikuara ishin në përputhje me legjislacionin, pasi as Vendimet e Asamblesë Ruse dhe as mjetet e tjera legjislative nuk parashikonin ndalime për organizimin e protestave publike. Ankuesi, më tej, kundërshtoi arsyet legjitime në këndvështrimin e Qeverisë Ruse për mosdhënien e lejes, dhe përkatësisht:

- ▶ mbrojtja e sigurisë publike dhe parandalimi i trazirave: ndërsa stendat dhe paradat synonin të organizoheshin për qëllime paqësore Qeveria Ruse nuk kishte vlerëzuar aspak gjasat që kundër-protestat të mund të krijonin trazira;
- ▶ ruajtja e moralit: Qeveria Ruse e përcaktonte “moralin” si qëndrimin dominues të opinionit publik, çka në vetvete nuk përfshin nocionet e diversitetit dhe pluralizmit të cilat janë edhe devizë e Konventës;
- ▶ mbrojtja e të drejtave dhe lirisë të të tjerëve: parakaluesit nuk kishin qëllime të dëmtonin por përkundrazi t’i garantonin përfitime shoqërisë Ruse, nëpërmjet promovimit të respektit dhe tolerancës për komunitetin LGBT.

Gjykata duhet të përcaktonte edhe nëse ndalimet ishin “të nevojshme në një shoqëri demokratike” dhe në proporcion me qëllimet e synuara.

Neni 14: Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ankuesi u shpreh se, mënyra e ndjekur nga autoritetet për të vlerësuar kërkesat për lejet për të organizuar protestat, në vetvete, ishte diskriminuese dhe bazohej në orientimin seksual të tijin dhe të protestuesve të tjerë.

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

- ▶ Neni 11 mbron protestat që mund të bezdisin ose mund t'i shkaktojnë fyerje një grupi të caktuar opozitar, në mënyrë që shoqëria të ndajë pikëpamje të ndryshme në lidhje me çështjet që mund të prekin ndjeshmërinë e shumicës. Shteti ka detyrimin që të marrë masa të arsyeshme dhe të pranueshme që kanë për qëllim realizimin e demonstratave të ligjshme, në mënyrë sa më paqësore. Nuk ka pasur asnjë vlerësim të saktë risku nga autoritetet shtetërore në lidhje me rrezikun që buronte nga kundër-protestat;
- ▶ Rrethanat e protestave nuk do të rezultonin në polemika dhe përplasje civile të paralajmëruara nga autoritetet shtetërore;
- ▶ Duke marrë në konsideratë qëndrimet e mbajtura nga kryetari i bashkisë etj., vendimet e marra për të ndaluar organizimin e paradave nuk janë marrë bazuar në shqyrtimin e fakteve të arsyeshme të lidhur me çështjen. Ato nuk përmbushnin ndonjë "nevojë të ngutshme sociale" si dhe nuk ishin "të nevojshme në një shoqëri demokratike". Për këtë arsye, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 11 në këtë rast;
- ▶ Gjykata konstatoi gjithashtu se, për shkak të lidhjeve ndërmjet komenteve dhe qëndrimeve të kryetarit të bashkisë dhe të vendimit për të mos lejuar protestat, arsyeja kryesore se përse protestuesit nuk u lejuan të parakaloni në marshim ishte se Qeveria Ruse besonte se protestat mund të promovonin homoseksualitetin. Marzhi i vlerësimit, i lënë në kujdesin e shteteve në rastet e çështjeve që përfshijnë homoseksualët, është shumë i ngushtë. Gjykata, pra, konstatoi edhe shkelje të Nenit 14.

Parimet themelore

- ▶ Për të vendosur nëse një ndërhyrje në Nenin 11 është në proporcion me një synim legjitim, Gjykata do të kryejë një ushtrim balancimi ndërmjet të drejtës së ankuesit dhe interesave kundërshtarë të autoriteteve;
- ▶ Neni 11 mbron protestuesit që mund të fyejnë personat të cilët besojnë në ideale diametralisht të kundërta nga ato të tyre;
- ▶ Shteti është i detyruar të marrë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme me qëllim garantimin e protestave paqësore;
- ▶ Hapësira e vlerësimit e lënë në dorën e shteteve në rastet e çështjeve që përfshijnë homoseksualët është shumë i ngushtë.

Çfarë ndodhi më tej?

Komiteti i Ministrave ka shprehur shqetësim lidhur me moszbatimin e këtij vendimi, për shkak se ankuesit ende nuk i është dhënë mundësia për të organizuar një paradë gay në Moskë. Në vitin 2013 u miratuan edhe ligje që ndalonin “propagandën homoseksuale”.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Hyrje: në këtë mësim do të hedhim një vështrim në fushë e veprimit dhe në hapësirën që kufizon lirinë e tubimit dhe të organizimit

Koncepte/tema: kufizimi i lirisë së tubimit dhe shoqërimit si dhe akti i baraspeshës ndërmjet të drejtës së individit për protesta paqësore, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së sigurisë publike, parandalimit të çrregullimeve, mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve dhe moralit, nga ana tjetër.

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të përshkruajë dy tipat e ndryshëm të lirive që mbrohen nga neni 11 i Konventës;
- ▶ të shpjegojë si interpretohet neni 11 nga Gjykata kur trajton çështjen e baraspeshës ndërmjet tij dhe të drejta të tjera dhe me interesa konkurruese;
- ▶ të interpretojë zbatimin e nenit 14 të Konventës në dritën e diskriminimit të bazuar në orientimin seksual;
- ▶ të dallojë aspektet ligjore që merr parasysh Gjykata kur vendos nëse shteti mund të kufizojë ligjërisht lirinë e tubimit dhe të organizimit.

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të shpjegojë arsyetimin e çështjes së Aleksejev kundër Rusisë;
- ▶ të identifikojë dhe përshkruajë argumentet e të dy palëve;
- ▶ të komunikojë në mënyrë të efektshme një argument;
- ▶ të dëgjojë pikëpamjet e të tjerëve;
- ▶ të kritikojë një argument dhe ta mbrojë qëndrimin e tij.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të vlerësojë rëndësinë historike dhe bashkëkohore të nenit 11 të Konventës në një shoqëri demokratike;
- ▶ të parashikojë konfliktet që neni 11 mund të krijojë me nenet e tjerë të Konventës;
- ▶ të vlerësojë rëndësinë e mbrojtjes që siguron neni 14, kur ushtrohet liria e tubimit dhe e organizimit.

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
10'	<p>1. Diskutim klase për çështje të përgjithshme</p> <p>Mësuesi përgatit citate për aktivizimin, fuqizimin dhe veprimin, si dhe për simbolet e aktivizimit shoqëror (për shembull, simbole paqeje, ylberi i LGBT) dhe i shfaq ato në të gjithë klasën, në mënyrë që nxënësit t'i lexojnë kur hyjnë ose dalin nga klasa.</p> <p>Klasa diskuton për çështjen e mëposhtme: pse është e rëndësishme e drejta e tubimit dhe organizimit paqësor në një shoqëri demokratike?</p> <p>Klasa ftohet të japë ide që do të shërbejnë për të krijuar, në një fletë të madhe letre ose në një vend të dukshëm në klasë, një diagram rreth konceptit “ndryshimet e demokratike të së kaluarës”, për shembull, emancipimi i gruas, heqja e aparteidit, ndalimi i duhanit. Mësuesi shpjegon si neni 11, duke mbrojtur tubimin dhe organizimit, kthehet në liri themelore drejt ndryshimeve demokratike.</p>	E gjithë klasa	
10'	<p>2. Hyrje në nenn 11 dhe 14 të Konventës</p> <p>Mësuesi shpjegon në klasë kuptimin e nenit 11 të Konventës dhe, veçanërisht, paragrafin 2, si dhe kriteret që duhet të përmbushen për të justifikuar një ndërhyrje. Po kështu, shpjegohet edhe kuptimi dhe fusha e nenit 14.</p> <p>3. Faktet e çështjes Aleksejev kundër Ruisë</p> <p>Mësuesi bën të njohura faktet, shpjegon vendimin dhe skicon parimet themelore.</p>	E gjithë klasa	
25'	<p>3. “Ne jemi të gjithë aktivistë”, simulim demonstrimi</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Klasa ndahet në grupe me 3 deri 5 veta; ▶ Çdo grupi i jepet 5 minuta kohë për të dhënë ide në lidhje me pyetjen “Ku vini re padrejtësi në komunitetin tuaj/ shkollë/vendi/botë” dhe vendosni për një “çështje” për të cilën i gjithë grupi ndan të njëjtat ndjenja të forta. 		<p>Tabakë të mëdhenj letre për parulla,</p> <p>Fletë të mëdha për çdo grup</p>

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
	<ul style="list-style-type: none"> ▶ I jepni çdo anëtari të grupit nga 5' për të krijuar parulla për grupin, më thënie dhe simbole në shërbim të "çështjes" së tyre, që mbron ndryshimin. ▶ Jepini klasës 7 minuta për komente. Çdo grup ka një minutë kohë për t'u ngritur dhe për të mbajtur lart parullën e vet, duke ua shpjeguar "Kauzën" e tyre të gjithë klasës. ▶ Në një kohë prej 7 minutash kërkoni nga nxënësit të ngrenë duart nëse ndihen të pakënaqur ose nuk janë dakord me "kauzat" e tjera, duke shpjeguar edhe arsyen e qëndrimit të tyre. Mësuesi e lidh këtë me aktin e balancimit të të drejtave dhe shqyrtimet që lidhen me zbatimin e nenit 11. Mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të përfytyrojnë si do të kishte qenë demonstrimi në rast se do të ishin grupi me numrin më të vogël të votave dhe, për këtë arsye, nuk do të lejoheshin të paraqisnin "kauzën" e tyre para klasës. Kjo do të theksojë rëndësinë e nenit 14 (ose mësuesi do ta bëjë këtë përmes një lojë me role) 		

► Jersild kundër Denmarkës

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-57891#{"itemid":\["001-57891"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-57891#{)

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Ankuesi, Jens Olaf Jersild, është një gazetar Danez, i punësuar nga Danish Broadcasting Corporation. Ankuesi punonte në programin televiziv të Lajmeve të së Dielës.

Arsyetimi

Liria e shprehjes konsiderohet si një e drejtë themelore në shoqëritë demokratike. Mediat gëzojnë mbrojtje sipas Nenit 10 të Konventës, ndërsa bartin përgjegjësi të caktuara në lidhje me ushtrimin e pushtetit të tyre. Ky rast portretizon një konflikt të perceptuar ndërmjet të drejtës së shprehjes dhe interesave konkurrues publikë (këtu, mbrojtja e të drejtave të minoriteteve). Në këto raste, Gjykata duhej të vlerësonte dhe peshonte interesat e kundërt të palëve, në mënyrë që të vendoste nëse kishte apo jo baraspeshim dhe paanësi në nivel kombëtar.

Faktet

31 Maj 1985: ankuesi kontaktoi dhe intervistoi pjesëtarë të grupeve të ndryshme rinore, të ashtu-quajtur "Greenjackets" (Xhaketajeshilët), të cilët e kishin tërhequr vëmendjen e shtypit Danez për shkak të sjelljeve të tyre tej mase raciste.

21 Korrik 1985: pamjet filmike janë redaktuar nga ankuesi dhe versioni përfundimtar përfshinte anëtarë të grupit "Greenjackets" (Xhaketajeshilët) duke bërë komente fyese për emigrantët dhe grupet e minoriteteve etnike në Danimarkë. Gazetari pretendonte se qëllimi i tij nuk ka qenë që të promovojë intolerancën, por përkundrazi, të sfidojë vetëkënaqësinë për qëndrimet raciste në shoqërinë Daneze. Kundër programit është bërë një ankesë. Individët e përfshirë ishin marrë në pyetje dhe, më pas, ishin dënuar për shprehjen e deklaratave publike kërcënuese, fyese ose poshtëruese ndaj një grupi personash mbi bazën e racës, kombësisë dhe etnisë.

24 Prill 1987: ankuesi u dënua dhe u gjobit nga një gjykatë Daneze, me akuzën e dhënies së ndihmës dhe nxitjen e personave për të kryer krimet sa më sipër. Ai u dënua me 5 ditë burgim dhe një gjobë në të holla.

Beteja ligjore

Apelet pasuese të Z. Jersild ishin të pasuksesshëm, për shkak se gjykatat Daneze kishin konstatuar se duke kontaktuar të rinjtë dhe duke përfshirë në skenarin e emisionit

komente raciste, ankuesi kishte shkaktuar publikimin e qëndrimeve raciste. Ai kishte bashkëpunuar në publikimin e këtyre deklaratave.

13 Shkurt 1989: kur vihen në balancë interesat e personave të fyer nga komentet e bëra, përkundrejt të drejtës së publikut për t'u informuar, gjykatat e brendshme ishin shprehur se

25 Korrik 1989: një kërkesë – padi u parashtrua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

23 Shtator 1994: Gjykata konstatoi shkelje të Neni 10 të Konventës. Ajo u shpreh se, duke e gjykuar programin si një të tërë, ai nuk kishte për qëllim që të promovonte pikëpamjet dhe idetë raciste.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore parashtruar Gjykatës

Ankuesi pretendoi se dënimi i tij dhe vetëm vendimi për të shpallur atë vendim për dënim ishin në shkelje të së drejtës së lirisë të garantuar nga Neni 10.

Neni 10: Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

U pranua se dënimi i ankuesit përbënte ndërhyrje të drejtpërdrejtë me të drejtën e tij për t'u shprehur lirisht. U ra gjithashtu dakord që kjo ndërhyrje ishte e parashikuar shprehimisht në ligj me dispozitë, ndërsa vetë vepra ishte përcaktuar në legjislacion. Në mënyrë të ngjashme, nuk u kontestua fakti që ndërhyrja synonte realizimin e një synimi të ligjshëm, konkretisht mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të atyre të cilët ishin bërë objekt i komenteve raciste.

E vetmja çështje për të cilën kishte debat ishte nëse për një shoqëri demokratike ishte i nevojshëm një dënim i tillë. A krijonte dënimi dhe burgosja një terren të balancuar mes të drejtës së ankuesit për t'u shprehur lirisht dhe mbrojtjes së të tjerëve? Apo, a ishte ndërhyrja jo-proporcionale krahasuar me qëllimin e saj? A kishin parashtruar gjykatat daneze arsye të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të justifikuar dënimin dhe eventualisht burgosjen?

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

Gjykata konstatoi se, në këtë rast, interesat konkurruese ishin e drejta e lirisë së shprehjes të ankuesit dhe e drejta e të tjerëve për t'u mbrojtur nga urrejtja racore.

Gjykata theksoi rëndësinë e luftës kundër diskriminimit racor si dhe rëndësinë e lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike, dhe në veçanti, mbrojtjen e veçantë që i jepet shtypit dhe medias në përgjithësi. Nuk është i rëndësishëm vetëm fakti se media ka të drejtë që t'i përcjellë publikut mesazhe, por është gjithashtu e drejtë e publikut për t'i marrë këto mesazhe. Në mënyrë që ndërhyrja të jetë e justifikuar, duhet të ruhet baraspesha dhe paanshmëria në trajtimin e këtyre dy interesave konkurrues. Me qëllim marrjen e një vendimi, Gjykata do të duhej të shqyrtonte ndërhyrjen në dritën e çështjes në tërësi.

Duke e marrë në konsideratë programin si të tërë, Gjykata u shpreh se në ai nuk synonte përhapjen e ideve dhe pikëpamjeve raciste. Nuk kishte arsye të vlefshme për të dyshuar faktin se programi synonte të kontribuonte ndaj një debati publik ekzistues, duke tërhequr vëmendjen ndaj mentalitetit dhe prejardhjes sociale të disa të rinjve me pikëpamje raciste. Për më tepër, Gjykata nuk gjeti asnjë arsye për të vënë në pikëpyetje natyrën dhe vlerat informative të programit, i cili synonte një publik të arsimuar. Megjithatë nuk identifikonte shprehimisht imoralitetin dhe rreziqet e promovimit të urrejtjes raciale, sjellja e ankuesit gjatë intervistës tregonte se ai nuk ndante asnjë nga pikëpamjet e të ashtu-quajturve "Greenjackets" (Xhaketajeshilët).

Pavarësisht se komentet për të cilët të rinjtë ishin dënuar nuk e gëzonin mbrojtjen e Nenit 10, Gjykata theksoi qëndrimin se qëllimi i ankuesit në prodhimin dhe transmetimin e programit nuk ishte aspak racist. Për këtë arsye, Gjykata doli në përfundimin se ka pasur një shkelje të Nenit 10 lidhur me të drejtën e ankuesit për t'u shprehur lirish.

Parime themelore

- ▶ Për të vendosur nëse ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes është në proporcion me një qëllim legjitim, Gjykata do të kryejë një ushtrim balancues ndërmjet të drejtës së ankuesit dhe interesave konkurrues;
- ▶ Gjatë këtij ushtrimi, Gjykata do të krijojë bindjen e saj duke e marrë në konsideratë programin si të tërë;
- ▶ Shtypi gëzon mbrojtje të veçantë sipas Nenit 10 të Konventës, për arsye të funksionit publik që media ka për informimin në lidhje me debate që cekin interesin publik;
- ▶ Gjykata do të hetojë gjithashtu nëse gjykatat e brendshme kanë ofruar arsyet përkatëse të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë e shprehjes.

Çfarë ndodhi më tej?

Pas vendimit të Gjykatës, një gjykatë daneze vendosi, në datën 24 Janar 1995, të lejonte rishqyrtimin e çështjes kundër ankuesit. Në lidhje me masat e përgjithshme, u miratua një sërë aktesh dhe vendimesh të brendshme në zbatim të parimeve të përcaktuara në çështjen Jersild.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Hyrje

Ky mësim hedh një vështrim mbi lirinë e shprehjes.

Koncepte/tema: kufizimi i lirisë së shprehjes dhe aktet që baraspeshojnë të drejtat e individit për t'u shprehur dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke përfshirë këtu edhe lirinë e fesë.

Objektivat e të nxënit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të përshkruajë tipat e ndryshëm të lirisë që mbrohen nga neni 9 dhe 10 Konventës;
- ▶ të shpjegojë mënyrën si neni 10 interpretohet nga Gjykata kur harmonizohet me një të drejtë tjetër, për shembull, me lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe fesë ose në rastin e interesave konkurruese;
- ▶ të identifikojë çfarë duhet të marrë parasysh kur vendos nëse është i mbështetur në ligj kufizimi që shteti i bën lirisë së shprehjes.

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë argumentet e kundërta;
- ▶ të komunikojë në mënyrë të efektshme një argument;
- ▶ të dëgjojë pikëpamjet e të tjerëve;
- ▶ të kritikojë një argument dhe të mbrojë qëndrimin e tij.

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të vlerësojë rëndësinë e nenit 9 dhe nenit 10 të konventës në një shoqëri demokratike;
- ▶ të parashikojë që neni 10 mund të krijojë konflikt me të drejtat e të tjerëve;
- ▶ të vlerësojë marrëdhëniet ndërmjet nenit 9 dhe 10 dhe baraspeshën që kërkohet në rastet kur ata prodhojnë konflikt.

Kohëzgjatja: 45 minuta

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
5'	1. Faktet e çështjes Jersil kundër Danimarkës. Fleta e punës 2 shpërndahet në klasë	E gjithë klasa	Fleta e punës 2
15'	2. Hyrje në nenet 9 dhe 10 të Konventës Më ndihmën e fletës së punës 1, mësuesi shpjegon kuptimin e neneve 9 dhe 10, veçanërisht paragrafin 2 të nenit 10 dhe kriteret që duhet të përmbushen për të justifikuar ndërhyrjen e shtetit.	E gjithë klasa	Fleta e punës 1
20'	3. klasa diskuton çështje të përgjithshme Në klasë diskutohen në klasë: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Përse është e rëndësishme e drejta e lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike? Identifikoni disa shembuj të lirisë së shprehjes në jetën e përditshme. ▶ Përse është e rëndësishme e drejta e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë në një shoqëri demokratike? Identifikoni disa shembuj të lirisë së fesë në jetën e përditshme. ▶ A është ndonjëra prej lirive të sipërpërmendura më e rëndësishme se të tjerat? A duhet lejuar shteti të kufizojë këto të drejta?	E gjithë klasa	
5'	4. Përfundime: parime të përgjithshme që rrjedhin nga vendimi Shpërndani fletën e punës 3 dhe 4, me parimet që dalin nga çështja e Jersild, në lidhje me interpretimin e nenit 10 dhe të baraspeshës në rastin e interesave konkurruese si në nenin 9.	E gjithë klasa	Fleta e punës 3 dhe 4

B.2. Material

Fleta e punës 1 - Teksti i nenit 9 dhe 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Neni 9 -Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 9 i shpjeguar

Neni 9 mbron lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe të besimit fetar. Paragrafi 1 qartësisht përcakton se këtu përfshihen dy liri: (i) liria e besimit fetar dhe e ndryshimit të besimit fetar; dhe (ii) liria e manifestimit të besimit fetar, qoftë si mendim ose në praktikë, për shembull, duke e dhënë mësim, nëpërmjet adhurimit, ushtrimit ose nëpërmjet mbajtjes/veshjes së simboleve fetare.

E drejta e parë quhet *forum internum*, që shprehimisht do të thotë "*forum i brendshëm*". Janë individët të cilët vendosin se cilën fe, mendim ose besim dëshirojnë të ndjekin dhe se shteti nuk mund të bëjë asgjë për t'i ndaluar ata. Për këtë arsye, kjo e drejtë konsiderohet si "*absolute*". Po aq e rëndësishme është mbrojtja nga ky nen i lirisë për të mos pasur një fe, mendim ose besim; askush nuk mund të detyrohet të besojë me imponim.

Liria e dytë – e manifestimit të një feje, mendimi ose besimi – quhet *forum externum*, që shprehimisht do të thotë "*forum i jashtëm*". Siç u tha edhe më sipër, kjo është liria e manifestimit të fesë ose besimit fetar. Megjithatë, kjo liri mund të kufizohet nga shteti, siç u përshkrua edhe në paragrafin 2 të Nenit 9. Nëse dikush ankohet përpara Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, (Gjykata) me pretendimin se shteti u ka kufizuar padrejtësisht lirinë e tyre të manifestimit të besimit fetar, Gjykata duhet të vlerësojë nëse masa e kufizimit i kapërcen kufijtë e të lejueshmes, duke shkelur kështu Nenin 9. Testi i zbatuar nga Gjykata me qëllim marrjen e një vendimi është i njëjtë me testin për kufizimin e lirisë së shprehjes, dhe shpjegohet më poshtë, në lidhje me Nenin 10.

Neni 10 - Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Shpjegimi i Nenit 10

Neni 10 mbron lirinë e shprehjes, e njohur gjerësisht si thelbësore për funksionimin e duhur të një shoqërie liberale dhe demokratike. Paragrafi 1 dëfton se mbron një gamë të gjerë idesh, dhe se Gjykata ka vendosur që kjo dispozitë përfshin edhe mbrojtjen e ideve të cilat mund të "tronditin", ofendojnë ose shqetësojnë" dikë. Këto ide mund të përcillen, ndër të tjera, nëpërmjet fjalimeve, protestave ose burimeve medietike, përfshi këtu edhe Internetin.

Neni 10 gjithashtu përfshin të drejtën e një individi apo grupi për të marrë dhe shpërndarë informacion. Për shembull, nëse një shtet e mbyll një gazetë, sepse nuk bie dakord me politikën e saj editoriale dhe me publikimet e saj, ky veprim mund të konsiderohet si shkelje e lirisë së publikut të gjerë për të lexuar gazetën, si dhe shkelje e lirisë së gazetës për t'u shprehur lirisht me opinione dhe për t'i ndarë ato me publikun.

Kufizimet e lirisë të përfshira në Nenet 9 dhe 10

Nenet 9 dhe 10 nuk janë "absolute", që do të thotë se në lirinë e manifestimit të një personi apo një grupi të një feje apo besimi fetar mund të ketë ndërhyrje nga shteti. Paragrafi i dytë i të dy neneve lejon disa kufizime të caktuara nga ana e shtetit, por vetëm kur ato përmbushin tre kriteret:

- ▶ kur janë të parashikuara në ligj;
- ▶ kur i shërbejnë zbatimit të një objektivi legjitim të renditur në paragrafin 2 (ruajtja e rendit publik);
- ▶ kur ndërhyrjet janë të "nevojshme në një shoqëri demokratike".

Sa i përket kriterit të tretë, Gjykata ka detyrimin që të vendosë se kur një masë, e cila kufizon lirinë e shprehjes ose lirinë e manifestimit të fesë ose besimit fetar është e "nevojshme në një shoqëri demokratike". Gjykata, nëpërmjet kësaj çështjeje, ka përshkruar këtë situatë në rastet si vijon:

- ▶ ka një nevojë të ngutshme për marrjen e kësaj mase (d.m.th. a e kërkon shoqëria këtë masë?);
- ▶ ka arsye të rëndësishme dhe të mjaftueshme për të marrë këtë masë (d.m.th. a mundet shteti të japë arsye për marrjen e kësaj mase?);
- ▶ masa është në përpjestim me objektivat/qëllimet e synuara (d.m.th. a mundet që shteti të kishte përdorur masa më të buta, le të themi për të parandaluar prishjen e rendit publik? Ai ishte kjo masë e nevojshme?).

Vetëm nëse Gjykata bindet që këto tre nën-kritere janë përmbushur, masa e marrë nga shteti, si ndërhyrje e "nevojshme në një shoqëri demokratike", nuk do të konsiderohet në shkelje të Nenit 10.

Fleta e punës 2 – Një përmbledhje e shkurtër e fakteve dhe arsytimit në çështjen Jersild kundër Danimarkës

Kronologjia

Ankuesi kontaktoi dhe intervistoi pjesëtarë të grupeve të ndryshme rinore, të ashtuquajtur "Greenjackets" (Xhaketajeshilët), të cilët e kishin tërhequr vëmendjen e shtypit Danez për shkak të sjelljeve të tyre, tej mase raciste. Pamjet filmike janë redaktuar nga ankuesi dhe versioni përfundimtar përfshinte anëtarë të grupit duke bërë komente fyese për emigrantët dhe grupet e minoriteteve etnike në Danimarkë. Gazetari pretendonte se qëllimi i tij nuk ka qenë që të promovojë intolerancën por përkundrazi, të sfidojë vetë-kënaqësinë për qëndrimet raciste në shoqërinë Daneze. Kundër programit u bë një ankesë. Individët e përfshirë ishin marrë në pyetje dhe më pas ishin dënua për shprehjen e deklaratave publike kërcënuese, fyese apo degraduese ndaj një grupi personash mbi bazën e racës, kombësisë dhe etnicitetit. Ankuesi u dënua dhe u gjobit nga një gjykatë Daneze me akuzën e dhënies së ndihmës dhe inkurajimin e personave për të kryer krimet në fjalë.

Apelimet e tij të mëvonshme ishin të gjithë të pasuksesshëm. Gjykatat Daneze u shprehën se duke kontaktuar të rinjtë dhe duke redaktuar programin në mënyrë të tillë që të përfshinte komente raciste ankuesi kishte shkaktuar publikimin e komenteve raciste. Pra ishte e qartë, sipas gjykatës Daneze, se ankuesi kishte dhënë ndihmën e tij në publikimin e këtyre deklaratave. Duke pranuar se interesat e atyre që ishin fyer nga këto komente duhej të balancoheshin me interesin e informimit të publikut të gjerë, gjykatat e brendshme ishin shprehur se vlera prej lajmi e qëndrimeve nuk ishte e mjaftueshme për të publikuar emisionin. Ankuesi parashtrroi një kërkesë – padi në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me pretendimin se dënimi i tij ishte në shkelje të së drejtës së tij për t'u shprehur lirisht, në zbatim të Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimi dhe arsytimi i Gjykatës

U pranua se dënimi i ankuesit përbënte ndërhyrje të drejtpërdrejtë me të drejtën e tij për t'u shprehur lirisht. U ra gjithashtu dakord që kjo ndërhyrje ishte e parashikuar shprehimisht në ligj me dispozitë, ndërsa vetë vepra ishte përcaktuar në legjislacion. Në mënyrë të ngjashme, nuk u kundërshtua fakti që ndërhyrja synonte realizimin e një synimi të ligjshëm, konkretisht mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të atyre të cilët ishin bërë objekt i komenteve raciste.

E vetmja çështje për të cilën kishte debat ishte nëse, për një shoqëri demokratike, është i nevojshëm një dënim i tillë. A krijonte dënimi dhe burgosja një terren të baraspeshuar mes të drejtës së ankuesit për t'u shprehur lirisht dhe mbrojtjes së të tjerëve? Ose, a ishte ndërhyrja jo në përpjesëtim të drejtë qëllimin e saj? A kishin parashtruar gjykatat daneze arsye të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të justifikuar dënimin dhe eventualisht burgosjen?

Gjykata konstatoi se interesat konkurruese në këtë rast ishin e drejta e lirisë së shprehjes të ankuesit dhe e drejta e të tjerëve për t'u mbrojtur nga urrejtja racore. Gjykata theksoi rëndësinë e luftës kundër diskriminimit racor si dhe rëndësinë e lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike, dhe në veçanti, mbrojtjen e veçantë

që i jepet shtypit dhe medias në përgjithësi. Nuk është i rëndësishëm vetëm fakti se media ka të drejtë që t'i përcjellë publikut mesazhe, por është gjithashtu e drejtë e publikut për t'i marrë këto mesazhe. Në mënyrë që ndërhyrja të jetë e justifikuar, duhet të ruhet baraspesha dhe paanshmëria në trajtimin e këtyre dy interesave konkurruese. Me qëllim marrjen e një vendimi, Gjykata do të duhej të shqyrtonte ndërhyrjen në dritën e çështjes në tërësi.

Duke e vlerësuar programin si të tërë, Gjykata u shpreh se ai nuk synonte përhapjen e ideve dhe pikëpamjeve raciste. Nuk kishte arsye të vlefshme për të dyshuar faktin së programi synonte të kontribuonte ndaj një debati publik ekzistues, duke tërhequr vëmendjen ndaj mentalitetit dhe prejardhjes sociale të disa të rinjve me pikëpamje raciste. Për më tepër, Gjykata nuk gjeti asnjë arsye për të vënë në pikëpyetje natyrën dhe vlerat informative të programit, i cili synonte një publik të arsimuar. Megjithëse nuk identifikonte shprehimisht imoralitetin dhe rreziqet e promovimit të urrejtjes raciale, sjellja e ankuesit gjatë intervistës tregonte se ai nuk ndante asnjë nga pikëpamjet e të ashtu-quajturve "Greenjackets" (Xhaketajeshilët).

Pavarësisht se komentet për të cilët të rinjtë ishin dënuar nuk e gëzonin mbrojtjen e Nenit 10, Gjykata theksoi qëndrimin se qëllimi i ankuesit në prodhimin dhe transmetimin e programit nuk ishte aspak racist. Për këtë arsye, Gjykata doli në përfundimin se gjykatat Daneze nuk i kishin marrë si duhet në konsideratë këto fakte. Për këto arsye, Gjykata votoi, në një rezultat 12 me 7, në favor të vendimit se kishte pasur shkelje të lirisë së shprehjes të Z. Jersild.

Mendimi i pakicës (në Gjykatë)

Siç u vu në dukje, shtatë gjyqtarë nuk ranë dakord me vendimin e Shumicës në Gjykatë. Ata shkruan 2 mendime mospajtuese.

Mendimi i parë mospajtues parashtronte se gjykatat Daneze, tashmë, kishin kryer në mënyrë të kujdesshme ushtrimin e balancës midis të drejtës së lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, dhe se Gjykata nuk duhej të zëvendësonte vlerësimin e saj. Gjykatat Daneze kishin vepruar me maturinë e tyre dhe, për rrjedhojë, gjatjet e tyre nuk mund të konsideroheshin në shkelje të Nenit 10.

Mendimi tjetër mospajtues i tre gjyqtarëve theksonte se deklaratat e risjella nëpërmjet programit nxisnin dhunën raciste të shprehur. Kjo pakicë mendonte se ankuesi nuk kishte bërë mjaftueshëm përpjekje për të sfiduar pikëpamjet raciste të shprehura, të cilat ishin shumë të nevojshme në mënyrë që të bëhej kundër-balancimi i duhur. Pra, dënimi nga gjykatat Daneze nuk ishte në shkelje të Nenit 10.

Përfundime

Parashikuar në ligj:

Fyerja ishte e parashikuar në ligj.

Synim i përligjur:

Si shprehet paragrafi 2 i nenit 10, vendimi për të akuzuar dhe dënuar Z. Jersild bazohej në idenë e mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtat e atyre që kanë qenë objekt i sjelljeve raciste.

I nevojshëm në një shoëri demokratike:

Qëllimi i programit ishte të ndihmonte debatin publik për prejardhjen e të rinjve që kishin pikëpamje të tilla, në mënyrë që të mos bëheshin racistë. Z. Jersild nuk ndante të njëjtat pikëpamje me të intervistuarit, për këtë arsye ishte e panevojshme të akuzohej dhe të dënohej për një gjë të tillë.

Mendimi i kundërt:

Gjykata daneze kishte trajtuar si duhet baraspeshën ndërmjet shprehjes dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave që ishin objekt i diskutimeve, kështu që nuk ishte e nevojshme ndërhyrja e gjykatës; z. Jersild nuk bëri asnjë përpjekje për të sfiduar pikëpamjet raciste, për këtë arsye dënimi ishte i nevojshëm.

Fleta e punës 3 – Parime të përgjithshme për t’u marrë në konsideratë në çështjen Jersild

Interpretimi i përgjithshëm i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)


1. Kur vendoset nëse një masë e caktuar është parashikuar shprehimisht nga legjislacioni i brendshëm, kemi të bëjmë me një çështje parimi, që përcakton se janë kryesisht autoritetet kombëtare që duhet të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjet e tyre.
2. Kur merret në konsideratë “përpjesëtueshmëria” si një masë, varësia kryesore është nga rrethanat specifike të çështjes. Shpesh pyetja që duhet të bëhet është: “A mundet që autoritetet, në këtë rast, të kishin marrë masa më pak të rrepta?”
3. Kur ekziston një shkallë e gjerë ndryshimi në sjellje mes vendeve Evropiane në lidhje me një çështje të caktuar, për shembull, për rëndësinë e besimit fetar në shoqëri, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata) duhet të pranojë që autoritetet kombëtare të një shteti janë në një pozitë më të mirë për të vlerësuar peshën e çështjes. Kjo quhet t’i japësh shtetit “liri vlerësimi”. Megjithatë, Gjykata duhet të jetë e rreptë në garantimin që shteti po merr parasysh parimet e sakta gjatë vendimmarrjes lidhur me çështjen.

4. Kur dy të drejta/çështje duken në pamje të parë se po përplasen – për shembull, liria e shprehjes dhe liria e besimit fetar ose liria e shprehjes dhe liria e të tjerëve nga diskriminimi racor – duhet të arrihet një balancë mes tyre në varësi të fakteve të veçanta të çështjes.

Interpretimi i Neneve 9 dhe 10 KEDNJ

1. Pavarësisht se Nenet 9 dhe 10 në disa raste bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, duhet të kuptohet që ata janë gjithashtu të lidhur ngushtë; kur praktikon besimin fetar je duke shprehur bindjet e tua gjithashtu, kështu që liritë e mbrojtura nga Neni 9 janë gjithashtu të mbrojtura edhe nga Neni 10.
2. Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e besimit fetar përfshijnë lirinë për të ndjekur ose për ndryshuar një besim të caktuar fetar apo edhe për të mos besuar, si dhe lirinë për të manifestuar fenë ose besimin fetar në fjalë. Në këtë të fundit mund të ndërhyhet nga shteti. Liria e besimit fetar është një nga elementet më jetikë që formojnë identitetin e besimtarëve dhe perceptimin e tyre për jetën. Megjithatë, besimtarët duhet të tolerojnë dhe pranojnë mohimin e besimeve të popujve të tyre apo edhe pikëpamjet krejtësisht armiqësore ndaj besimit të tyre fetar.
3. Liria e shprehjes është thelbësore për funksionimin e duhur e një shoqërie liberale dhe demokratike. Neni 10 mbron lirinë e mendimit për të pasur opinione dhe për të marrë dhe ndarë ide dhe informacion. Kërkesat e një shoqërie demokratike nënkuptojnë se liria e shprehjes përfshin lirinë e shprehjes së ideve ose të komunikimit të informacionit që trondit, ofendon ose shqetëson shtetin ose çdo lloj grupi tjetër përfaqësues të popullatës.
4. Të gjithë ata që ushtrojnë të drejtat dhe liritë e tyre, të përfshira në Nenin 10, kanë “detyra dhe përgjegjësi” të ndryshme. Për shembull, një detyrë ose përgjegjësi e tyre mund të jetë detyrimi për të shmangur, për sa është e mundur, shprehje fyese ndaj të tjerëve, të cilat nuk kontribuojnë, në asnjë lloj mënyrë, në debatit publik. Në varësi të rrethanave, mund të konsiderohet e nevojshme të parandalohen ose sanksionohen shprehje të tilla, gjithmonë me kusht që masa e marrë të jetë në përpjesëtim me synimin legjitim.

Fleta e punës 4 –Hapat që ndjek Gjykata kur vendos për një shkelje të nenit 9 ose 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut



3.6. Tema 5 – Barazi për të gjithë

3.6.1. Hyrje në temë dhe në çështjet

- ▶ Gropi kundër Shqipërisë: a duhet të burgosen njerëzit për t'u ndëshkuar apo si ndëshkim?
- ▶ Galgen kundër Gjermanisë: a mund të lëndojmë dikë – ose të kërcënojmë për të lënduar dikë për të mbrojtur dikë tjetër?

Si i zgjidhim mosmarrëveshjet me miqtë ose me shokët e shkollës? Si duhet të ndëshkohem, nëse bëj diçka të gabuar?

► Grori kundër Shqipërisë

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/fra/pages/search.aspx?i=001-93410#{"itemid":\["001-93410"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/fra/pages/search.aspx?i=001-93410#{)

Pjesa A.Vendimi referues

Ankuesi(t)

Z. Grori, është një shtetas Shqiptar i lindur në vitin 1971, dhe aktualisht po vuan një dënim me burgim të përjetshëm dhe një tjetër, me 15 vjet heqje lirie, në burgun e sigurisë së lartë të Peqinit (Shqipëri).

Arsyetimi

Mungesa e trajtimit të duhur mjekësor të ankuesit, që ndodhet në burg, nga ana e autoriteteve të brendshme, përbën një trajtim çnjerëzor në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, kur të dënuarit janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe, në rrethana të caktuara, përbën arsye për lirim nga burgu për të shmangur vuajtjet e mëtejshme. Ekzekutimi i vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja, në mungesë të marrëveshjeve ndërkombëtare me këtë objekt, është i pavlefshëm.

Faktet

Autoritetet Italiane dënuan ankuesin në mungesë (*in absentia*) me burgim të përjetshëm për vrasje dhe me pesë vjet heqje lirie për armëmbajtje pa leje.

2001: Z. Grori u ndalua në Shqipëri mbi bazën e fletë-arrestit të lëshuar në Itali, lidhur me përfshirjen e tij në një organizatë kriminale dhe në trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Interpol Roma u dërgoi një faks autoriteteve shqiptare, duke u kërkuar fillimin e proceseve penale kundër ankuesit për krimet e kryera në territorin italian.

Korrik 2002: zyra e Prokurorit të Përgjithshëm filloi proceset penale në gjykatën e rrethit të Tiranës, duke e akuzuar ankuesin me trafikim të lëndëve narkotike.

Qershor 2006: gjykatat Shqiptare e shpallën atë fajtor dhe e dënuan me 15 vjet heqje lirie.

Autoritetet Italiane nuk mund të kërkonin ekzekutimin e dënimit nga institucionet Shqiptare pasi, në kohën e dhënies së vendimit, asnjë prej shteteve të përfshirë nuk kishte ratifikuar ndonjë marrëveshje ndërkombëtare në këtë fushë. Megjithatë, ndërsa ai mbahej në paraburgim në pritje të shqyrtimit të çështjes nga gjykata me akuzën e trafikut të drogës në Itali, gjykata dha masën e sigurisë me burg.

- Z. Grori a ankua përpara gjykatave Shqiptare me pretendimin se nuk kishte asnjë kërkesë nga pala Italiane për njohjen e vendimit të dhënë në mungesë (*in absentia*) kundër tij. Ai pretendonte, gjithashtu, se nuk kishte asnjë marrëveshje

ndërkombëtare të ratifikuar dhe në fuqi ndërmjet dy shteteve në kohën në fjalë, me qëllim vërtetimin e fuqisë ligjore të vendimit;

- ▶ Gjykatat vendore vendosën kundër tij, duke u shprehur se bashkëpunimi midis vendeve mund të ndodhte dhe të prodhonte pasoja në një fushë të caktuar edhe në mungesë të traktateve dy palësh, mbi bazën e vullnetit të mirë dhe normave dhe parimeve të përgjithshme të reciprocitetit, të njohura dhe pranuar gjerësisht.

2003 deri në 2004: Z. Grori, duke parë përkeqësimin e shëndetit të tij, ka kërkuar ekzaminim mjekësor. Ai u diagnostikua se vuante nga skleroza e shumëfishtë.

Beteja ligjore

Korrik 2004: Z. Grori paraqiti një kërkesë-padi në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

2005: Ankuesi u ankua për mungesë të trajtimit të duhur mjekësor në burg, që çon në keqtrajtim, dhe për trajtim të pjesshëm me barna mjekësore, pasi i ishin dhënë barna vetëm për reumatizëm.

2008: për shkak të situatës së rëndë shëndetësore të ankuesit, Gjykata vendosi se ai duhet të transferohet menjëherë në një spital civil. Transferimi u bë 17 ditë pas dhënies së këtij vendimi.

Mandat: dokumenti i lëshuar nga një zyrtar ligjor ose i institucioneve qeveritare ku autorizohet Policia e Shtetit ose një organ tjetër për të kryer një arrestim a veprime të tjera në funksion të administrimit të drejtësisë.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore për Gjykatën

Ankuesi kërkoi (ndër të tjera) të mbështetej në mbrojtjen që ofrojnë paragrafët e Nenit 3 si dhe Nenit 5 të Konventës.

Neni 3: Ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues

1. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese

Neni 5: E drejta për liri dhe siguri

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj

Ankuesi argumentoi se:

- ▶ ai nuk kishte marrë trajtimin e duhur mjekësor në kushtet e burgut, çka i kishte shkaktuar përkeqësimin e shëndetit të tij;
- ▶ ekzekutimi i dënimit të dhënë nga gjykatat Italiane ishte i pavlefshëm.

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

Në raste të jashtëzakonshme, kur një i burgosur është aq sëmurë sa që kushtet e tij fizike janë absolutisht të papajtueshme me paraburgimin, Neni 3 mund të kërkojë lirim e këtij personi me kushte të caktuara. Tre janë elementet të cilët duhet të merren në konsideratë në lidhje me pajtueshmërinë e shëndetit të ankuesit me qëndrimin e tij në paraburgim:

- ▶ gjendja mjekësore e të burgosurit;
- ▶ përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesit të dhënë gjatë paraburgimit;
- ▶ këshillimi i mbajtjes në paraburgim duke mbajtur parasysh gjendjen shëndetësore të ankuesit.

Gjykata theksoi se, Neni 3 nuk parashtrohet një detyrim të përgjithshëm për lirim e të ndaluarve për arsye shëndetësore. Megjithatë, ky nen i përcakton detyrime për shtetet në lidhje me mbrojtjen dhe garantimin e mirëqenies fizike të personave të ndaluar. Gjykata konstatoi se shpërfillja e autoriteteve Shqiptare për t'i siguruar Z. Grori trajtimin e duhur mjekësor, e kombinuar me vuajtjet fizike të ankuesit gjatë paraburgimit, faktikisht, arriti në trajtim çnjerëzor dhe në shkelje të Nenit 3.

Në lidhje me Nenin 5, duke qenë se e drejta ndërkombëtare, tek e cila mbështeten gjykatat e brendshme për të justifikuar ndalimin e ankuesit, nuk kishte fuqi ligjore në kohën e ndalimit të ankuesit, interpretimi i bazës ligjore ishte i gabuar dhe, për rrjedhojë, Neni 5, Paragrafi 1 ishte shkelur.

Parimet themelore

- ▶ kur një i burgosur është aq sëmurë sa që kushtet e tij fizike janë absolutisht të papajtueshme me paraburgimin, Neni 3 mund të kërkojë lirim e këtij personi me kushte të caktuara;
- ▶ shteti duhet të mbrojë mirëqenien fizike të personave të ndaluar;
- ▶ ndalimi dhe paraburgimi i një personi do të konsiderohet si arbitrar nëse nuk është në përputhje me procedurat e përshkruara nga ligji në fuqi në kohën e ndalimit të personit.

Çfarë ndodhi më tej?

Gjykata i dha Z. Grori shpërblim të drejtë për dëmet jo-pasurore, të shkaktuar nga mungesa e aksesit në trajtimin e duhur mjekësor përgjatë kohës së ndalimit të tij, si dhe për paligjshmërinë e paraburgimit të tij, nga viti 2002 deri në vitin 2003.

Kuadri ligjor i brendshëm është përditësuar: Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" u miratua në Prill të vitit 2014; Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve po rishikohet, ashtu siç po rishikohen edhe rregulloret e brendshme për secilin institucion, pjesë e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Stafet mjekësore në spitalet e burgjeve po i nënshtrohen trajnimeve periodike dhe afatgjata. Instrumentet e së drejtës ndërkombëtare, të cilët nuk ishin në fuqi në Shqipëri në kohën e shkeljes në fjalë, tanimë janë pjesë e së drejtës së brendshme.

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Në këtë veprimtari fokusi është neni 5, paragrafi 1 i Konventës

Koncepte/tema: liria, siguria dhe përpjesëtueshmëria

Objektivat e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të përshkruajë përmbajtjen e nenit 5 të Konventës;
- ▶ të shpjegojë konceptin e përpjesëtueshmërisë;
- ▶ të shpjegojë si zbatohet në praktikë koncepti i përpjesëtueshmërisë.

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë shkelje të nenit 5 të Konventës;
- ▶ të identifikojë dhe të komunikojë idetë dhe qëndrimet e të dy palëve në një gjyq;
- ▶ të zbatojë parimin e përpjesëtueshmërisë në praktikë

Qëndrimet

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të dëgjojë dhe të vlerësojë pikëpamjet e të tjerëve.

B.1. Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metoda-Veprimtaritë e mësuesit dhe Veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
15'	<p>1. Mësuesi shkruan nenin 5 në tabelë dhe fton nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Ç'është liria sipas nenit 5 të konventës? ▶ Në ç'kushte mund të kufizohet liria individuale? 	E gjithë klasa	
10'	<p>Klasa ndahet në grupe me nga 4 veta. Detyra e grupit është të shqyrtojë çështjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Cilat janë të drejtat që duhet t'u garantohen të burgosurve në stacionin e policisë? ▶ A keni qenë ndonjëherë në situata të ngjashme, ku do të dëshironit të respektoheshin disa të drejta? 	Punë në grup	
15	<p>Studim rasti</p> <p>Në grupe, nxënësit duhet të eksplorojnë faktet që lidhen me çështjen Gromi kundër Shqipërisë dhe të përgatitin përgjigjet e tyre, me shkrim, për pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ A është e ligjshme për një individ, që është dënuar nga gjykata e një vendi, të burgoset në një vend tjetër? ▶ A është e drejtë që një i burgosur të lirohet nëse është shkelur neni 5? ▶ Çfarë mendoni në lidhje me zbatimin e parimit të përpjesëtueshmërisë në procesin e marrjes së vendimit? ▶ Cilat janë të drejtët që nxënësit mund të përdorin për të mbrojtur veten nga dhuna e shtetit? 	Punë në grup	
5'	<p>Mësuesi u paraqet vendimin nxënësve dhe diskuton me ta për rëndësinë e njohjes së Konventës dhe të vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut për të sjellë ndryshime pozitive në vend.</p>	E gjithë klasa	

► Gäfgen k. Gjermanisë

Për mësuesit rekomandohet që, përveç përmbledhjeve të shkurtuara, dhe atje ku është e mundur, të lexojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje në adresën:

[http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-99015#{“itemid”:\[“001-99015”\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-99015#{“itemid”:[“001-99015”]})

Pjesa A. Vendimi referues

Ankuesi(t)

Ankuesi është Z. Gäfgen, një student Gjerman i së drejtës, i lindur në 11 Prill 1975 në Frankfurt.

Arsyetimi

Neni 3 i Konventës përcakton ndalim kategorik të torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës. Kjo do të thotë që, shteti nuk mundet kurrsesi të justifikojë një trajtim të tillë, pavarësisht nga rrethanat e çështjes. Kështu mbrohet dinjiteti njerëzor. Nëpërmjet këtij vendimi pilot, gjykata konstatoi se marrja me dhunë (zhvatja) e deklaratave nga të dyshuarit është e ndaluar dhe se Neni 3 nuk ka përjashtime. Ajo, gjithashtu, konfirmoi se qoftë edhe vetëm kërcënimi për torturë përbën trajtim çnjerëzor e për pasojë shkelje të Nenit 3. Kjo çështje thekson limitet e vendosura ndaj autoriteteve, edhe në rastet kur mund të mendohet se është legjitime që të sakrifikosh të drejtat e dikujt në mënyrë që të mbrohen të drejtat e të tjerëve (shembulli klasik i të torturuarit të dikujt, me qëllim gjetjen e vend ndodhjes së “minës me sahat”). Kjo ruan qartësisht kufijtë e përcaktuar të Nenit 3 dhe shmang rreziqet e abuzimit me pushtetin, edhe në emër të ndjekjes së objektivave legjitimë.

Zhvatja: marrja me dhunë e informacionit nëpërmjet forcës apo kërcënimeve

Faktet

27 Shtator 2002: Z. Gäfgen rrëmbeu një djalë të ri, J. (vëllai 11-vjeçar i shokut të tij dhe djali më i vogël i një familjeje të njohur bankierësh në Frankfurt), e mbyti atë në apartamentin e tij dhe i dërgoi prindërve të djalit një letër të shkruar me shkrim dore, ku kërkonte një shpërblim prej €1 000 000 dhe rrugëkalim të sigurt për largim nga jashtë vendit. Ai e fshehu trupin e fëmijës nën një mol, në një liqen të vogël rreth një orë larg me makinë nga Frankfurti.

30 Shtator: prindërit e fëmijës i paguan shumën e kërkuar Z. Gäfgen në një stacion tramvaji në Frankfurt. Pas marrjes së shpërblësës policia e vuri nën vëzhgim dhe e arrestoi në po të njëjtën ditë, duke e dërguar në stacionin më të afërt të policisë. Më pas, atij iu njoftuan ligjërisht (në mënyrë korrekte) të drejtat e tij. Pas një konsultimi rreth 30-minutash me avokatin e tij, ai lëshoi një deklaratë ku pretendonte se fëmija po mbahej nga dy pengmarrës në një kasolle pranë liqenit.

1 Tetor: një oficer policie kërcënoi Z. Gäfgen për rreth 10 minuta, duke i thënë se oficerë të mirëtrajnuar për në fushën e hetimit do t'i shkaktonin atij dhimbje të jashtëzakonshme (por pa i lënë shenja fizike), nëse ai nuk tregonte vendndodhjen e fëmijës. Atij iu tha gjithashtu se do të burgosej në një qeli me dy "zezakë të gjatë", të cilët do të abuzonin seksualisht me të. Thuhet madje se një oficer e kishte goditur në gjoks, ia kishte përplasur kokën në mur dhe e kishte shtyrë fort andej këndeje. Kjo e bëri Z. Gäfgen që të tregonte vend ndodhjen e djalit, vend ku ai drejtoi edhe policinë. Ankuesi pranoi se kishte rrëmbyer dhe kishte vrarë vetë fëmijën. Autopsia e djalit konfirmoi që ai kishte vdekur nga asfiksia.

Beteja ligjore

15 Qershor 2005: Z. Gäfgen parashtrroi një kërkesë-padi, duke pretenduar shkelje të Neneve 3 dhe 6 të Konventës.

Baza ligjore dhe pyetjet kryesore drejtuar Gjykatës

Neni 3: Ndalimi i torturës dhe trajtimin çnjerëzor dhe degradues

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

A korrespondon sjellja e oficerëve të policisë me sjelljet që ndalohen nga Neni 3? A është kjo sjellje aq e rëndë, sa të përbëjë shkelje (që do të thotë: a përmbush një nivel minimal ashpërsie)? A është e drejta e parashikuar nga Neni 3 një e drejtë absolute dhe, konkretisht, a është e mundur që të ndërhyhet në këtë të drejtë në rrethana të jashtëzakonshme ku, për shembull, shteti beson se një ndërhyrje e tillë është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve?

Neni 6: E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme... ..
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: ...
 - a) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

A ishte procesi në tërësi i paanshëm, çka do të thotë, në përputhje me Nenin 6, pavarësisht nga fakti se gjatë procesit ishin siguruar prova materiale në shkelje të Nenit 3 të Konventës? A është dhunuar e drejta e ankuesit për mbrojtje efektive e parashikuar në Nenin 6 paragrafi 3?

Përgjigjja e gjykatës dhe parimet themelore

Të tre sjelljet e ndaluara nga Neni 3 mund të dallohen si vijon:

- ▶ tortura përfaqëson formën më të rëndë të sjelljeve të ndaluara nëpërmjet të cilave shkaktohet vuajtja, qoftë ajo fizike apo psikologjike;

- ▶ trajtimi çnjerëzor shkaktohet nga vuajtjet intensive, çka konsiderohet disi më e butë se tortura;
- ▶ trajtimi degradues përfshin elementin e poshtëritimit, duke shkaktuar ndjesinë e inferioritetit dhe zhvlerësimin e dinjitetit.

Çdo sjellje, që plotëson një nga përshkrimet e mësipërme, duhet të jetë e shoqëruar nga “një nivel minimal ashpërsie”, që të përbëjë shkelje të nenit 3. Gjykata e zbaton këtë standard rast pas rasti, duke marrë parasysh: natyrën dhe kontekstin e trajtimit; mënyrën dhe metodën e zbatimit; zgjatjen në kohë; pasojat fizike dhe mendore të viktimës; dhe, në disa raste, seksin, moshën dhe gjendjen shëndetësore të viktimës.

Gjykata u shpreh se, në sytë e ankuesit, kërcënimi ishte i drejtpërdrejtë dhe realist dhe kishte shkaktuar tek ai një ndjenjë të fortë frike (ai do të vuante dhimbje të padurueshme nëse nuk do të pohonte) dhe vuajtje mendore. Policia po vepronte për të marrë një deklaratë nga ankuesi dhe kërcënimet për këtë qëllim zgjatën për rreth 10 minuta. Gjykata pasi i mori parasysh këto fakte arriti në përfundimin se trajtimi i ankuesit nga autoritetet policore përbente trajtim çnjerëzor dhe një shkelje të Nenit 3. Gjykata theksoi natyrën absolute të kësaj të drejte edhe në rrethana të rrezikshme për jetën, pavarësisht nga sjellja e ankuesit.

Gjykata u shpreh se, meqë nuk ishin provat e marra në shkelje të Nenit 3 që kishin çuar në dënimin e ankuesit, por dëshmia e dytë e ankuesit në gjykatë, e drejta e ankuesit për mbrojtje në sallën e gjyqit ishte garantuar dhe se procesi, në tërësi, ishte i drejtë. Nuk kishte shkelje të Nenit 6.

Parimet themelore

- ▶ Gjykata konstatoi konkurrim midis të nevojës për mbrojtur jetën e njeriut nëpërmjet lejimit të efektivitetit të ndjekjes penale të një krimi, nga njëra anë, dhe ndalimit të trajtimit çnjerëzor dhe të drejtës së integritetit mendor dhe fizik, nga ana tjetër.
- ▶ Neni 3 është absolut, pavarësisht nga vepra penale në fjalë ose nga rrethanat e tjera, dhe kjo bëhet me qëllim që të shmanget abuzimi i pushtetit shtetëror;
- ▶ Meqë, nuk mund të bëhen kërcënime për të marrë informacion dhe, nëse ndodhin ato shkelin Konventën, një rrëfim i dytë i mëvonshëm – duke e gjykuar procedurën “si të tërë” – mund të jetë i pranueshëm, si bazë për dënimin e një personi.

Çfarë ndodhi me tej?

Shteti Gjerman u urdhërua që t’i paguante ankuesit € 1723.40 brenda tre muaj

Pjesa B. Veprimtari mësimore

Koncepte/tema: Ndalimi absolut i torturës; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe mbrojtja e saj në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Objektivat e të mësuarit

Objektivi kryesor i kësaj veprimtarie është të njohë nxënësit me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe mbrojtjen e saj në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo veprimtari e paraqet Konventën përmes ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

Njohuritë dhe të kuptuarit

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të interpretojë përmbajtjen e nenit 3 të Konventës;
- ▶ të shpjegojë natyrën absolute të ndalimit sipas nenit 3.

Aftësitë

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të identifikojë shkelje të nenit 3 të Konventës;
- ▶ të identifikojë trajtime që janë të papajtueshme me nenin 3.

Qëndrime

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- ▶ të shqyrtojë çështjen në dritën e të gjitha palëve të përfshira;
- ▶ të dëgjojë dhe të vlerësojë pikëpamjet e të tjerëve.

Kohëzgjatja: 45 minuta

B.1 Planifikimi

Koha	Përmbajtja Metodat-veprimtaritë e mësuesit-veprimtaritë e nxënësit	Lloji i veprimtarisë	Materiale
5'	1. Hyrje Mësuesi paraqet temën dhe metodën e punës.	E gjithë klasa	
10'	2. Prezantimi i çështjes dhe nenit 3 të Konventës. Mësuesi njeh nxënësit me faktet e çështjes, argumentet dhe vendimin e gjykatës.		
20'	3. Lojë me role – Ndalimi i torturës Mësuesi shpërndan materialet mësimore (gjysma e nxënësve merr tregimin A, ndërsa gjysma tjetër merr tregimin B) dhe u jep udhëzimet nxënësve: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Kur lexojnë tregimet, nxënësit nuk duhet të mendojnë për vërtetësinë ose rezultatet e tyre, por si ata do të vepronin në të njëjtën situatë ose si do të dëshironin të trajtoheshin; ▶ Nxënësit mbajnë shënime sipas dëshirës. Mësuesi u shpjegon nxënësve se tregimet bëjnë fjalë për një person i cili dyshohet për rrëmbim. Të dy grupet duhet të luajnë role të ndryshme: Në tregimin a, nxënësit duhet të identifikohen me rolin e prindërve të fëmijës së rrëmbyer; në tregimin B, nxënësit duhet të identifikohen me rolin e shokut të personit që dyshohet për rrëmbimin.	Punë në grup	Udhëzimet 1 dhe 2
10'	4. Diskutim i përgjithshëm Mësuesi nxit nxënësit të diskutojnë për vendimin dhe arsyetimin e Gjykatës, duke shprehur, në këtë mënyrë, mendimin e tyre.	E gjithë klasa	

B.2. Materiale

Nxënësit nxiten të lexojnë materialet paraprakisht për t'u njohur me çështjet kryesore të trajtuara në vendim. Në të njëjtën kohë, mësuesi përgatit pyetjet për detyrat e shtëpisë së nxënësve.

Udhëzimi 1: Lista e pyetjeve të mundshme

Pyetje të mundshme për një diskutim me nxënësit

- ▶ A është e pranueshme që policia të kërcënojë të dyshuarin (pse "PO" dhe pse "JO")?
- ▶ A do të pranohej një gjë e tillë në rrethana të tjera (kur "PO" dhe kur "JO"), apo këto kërcënime do të ishin të pranueshme në rastet kur do të shërbenin për të shpëtuar jetën e një personi tjetër? Po jetën e 1000 personave?
- ▶ A do të pranoheshin kërcënimet e policisë në rastin kur kjo është e sigurtë që personi i dyshuar është i duhuri?
- ▶ A duhet gjykata të marrë në shqyrtim provat e marra në këtë mënyrë, duke e ditur paraprakisht këtë gjë (pse "PO", pse "JO")?
- ▶ Cilat janë vlerat që mbrojmë nëse ne lejojmë kërcënime të tilla dhe cilat ndalojmë?
- ▶ A e justifikon qëllimi gjithmonë mjetin? A ekzistojnë objektiva ose vlera absolute, të cilat nuk mund të justifikohen kurrë?

Udhëzimi 2: Tregimi a dhe B

Tregimi A

Shoku juaj është një sipërmarrës shumë i suksesshëm. Ai është babai i dy fëmijëve: i një djali 11 vjeçar dhe i një vajze pak më të madhe. Një ditë, djali i tij nuk kthehet nga shkolla dhe merr njoftimin se është rrëmbyer nga katër të huaj që kërkojnë një shpërblim të madh për ta liruar. Ai njofton policinë dhe së bashku bëjnë planin për të dorëzuar shpërblimin, ndërkohë që policia fillon përpjekjet për t'i kapur ose të paktën për t'i identifikuar dhe për të shpëtuar fëmijën. Megjithëse shpërblimi i dorëzua, fëmija nuk u pa në vendin e premtuar dhe policia arrestoi një të dyshuar, i cili nuk e pranonte të kishte rrëmbyer fëmijën. Pas disa orë pyetjesh, policët (të trajnuar në vlerësime psikologjike) u bindën se i dyshuari e dinte ku ishte fëmija. Megjithatë, ata nuk mundën t'i merrnin atij ndonjë informacion. Për këtë arsye, ata iu drejtuan taktikës së vetme të mbetur: ata e kërcënuan atë me tortura të tilla të rënda, por pa shenja, në mënyrë që ai të mos ankohej dot për dhunën e ushtruar. Ata e kërcënuan se do të ushtronin dhunë fizike edhe te anëtarët e familjes. Nën presion (të cilin policia nuk kishte ndërmend ta vinte në praktikë), i dyshuari pohon pjesëmarrjen e tij në rrëmbimin e fëmijës dhe i drejton policët në skenën e krimit.

Tregimi B

Ju jeni i ulur në një makinë të parkuar përpara një qendre tregtare me një shok, student i qetë drejtësie. Shoku të thotë se po pret të dashurën. Pas pak, kalon një limuzinë me katër zotërinj, tre nga të cilët me kufje në vesh, të ulur në të. Meqë jeni me nxitim, ju shkoni në shtëpi. Në mbrëmje, shoku ju telefonon dhe ju kërkon të vini në stacionin e policisë si mbrojtës i tij. Ai është ndaluar i dyshuar për pjesëmarrje në një rrëmbim. Shoku pretendon se nuk di asgjë për rastin në fjalë. Ndërkohë ju identifikoni ndërmjet hetuesve në rajonin e policisë, njërin prej personave të ulur në limuzinën përpara qendrës tregtare. Shoku juaj merret në pyetje gjatë gjithë natës. Sa herë që ai del nga dhoma e pyetjeve, duket i lodhur, nervoz dhe i dëshpëruar. Më vonë, ai do t'ju thotë ju se ka qenë gjatë gjithë kohës i kërcënuar dhe në frikë për jetën dhe shëndetin. Ai pretendon se meqë nuk mund të duronte më presionin, ai i rrëfen policisë atë çfarë policia dëshironte të dëgjonte prej tij – që ai kishte rrëmbyer një fëmijë dhe i kishte kërkuar familjes një shumë të madhe parash.

4. Tabela e veprimtarive të tjera

Ju mund të gjeni veprimtari të tjera në uebsait-in e projektit: <http://explorehumanrights.coe.int>. Tabela e mëposhtme paraqet pikat kryesore të interesit për qëllime pedagogjike.

Tema 1: Është jeta ime

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar</i> (app. nr.23452/94)	Neni 2	Kjo çështje është zgjedhur për faktin se demonstroi kur dhe si shteti mund të ndërmarrë veprime në mbrojtje të jetës së qytetarëve.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, histori.
<i>Iglesias Gil dhe A.U.I kundër Spanjës</i> (app. nr.56673/00)	Neni 8	Kjo çështje trajton rrëmbimin e fëmijëve dhe detyrimin pozitiv të shtetit për të kthyer fëmijën e rrëmbyer në mënyrë të paligjshme prej njërit nga prindërit.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, gjeografi.
<i>Nulinger dhe Shurk kundër Zvicrës</i> (app.nr. 41615/07)	Neni 8	Kjo është një tjetër çështje e rrëmbimit të paligjshëm të fëmijës, por në këtë rast ka të bëjë me faktin nëse është gjithmonë në interes të fëmijës që fëmija të kthehet.	Edukim moral, edukim fetar, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, histori.
<i>Kristine Guduin kundër Mbretërisë së Bashkuar</i> (app.nr. 28957/95)	Neni 8 dhe 12	Çështja hedh vështrimin në njohjen ligjrisht të transeksualëve (të lejohen ata të kenë një identitet të ri të regjistruar në pasaportën e tyre, Kartë identiteti etj.)	Edukim moral, edukim fetar, studime bashkëkohore, studime sociale, politike, histori.
<i>X dhe të tjerët kundër Austrisë</i> App. nr.19010/07	Neni 8 dhe 14	Kjo çështje trajton barazinë e trajtimit për çiftet e të njëjtit sex në lidhje me birësimin.	Edukim moral, edukim fetar, studime bashkëkohore, studime sociale, politike, histori.

Tema 2 – Mos ma bëj një gjë të tillë

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë</i> App.nr. 25965/04	Neni 2, 3, 4 dhe 5	Kjo është një çështje që diskuton problemet që shkaktohen nga format moderne të skllavërisë, për shembull, trafikimi njerëzor.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, histori, art.
<i>Kalashnikov kundër Ruisë</i> App.nr. 47095/	Neni 3	Kjo çështje tërheq vëmendjen në dobësinë e veçantë të të burgosurve që keqtrajtohen në burg.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, politik, histori.
<i>Selmoni kundër Francës</i> App. nr.25803/94	Neni 3 dhe 6	Gjykata e parë Evropiane e të Drejtave të Njeriut që deklaroi që dikush është trajtuar aq keq nga policia sa mund të quhet "torturë".	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, politik, histori.
<i>MC kundër Bullgarisë</i> App. nr.39272/98	Neni 3 dhe 8	Kjo çështje trajton klasifikimin e Gjykatës për përdhunimin.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, politike, histori.

Tema 3: Si i trajtojmë të tjerët?

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Mubilanzila Majeka dhe Kaniki Mitunga kundër Belgjikës</i> (app.nr. 13178/03)	Neni 3, 5 dhe 8	Kjo çështje merret me mënyrën si shteti duhet të trajtojë edhe ata që migrojnë në mënyrë të paligjshme në vendin e tyre, veçanërisht nëse janë fëmijë.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, studime politike, histori, gjeografi.
<i>Sheshiç kundër Kroacisë</i> (app. nr.40116/02)	Neni 3 dhe 14	Kjo çështje merret me përgjigjen e shtetit ndaj sulmeve me motive raciste (kundër qytetarëve Rom)	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, studime politike, histori, gjeografi.

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Lautsi dhe të tjerët kundër Italisë</i> (app. nr.30814/06)	Neni 9 dhe neni 1 i Prot. 1	Kjo çështje shqyrton nëse pasja e një simboli fetar të shfaqur haptazi në shkollë (për shembull, një kryq) mund të interpretohet të jetë kundër pikëpamjeve fetare të fëmijëve dhe prindërve që i përkasin një feje tjetër	Edukim fetar, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, politik, histori.

Tema 4: Unë dua një zë!

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Instituti Otto Preminger kundër Austrisë</i> (app. nr.13470/87)	Neni 10	Kjo çështje shqyrton temën e vështirë të konfliktit të të drejtës së lirisë së shprehjes me pikëpamjet fetare të të tjerëve.	Edukim fetar, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, studime politike, histori, media.
<i>Vogt kundër Gjermanisë</i>	Neni 10 dhe 11	Kjo çështje merret me mësuesit të cilët duhet të ofrojnë këndvështrim neutral dhe objektiv, ndërkohë që mund të jenë anëtar të një partie politike.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, studime politike, histori, gjeografi.

Tema 5: Barazi për të gjithë

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Soring kundër Mbretërisë së Bashkuar</i> (app.nr. 14038/88)	Neni 3	Kjo çështje trajton dënimin me vdekje dhe nëse është e pranueshme të dërgohet dikush nga Evropa në një shtet që përdor dënimin me vdekje dhe që ka të ngjarë ta çojë atë në radhën e vdekjes.	Histori, gjeografi, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, etik, studime politike.
<i>Uitold Litua kundër Polonisë.</i> (aap. nr.26629/95)	Neni 5	Kjo çështje trajton rrethanat ku përlligjet ndalimi dhe mbajtja e një individi në gjendje arresti.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike.

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Dorson kundër Hollandës</i> (app.nr. 20524/92)	Neni 6	Ky nen trajton rëndësinë e aftësisë së dy palëve (të individit dhe të shtetit) për të shqyrtuar dëshmitë në një gjyq penal.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike.
<i>Salduz kundër Turqisë</i> (app.nr. 36391)	Neni 6	Çështja trajton përfaqësimin ligjor për personat e ndaluar në polici.	Edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike.
<i>Orsus dhe të tjerët kundër Kroacisë</i> (app. nr.15766/03)	Neni 6, 14 dhe Neni 2 i Prot. Nr. 1	Kjo çështje shikon në tërësi problemet që mund të lindin në një sallë gjyqi dhe që pengojnë zhvillimin e drejtë e të paanshëm të gjykimit.	Etikë, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike, studime fetare, gjuhësore, histori.
<i>Burdov mundër Rusisë</i> (app. nr.59498/00 dhe 33509/04)	Neni 6 dhe neni 1 i Prot. Nr.1	Kjo çështje lidhet me gjykimin e paanshëm dhe nëse pagesat për kompensime të urdhëruara nga një gjykatë mund të quhen "pronë"	Etikë, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike, ekonomi.
<i>Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë</i> (app. nr.34044/96. 35532/97 dhe 44801/98)	Neni 7	Kjo çështje shqyrton mundësinë e shtetit për të proceduar dikë për një vepër të kryer në kohën kur kjo nuk përbënte vepër penale sipas ligjit të vendit.	Etikë, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike, gjeografi, histori.
<i>Skopola kundër Italisë</i> (Nr. 2) (app.nr. 10249/03)	Neni 6 dhe 7	Kjo çështje ka të bëjë me përpjekjen për të bindur dikë për një veprim të kryer, i cili nuk ishte krim në kohën e kryerjes dhe njëkohësisht me të drejtën e burgosurit për të votuar.	Etikë, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike, qytetari, ekonomi.
<i>Lebedev kundër Rusisë</i> (app. nr.4493/04)	Neni 5	Kjo çështje trajton bazën ligjore që kërkohet në rastin kur shteti ndalon dhe mban të ndaluar një individ, për të siguruar që një personi të mos i shkelet liria në mënyrë të panevojshme.	Etikë, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike, qytetari, ekonomi.

Emri i çështjes	Neni i Konventës	Qëllimi	Lidhja me lëndët ose fushat lëndore
<i>Slih kundër slovenisë</i>	Neni 2	Çështja trajton detyrimin e shtetit për të hetuar vdekjet dhe për të siguruar që drejtësia të bëhet, por kjo gjë të jetë e dukshme.	Etikë, edukim moral, studime bashkëkohore, studime sociale, studime politike, histori, shkencë.

5. Variant i thjeshtuar i neneve të përzgjedhur nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe e Protokolleve të saj¹



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

5.1 Përmbledhje e hyrjes

Qeveritë anëtare të Këshillit të Evropës punojnë së bashku dhe të bashkuar në bazë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Me anë të kësaj Konvente, ata vendosin për të ndërmarrë hapat e para për të zbatuar shumë të drejta të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

5.2 Nene të përzgjedhur

Neni 1 - Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut

Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente.

Neni 2 – E drejta e jetës

Tike të drejtën për të jetuar

1. Ky dokument është përgatitur nga Drejtoria e Komunikimit. Ju lutemi, vini re se, ky variant i thjeshtuar shërben vetëm për qëllime edukative dhe frymëzohet nga versioni i thjeshtuar i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, përgatitur nga Amnesty International the të tjerë. Të vetmit tekste që kanë fuqi ligjore janë ato që gjënden në botimet zyrtare të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe të Protokolleve të saj.

Neni 3 – Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 4 – Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

Askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.

Neni 5 – E drejta për liri dhe siguri

Ti ke të drejtën e lirisë.

Nëse arrestoheni keni të drejtë të dini arsyen e arrestimit tuaj.

Nëse arrestoheni keni të drejtën për gjykuar brenda afatit ligjor ose të jeni ilirë deri në ditën e gjyqit.

Neni 6 – E drejta për gjykim të drejtë

Ti ke të drejtën për një gjyq të drejtë dhe të paanshëm dhe për një gjyqtar të pavarur. Nëse akuzoheni për një krim, ju jeni i pafajshëm deri në ditën kur provohet fajësia juaj. Nëse jeni i varfër, ju keni të drejtën e ndihmës nga një avokat të paguar nga shteti.

Neni 7 – Jo dënim pa ligj

Ju nuk mund të quheni fajtor për një krim që nuk ka qenë parashikuar si i tillë në ligj, në kohën e kryerjes së tij.

Neni 8 – E drejta për të respektuar jetën private dhe familjare

Ju keni të drejtën e respektit për jetën tuaj private dhe familjare, të banesës dhe të korrespondencës.

Neni 9 – Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e besimit

Ju keni të drejtën për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Ju keni të drejtën rëq ushtroni fenë tuaj në shtëpi dhe në publik dhe të ndryshoni fenë nëse dëshironi.

Neni 10 – Liria e shprehjes

Ju keni të drejtën për thënë dhe për të shkruar në mënyrë të përgjegjshme mendimin tuaj dhe për të marrë dhe për të dhënë informacion nga të tjerët.

Neni 11 – Liria e tubimit dhe organizimit

Ju keni të drejtën për të marrë pjesë në tubime paqësore dhe të krijosh dhe të marrësh pjesë në shoqata – duke përfshirë këtu edhe bashkimet profesionale.

Neni 12 – E drejta për t'u martuar

Ju keni të drejtën për t'u martuar dhe për të krijuar familje

Neni 13 – E drejta për zgjidhje efektive

Në rast se të drejtat tuaja janë shkelur, ju mund të ankoheni zyrtarisht në gjykatë ose në institucione të tjera publike.

Neni 14 – Ndalimi i diskriminimit

Ju i keni këto të drejta, pavarësisht nga ngjyra e lëkurës, seksi, gjuha, bindjet politike ose fetare ose nga origjina.

Neni 15 - Cenimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme

Në kohë lufte ose të emergjencave të tjera publike, qeveria mund të marrë masa që janë kundër të drejtave tuaja, por vetëm në kushte shumë të nevojshme. Edhe në këto raste, qeveritë nuk lejohen, për shembull, t'ju torturojnë ose t'ju vrasin.

Neni 16- Kufizime të veprimtarisë politike të të huajve

Qeveritë mund të kufizojnë veprimtarinë politike të të huajve, edhe nëse kjo bien në konflikt me nenet 10, 11 ose 14.

Neni 17 – Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të përdoret për të dëmtuar të drejtat dhe liritë e saj.

Neni 18 – Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave

Pjesa më e madhe e të drejtave në këtë Konventë mund të kufizohet nga një ligj i përgjithshëm që zbatohet për të gjithë.

Këto kufizime mund të zbatohen vetën nëse janë të domosdoshme.

Neni 19 – 51

Këto nene shpjegojnë si funksionon Gjykata Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Neni 34 – Kërkesat individuale

Nëse të drejtat tuaja sipas kësaj Konvente shkelen në një ndër shtetet anëtare, ju duhet të ankoheni së pari në autoritetet kompetente kombëtare. Nëse kjo nuk funksionon, atëherë ju mund t'i drejtoheni Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Neni 52 – Hetimet e Sekretarit të Përgjithshëm

Me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, qeveritë duhet të shpjegojnë se si legjislacioni kombëtar mbron të drejtat e kësaj Konvente.

5.3. Protokollat e Konventës

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 – Mbrojtja e pronës

Ju keni të drejtë për të zotëruar pronë dhe për ta përdorur atë.

Neni 2 i Protokollit Nr. 1 – E drejta për arsimim

Ju keni të drejtë për të shkuar në shkollë.

Neni 3 i Protokollit Nr. 1 – E drejta për zgjedhje të lira

Ju keni të drejtë për të zgjedhur qeverinë e vendit tuaj me votë të fshehtë.

Neni 2 i Protokollit Nr. 4 - Liria e lëvizjes

Nëse jeni në një vend në mënyrë të ligjshme, ju keni të drejtën të shkoni dhe të jetoni ku dëshironi brenda tij.

Neni 1 i Protokollit Nr. 6 - Heqja e dënimit me vdekje

Ju nuk mund të dënoheni me vdekje ose të ekzekutoheni nga shteti.

Neni 2 i Protokollit Nr. 7 –E drejta e apelit për çështje penale

Nëse jeni dënuar për një krim, ju keni të drejtë të apelonit në një gjykatë më të lartë.

Neni 3 i Protokollit Nr. 7 – Kompensimi për dënim të padrejtë

Ju keni të drejtën për t'u kompensuar në rastet kur dënimi i dhënë për ju rezultoi i padrejtë dhe ju shpalleni i pafajshëm nga gjykata.

Neni 1 i Protokollit Nr. 12 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

Ju nuk mund të diskriminoheni nga autoritetet publike për arsye, për shembull, të ngjyrës së lëkurës, seksit, gjuhës, bindjes politike ose fetare ose origjinës.

6. Burime nga Uebisai dhe nga baza e të dhënave

Faqja e projektit – “Eksploro dhe vepra për të drejtat e njeriut” mund të shfrytëzohet në adresën: <http://explorehumanrights.coe.int>

Këtu ju mund të gjeni:

- ▶ informacion për projektin, Këshillin e Evropës, Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, disa tekste ligjore dhe materiale të tjera;
- ▶ burime në gjuhë të ndryshme (video klipe, postera, materiale mësimore etj.) që mund të zgjidhen për qëllime të ndryshme.

Baza e të dhënave mund të shfrytëzohet në adresën:

<http://coe-repository.org>

Këtu mund të gjeni qindra materiale pedagogjike në anglisht dhe frëngjisht. Portali ofron disa instrumente për të kërkuar për burime të tjera në përputhje me nevojat tuaja.

6.1 Baza e të dhënave dhe qëllimet e saj

Për të plotësuar manualin dhe 12 veprimtaritë e saj kryesore (dhe 20 veprimtari të tjera shtesë), mbi të cilin është ndërtuar kapitulli 1 i kësaj metodologjie, ekipi vendosi t’i vërë në shërbim të mësuesve dhe të nxënësve të shkollës së mesme, dhe si pjesë e burimeve edukative të zhvilluara nga Këshilli i Evropës për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë demokratike. Për këtë qëllim, grupi i punës vendosi të krijonte këtë bazë burimore të veprimtarive edukative online përmes një portali dhe rrugëve për shfrytëzimin e tij.

Përveç kësaj, këtu gjenden edhe pjesë nga botime të tjera (si broshura), të cilat mund të përdoren të veçanta nga një mësues, pa qenë e nevojshme të shkarkohet i gjithë libri në të cilin pjesa ndodhet. Në këtë mënyrë rritet efikasiteti i përdorimit të një burimi arsimor.


Librat, shpesh herë janë të gjatë dhe përfshijnë një numër të madhe temash, kështu që përfitimi i mundësisë së shfrytëzimit të pjesëve të tij për mësuesin qëndron në faktin që ky i fundit ka mundësi të kërkojë dhe të gjejë, në pak kohë, vetëm ato që i nevojiten për qëllimin e tij.

Baza e të dhënave përmban edhe tekste referencë, të tilla si konventat dhe kartat.

6.2 Disa mënyra kërkimi

Portali dhe programi i tij ofrojnë disa rrugë kërkimi nëpër burimet. Për këtë arsye, për t'i zbuluar ato, fillimisht duhet të shkoni në faqen kryesore:

<http://coe-repository.org/page/>



experimental version
Explore & Act for Human Rights
Pedagogical resources

Select Language


Search...

Advanced Search
Allows you to search for resources by crossing Resource Languages, Resource Types, End User Roles and Educational Levels.
[Start searching](#)


Browse
Browse through all the educational resources, distributed between Resource Languages, Educational Levels and Resource Types.
[Start browsing](#)

Navigational Search
Allows you to search for resources moving through a semantic tree of Human Rights concepts.
[Start searching](#)

- ▶ Kërkim i drejtpërdrejt: ju mund të shënoni fjalën në kutinë e kërkimit



- ▶ Kërkim i avancuar: ju mund të kërkoni burimet duke kombinuar gjuhën, burimin dhe nivelin e arsimit;



experimental version
Explore & Act for Human Rights
Pedagogical resources

Select Language

Search...

Home [Advanced Search](#) [Browse](#) [Navigational Search](#)

Advanced Search

Please, use the upper search for a simple search, or the search form from the aside for an advanced search

Search

All words Exact phrase

Title Keywords Description

Filter by language:

Filter by type of resource:

Filter by intended end user role:

Filter by educational level:

- ▶ Eksploroni: kjo do t'ju lejojë të shikoni të gjitha burimet, të shpërndara në bazë të gjuhës, nivelit të mësidhënies dhe tipit të burimit.

By Language

- English 850
- French 269

By Educational Level

- Pre-primary Education 6
- Primary Education 336
- Secondary education 400
- Post-secondary education 114

By Resource Type

- Assessment 1
- Case Study 99
- Course 23
- Demonstration 5
- Exercise 167
- Game & role play 0
- Enquiry-oriented activity (student research) or Experiment 0
- Exploration or Simulation 1
- Information or Sensitization 42
- Glossary or Definition 4
- Guide 125
- Learning asset (data/fact/example) 0
- Legal Text 36
- Lesson plan 323
- Project 1
- Study or Analysis 1
- Tool 23

Search results

1 2 3 4 ... 85 ... Next

60 years of the European Convention on Human Rights

A short video intended for the general public. It shows images inside and outside the ECHR, especially recent images.

Keywords: ECHR, history

Learning Resource Type: video/wmv
Format: video/wmv
[View extended info](#)

ECHR video on admissibility conditions

A short video intended for the general public. Similar to an ad. With very contemporary and lively visual presentation, it describes the conditions to for an application to be admissible at the...

[more](#)

Keywords: ECHR, admissibility, ECHR, application, conditions

Learning Resource Type: animation
Format: video/wmv
[View extended info](#)

Educating for democracy - Assessment of students, teachers and schools


Chapter for teacher training - 26 pages - Includes 18 work files - Presents different forms of evaluation in a non-judgemental manner. It advises teachers on perspectives, forms and standard of...

[more](#)

Keywords: journal, logbook, portfolio, evaluation, formative, summative, achievement, processes,

Learning Resource Type: narrative text
Format: application/pdf

- ▶ Kërkimi në rrjet: shikoni për burime duke hapur një pemë konceptesh që lidhen me të drejtat e njeriut. Duke klikuar në një “nyje” – një koncept – do të hapen degët dhe pemët që lidhen me të, ndërkohë që poshtë pemës do të gjeni një listë të burimeve që lidhen me konceptin.



Exploring children's right - We are wizards

Student project plan to be done in 4 lessons (sittings). Written for elementary school teachers – 5 pages long
The teacher learns how to show children to find original and creative solutions to real-life problems by imagining themselves as wizards.

6.3. Çfarë do të gjeni

Në të gjitha rastet do të gjeni një listë të burimeve, që do të shfaqen në ekranin tuaj, si më poshtë. Në këtë shembull, kërkimi është për konceptin “dënim me vdekje” dhe baza e të dhënave gjeti 8 burime.

Search results 8 results found.

Death is not justice

The brochure addressed to the general public explains why death is no justice and the relationship between abolition of the death penalty and the society. It gives answers to most asked questions. - 4... [more](#)

Keywords: Death penalty, justice, democracy, Human Rights

Learning Resource Type: Guide (advise sheets)

Format: application/pdf

[View extended info](#)

The Death Penalty: Soering v UK

This lesson plan uses the case of Soering v UK to consider the death penalty and the human rights implications of this topic. -12 pages-

Keywords: article 2, article 3, right to life, torture, inhuman, degrading, treatment, human rights, EDC, HRE, CoE

Learning Resource Type: lesson plan

Format: application/pdf

[View extended info](#)

Why abolish? Questions and answers about the death penalty

Explanations and argumentation in favor of abolition of the death penalty. - 17 pages - This argumentative text is addressed to the general public but requires some level of language and abstraction... [more](#)

Keywords: death penalty, human rights, democracy, justice, deterrence, crime rate, prison

Learning Resource Type: Demonstration

Format: application/pdf

[View extended info](#)

Lista ju jep mundësinë që, me një shikim të shpejtë, të krijoni një ide për burimet që përputhen me kriteret tuaja të kërkimit. Në varësi të gjatësisë së përshkrimit, mund të shfaqet butoni “more” (më shumë). Duke klikuar në të, ju krijohet mundësia të shihni përshkrimin e plotë.

Ju mund të fitoni më shumë informacion duke klikuar komandën “View extended information” (“Shiko informacionin e zgjeruar”). Me anë të këtij veprimi, ju mund të hyni në informacionet e mëposhtme:

- ▶ përshkrimi: disa rreshta për burimin, numrin e faqeve, nëse është një tekst ose kohëzgjatjen, nëse është një video;
- ▶ gjuha;
- ▶ fjala kyç;
- ▶ formati, për shembull: pdf, ëord etj.;
- ▶ vendndodhja: lidhja (link) me burimin;
- ▶ tipi i burimit të të mësuarit: demonstrim, referencë, ushtrim, leksion, ditar mësimi etj.;
- ▶ përdoruesi: nxënësi, mësuesi et5j.

Ky informacion do t’ju ndihmojë të gjeni dokumentin për të cilin keni nevojë për klasën tuaj, ndërmjet qindra burimeve të tjera.

The Death Penalty: Soering v UK

Description

This lesson plan uses the case of Soering v UK to consider the death penalty and the human rights implications of this topic. -12 pages-

General

Language: en

Keywords: article 2, article 3, right to life, torture, inhuman, degrading, treatment, human rights, EDC, HRE, CoE

Technical

Format: application/pdf

Location: <http://62.217.125.52/coe/archive/files/46a1270b4468db4fd4645538e2522da.pdf>

Educational

Learning Resource Type: lesson plan

Intended User Role: Teacher

Context: Classroom

Close

Të gjitha dokumentet janë falas dhe, nëse janë në formatin pdf, mund të shkarkohen direkt nga baza e të dhënave.

7. Publikimet kryesore për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

- ▶ *Handbook on European non-discrimination law*
www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_ENG_01.pdf
- ▶ *Handbook on European non-discrimination law: Case-law update. July 2010-December 2011*
www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_ENG_02.pdf
- ▶ *Handbook on European law relating to asylum, borders and immigration*
www.echr.coe.int/Documents/Handbook_asylum_ENG.pdf
- ▶ *Handbook on European data protection law*
www.echr.coe.int/Documents/Handbook_data_protection_ENG.pdf
- ▶ *Practical impact of the Council of Europe monitoring mechanisms*
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168007feea>
- ▶ *Rights and freedoms in practice*
www.echr.coe.int/Documents/Pub_coe_Teaching_resources_ENG.pdf
- ▶ *Human rights and the fight against terrorism*
www.un.org/en/sc/ctc/specialmeetings/2011/docs/coe/coe-rights_guidelines_en.pdf

8. Botime të tjera për edukimin e të drejtave të njeriut

- ▶ *Compass – A manual on human rights education ëith young people*
<http://eycb.coe.int/compass/en/contents.html>
- ▶ *Companion – A campaign guide about education and learning for change in diversity, human rights and participation*
http://eycb.coe.int/compass/en/pdf/Companion_final.pdf
- ▶ *Domino – A manual to use peer group education as a means to fight racism, xenophobia, anti-Semitism and intolerance*
www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Publications/Domino_en.pdf
- ▶ *Education pack – Ideas, resources, methods and activities for informal intercultural education with young people and adults*
www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Publications/Education_Pack_en.pdf

Sales agents for publications of the Council of Europe Agents de vente des publications du Conseil de l'Europe

BELGIUM/BELGIQUE

La Librairie Européenne -
The European Bookshop
Rue de l'Orme, 1
BE-1040 BRUXELLES
Tel.: +32 (0)2 231 04 35
Fax: +32 (0)2 735 08 60
E-mail: info@libeurop.eu
<http://www.libeurop.be>

Jean De Lannoy/DL Services
Avenue du Roi 202 Koningslaan
BE-1190 BRUXELLES
Tel.: +32 (0)2 538 43 08
Fax: +32 (0)2 538 08 41
E-mail: jean.de.lannoy@dl-servi.com
<http://www.jean-de-lannoy.be>

BOSNIA AND HERZEGOVINA/ BOSNIE-HERZÉGOVINE

Robert's Plus d.o.o.
Marka Marulića 2/V
BA-71000 SARAJEVO
Tel.: + 387 33 640 818
Fax: + 387 33 640 818
E-mail: robertsplus@bih.net.ba

CANADA

Renouf Publishing Co. Ltd.
22-1010 Polytek Street
CDN-OTTAWA, ONT K1J 9J1
Tel.: +1 613 745 2665
Fax: +1 613 745 7660
Toll-Free Tel.: (866) 767-6766
E-mail: order.dept@renoufbooks.com
<http://www.renoufbooks.com>

CROATIA/CROATIE

Robert's Plus d.o.o.
Marasovičeva 67
HR-21000 SPLIT
Tel.: + 385 21 315 800, 801, 802, 803
Fax: + 385 21 315 804
E-mail: robertsplus@robertsplus.hr

CZECH REPUBLIC/ RÉPUBLIQUE TCHÈQUE

Suweco CZ, s.r.o.
Klecakova 347
CZ-180 21 PRAHA 9
Tel.: +420 2 424 59 204
Fax: +420 2 848 21 646
E-mail: import@suweco.cz
<http://www.suweco.cz>

DENMARK/DANEMARK

GAD
Vimmelskaftet 32
DK-1161 KØBENHAVN K
Tel.: +45 77 66 60 00
Fax: +45 77 66 60 01
E-mail: reception@gad.dk
<http://www.gad.dk>

FINLAND/FINLANDE

Akateeminen Kirjakauppa
PO Box 128
Keskuskatu 1
FI-00100 HELSINKI
Tel.: +358 (0)9 121 4430
Fax: +358 (0)9 121 4242
E-mail: akatilaus@akateeminen.com
<http://www.akateeminen.com>

FRANCE

Please contact directly /
Merci de contacter directement
Council of Europe Publishing
Editions du Conseil de l'Europe
FR-67075 STRASBOURG cedex
Tel.: +33 (0)3 88 41 25 81
Fax: +33 (0)3 88 41 39 10
E-mail: publishing@coe.int
<http://book.coe.int>

Librairie Kléber

1 rue des Francs-Bourgeois
FR-67000 STRASBOURG
Tel.: +33 (0)3 88 15 78 88
Fax: +33 (0)3 88 15 78 80
E-mail: librairie-kleber@coe.int
<http://www.librairie-kleber.com>

GREECE/GRÈCE

Librairie Kauffmann s.a.
Stadiou 28
GR-105 64 ATHINA
Tel.: +30 210 32 55 321
Fax.: +30 210 32 30 320
E-mail: ord@otenet.gr
<http://www.kauffmann.gr>

HUNGARY/HONGRIE

Euro Info Service
Pannónia u. 58.
PF. 1039
HU-1136 BUDAPEST
Tel.: +36 1 329 2170
Fax: +36 1 349 2053
E-mail: euroinfo@euroinfo.hu
<http://www.euroinfo.hu>

ITALY/ITALIE

Licosa SpA
Via Duca di Calabria, 1/1
IT-50125 FIRENZE
Tel.: +39 0556 483215
Fax: +39 0556 41257
E-mail: licosa@licosa.com
<http://www.licosa.com>

NORWAY/NORVÈGE

Akademika
Postboks 84 Blindern
NO-0314 OSLO
Tel.: +47 2 218 8100
Fax: +47 2 218 8103
E-mail: support@akademika.no
<http://www.akademika.no>

POLAND/POLOGNE

Marka JSC
25 Obrońcow Street
PL-03-933 WARSZAWA
Tel.: +48 (0)22 509 86 00
Fax: +48 (0)22 509 86 10
E-mail: arspolona@arspolona.com.pl
<http://www.arspolona.com.pl>

PORTUGAL

Marka Lda
Rua dos Correeiros 61-3
PT-1100-162 LISBOA
Tel: 351 21 3224040
Fax: 351 21 3224044
Web: www.marka.pt
E-mail: apoio.clientes@marka.pt

RUSSIAN FEDERATION/ FÉDÉRATION DE RUSSIE

Ves Mir
17b, Butlerova ul. - Office 338
RU-117342 MOSCOW
Tel.: +7 495 739 0971
Fax: +7 495 739 0971
E-mail: orders@vesmirbooks.ru
<http://www.vesmirbooks.ru>

SWITZERLAND/SUISSE

Planetis Sàrl
16 chemin des Pins
CH-1273 ARZIER
Tel.: +41 22 366 51 77
Fax: +41 22 366 51 78
E-mail: info@planetis.ch

TAIWAN

Tycoon Information Inc.
5th Floor, No. 500, Chang-Chun Road
Taipei, Taiwan
Tel.: 886-2-8712 8886
Fax: 886-2-8712 4747, 8712 4777
E-mail: info@tycoon-info.com.tw
orders@tycoon-info.com.tw

UNITED KINGDOM/ROYAUME-UNI

The Stationery Office Ltd
PO Box 29
GB-NORWICH NR3 1GN
Tel.: +44 (0)870 600 5522
Fax: +44 (0)870 600 5533
E-mail: book.enquiries@tso.co.uk
<http://www.tsoshop.co.uk>

UNITED STATES and CANADA/ ÉTATS-UNIS et CANADA

Manhattan Publishing Co
670 White Plains Road
USA-10583 SCARSDALE, NY
Tel: + 1 914 472 4650
Fax: +1 914 472 4316
E-mail: coe@manhattanpublishing.com
<http://www.manhattanpublishing.com>

Council of Europe Publishing/Editions du Conseil de l'Europe
FR-67075 STRASBOURG Cedex

Tel.: +33 (0)3 88 41 25 81 – Fax: +33 (0)3 88 41 39 10 – E-mail: publishing@coe.int – Website: <http://book.coe.int>
Liritë–Veprimtari mësimore për çështje ligjore, për shkollat e mesme ► Faqe 146